



PENGIMI I  
**TREGTISË ME NJERËZ**  
NË PRAKTIKËN E GJYKATAVE TË VENDIT



“Pëngimi i tregtisë me njerëz gjatë praktikës së gjykatave të vendit”

Shkup, nëntor 2005

# “Pëngimi i tregtisë me njerëz gjatë praktikës së gjykatave të vendit”

**Autor:** *Violeta Velkoska*

**Botues:** *Koalicioni "Të gjithë për gjykime të drejta"  
rr. Makedonija br. 11/2-10  
1000 Shkup, R. e Maqedonisë  
tel./faks: ++389 2 3215-263  
e-mail: [contact@all4fairtrails.org.mk](mailto:contact@all4fairtrails.org.mk)  
[www.all4fairtrails.org.mk](http://www.all4fairtrails.org.mk)*

**Për botuesin:** *Vesna Stojkovska, drejtor*

**Redaktor:** *Violeta Velkoska*

**Përgatitje grafike:** *Studio EMITER - Shkup  
tel./faks: (02) 3115-111  
e-mail: [emiter@unet.com.mk](mailto:emiter@unet.com.mk)*

**Kopertina:** **PROMODSGN**  
[www.promo.com.mk](http://www.promo.com.mk)

**Përkthim:** *Norik Selimi*

**Lektorë:** *Haki Selimi*

E Perkohur nga



Organization for Security and Co-operation in Europe  
Spillover Monitor

**Mission to Skopje**

---

Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të thotë se e përfaqëson këndvështrimin dhe qëndrimin e Misionit Vëzhgues të OSBE-së në Shkup.

# Përmbajtja

Falënderim .....	5
Rezyme e shkurtër .....	6

## **KREU 1. TË DHËNA THEMELORE .....** 9

1. Koalicioni "Të gjithë për gjyqime të drejta" .....	9
2. Projekti për vëzhgimin e lëndëve në lidhje me tregtinë me njerëz .....	11

## **KREU 2. RREGULLORJA LIGJORE E DUKURISË: TREGTI ME NJERËZ .....** 13

3. Kontrollim i krimit përmes vendosjes dhe zhvillimit të normativës juridike ndëshkimore efikase të veprave penale "Tregti me njerëz" dhe "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit" .....	13
4. Vështrim i shkurtër historik i definimit të tregtisë me njerëz dhe ndërmjetësimit gjatë kryerjes së prostitucionit përmes dispozitave ligjore në Republikën e Maqedonisë .....	15
5. "Tregtia me njerëz" .....	19
6. Ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit dhe tregtisë me njerëz .....	20
7. Kontrabanda e migruarëve dhe tregtia me njerëz .....	21

## **KREU 3. TË DREJTAT E VIKTIMËS .....** 23

• E drejta e kompensimit .....	23
• E drejta e ndihmësit .....	24
• E drejta e viktimës për të qenë prezent .....	25
• Informim në lidhje me të drejtat e saj .....	25
• E drejta për të propozuar dëshmi të reja .....	26
• E drejta për t'u parashtruar pyetje dëshmitarëve dhe ekspertëve .....	26
• E drejta për të arsyetuar kërkesën pronëso-ro-juridike .....	26
• E drejta për përkthim .....	27
• E drejta për mbrojtje .....	27
• E drejta për gjykim ku përjashtohet publiku .....	28
• Mundësia për marrje në pyetje të viktimës pa praninë e të akuzuarit .....	28
• Trajtimi i viktimës pa e mëshiruar dhe me respekt .....	29

<b>KREU 4. I AKUZUARI</b> .....	31
8. Profili .....	31
9. Të drejtat e të akuzuarit në procedurën para gjykatës .....	34
<b>KREU 5. MBROJTJA E DËSHMITARËVE</b> .....	37
10. Rregullorja vendase në sferën e mbrojtjes së dëshmitarit .....	39
11. Nevoja për mbrojtje të dëshmitarëve në Maqedoni .....	41
• Sigurimi i ndërtesës së gjykatës .....	42
• Kufizime hapësinore .....	43
<b>KREU 6. KOMPENSIMI I VIKTIMAVE</b> .....	47
12. Dëmshpërblim për viktimat në Maqedoni .....	48
<b>KREU 7. ZGJATJA E PROCEDURËS</b> .....	55
13. Ndërlikueshmëria e lëndës .....	55
14. Arsyet për shtyrjen e shqyrtimit kryesor .....	57
• Prania .....	58
• Aktakuza .....	64
• Përgatitja e mbrojtjes .....	65
• Ekspertiza .....	65
• Dërgesa .....	66
15. Afatet .....	67
• Zgjatje e tërësishme e procedurës .....	68
<b>KREU 8. POLITIKA NDËSHKUESE E MAQEDONISË NË LIDHJE ME VEPRAT PENALE TREGTI ME NJERËZ, NDËRMJETËSIM NË KRYERJEN E PROSTITUCIONIT DHE KONTRABANDË E MIGRUESVE</b> .....	71
16. Matja gjyqësore e dënimeve .....	72
<b>KREU 9. REKOMANDIME</b> .....	79
<b>SHTOJCË</b>	
17. Konkluzat nga tryeza e rrumbullakët e mbajtur me rastin e Raportit "Pengimi i tregtisë me njerëz në praksën e gjykatave të vendit të Koalicionit "Të gjithë për gjykime të drejta" .....	83
18. Nene nga Kodi Penal dhe Ligji për Procedurë Penale .....	85

---

## *Falënderim*

Koalicioni "Të gjithë për gjykime të drejta" – Shkup u ballafaqua edhe me një sfidë të rëndësishme përmes projektit "Vëzhgimi i lëndëve në sferën e tregtisë me njerëz në Republikën e Maqedonisë", të cilin e implementoi gjatë vitit 2004 dhe 2005 dhe me të cilin insistohet të japë një kontribut në implementimin e Programit Nacional të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në luftën kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal.

Raporti përfundimtar është prodhim i punës së madhe që kanë bërë vëzhguesit, asistenti i projektit, resurset tjera njerëzore të Koalicionit dhe nënkuptohet koordinatori të projektit, i cili me sakrificën dhe përkushtimin e tij, jam i bindur se do të sjellë kritika pozitive për raportin.

Të vetëdijshëm për faktin se tema e tregtisë me njerëz është në një nivel mjaft të eksploatuar nga opinioni profesional dhe sektori joqeveritar, pa modesti mund të shënoj se raporti përfundimtar i Koalicionit sipas qasjes metodologjike dhe shkencore, e bën atë të vetëm dhe të veçantë.

Gjatë realizimit të projektit, edhe këtë herë hasëm në bashkëpunim të plotë dhe mirëkuptim nga kryetarët e gjykatave themelore ku u identifikuan lëndët, si dhe nga gjykatësit që gjykuan, të cilëve në emrin tim personal dhe në emrin e vëzhguesve u shprehi falënderim të veçantë.

Nënkuptohet, implementimi i projektit nuk do të ishte i mundshëm pa përkrahjen financiare të partnerit tonë strategjik – misionit të OSBE-së në Shkup dhe të Ministrisë për punë të jashtme të Finlandës, me sugjerimet e të cilëve gjatë realizimit të aktiviteteve të projektit dhe përgatitjes së raportit përfundimtar, në masë të madhe është rritur cilësia e tij.

Kryetar  
*Trajçe Pelivanov*

## ***Rezyme e shkurtët***

Mungesa e një analizë më të hollësishme empirike të gjendjes së Maqedonisë rreth çështjes së suksesit të shtetit në ballafaqimin me fenomenin e tregtisë me njerëz, në suaza të të gjitha institucioneve përgjegjëse për ndjekjen dhe pengimin e saj, paraqet shkas për përgatitjen e raportit "Pengimi i tregtisë me njerëz gjatë praktikës së gjykatave të vendit" të Koalicionit "Të gjithë për gjykime të drejta".

Hulumtimi i përfshirë në raportin paraqet fillimisht mbledhje të sistematizuar të të dhënave në nivel nacional për numrin më të madh të lëndëve në lidhje me veprat penale "Tregti me njerëz", "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit" dhe "Kontrabanda e migruesve" të cilat zhvillohen në gjykatat themelore të Maqedonisë.

Përmes përpunimit cilësor dhe kuantitativ të të dhënave, u sjellën këto përfundime:

### **Mbrojtja e dëshmitarëve**

- Në më tepër se një e katërta e lëndëve, dëshmitari në shqyrtimin kryesor nuk ka qenë i informuar për të drejtën të mos përgjigjet në pyetje të veçanta, nëse është relevante se me atë do të kishte shkaktuar ngarkesë për veten apo për ndonjë farefis të tij, dëm material ose ndjekje penale, edhe pse ky obligim është i paraparë me nenin 223 paragrafi 2 nga LPP. Në 75 % të lëndëve bëhet fjalë për dëgjim të viktimës dëshmitar gjatë procedurës
- Në asnjë rast dëshmitari në lëndët në lidhje me tregtinë me njerëz nuk e ka shkurtuar dhënien e të dhënave personale (në pajtim me dispozitën e 223-së nga LPP) që është e paraparë për situatat kur ekziston mundësia që me dhënien e ndonjë deklarate apo përgjigje ndonjë pyetjeje do të vente veten apo ndonjë të afërmin e tij në rrezik serioz për jetën, shëndetin apo integritetin fizik. Njëherësh, nuk ka ndodhur që dëshmitari të refuzojë dhënien e deklaratës në prani të të akuzuarit dhe automatikisht të përdoret dispozita e nenit 312 nga LPP, sipas së cilën i akuzuari në situata të tilla mund të largohet nga gjykatorja.
- Dëgjimi i dëshmitarit apo ekspertit përmes video konferencës është bërë vetëm në një lëndë në Republikën e Maqedonisë.
- Mënyra e veçantë e marrjes në pyetje të dëshmitarit përmes gjykatës në hapësirë që dallon nga gjykatorja ( që rregullohet me nenin 270 nga LPP) deri tani nuk është përdorur në asnjë lëndë të vëzhguar

- Kontrollimi i hyrjes së ndërtesës së gjykatës në gjykatat themelore para të cilave janë vëzhguar lëndë në lidhje me tregtinë me njerëz, ka qenë në nivel të kënaqshëm. Njëherësh, në të gjitha situatat ku prania e viktimës në shqyrtimin kryesor ka qenë e siguruar, është organizuar edhe sigurim përkatës fizik nga përfaqësues të MPB, nga sigurimi i shtetit prej nga vjen viktimja ose policia e gjykatës.
- Kapacitetet hapësinore të gjykatave janë të kufizuara dhe paraqiten si faktor për zmadhimin e mundësive për viktimizim të shkallës së dytë të viktimës në tregtinë me njerëz. Gjykatoret e vogla nuk mundësojnë realizimin e ndryshimeve të LPP që janë verifikuar në nenin 303, sipas të cilave radhitja për uljen e pjesëmarrësve në procedurë është përcaktuar më ndryshe në krahasim me periudhën e kaluar.

## Kompensimi i viktimave

- Në gjykatat themelore në Maqedoni, përkundër mundësive të gjëra që jepen me ligj për kompensimin e viktimave të tregtisë me njerëz, ende nuk është vendosur dhe zhvilluar praktika e sigurimit të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar me kryerjen e veprës.
- Me caktimin e obligimit të domosdoshëm të gjykatës që me aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, të vendosë edhe për kërkesën pronëso-ro-juridike në procedurën penale, qoftë menjëherë, qoftë me sjelljen e vendimit plotësues, legjislatura ka krijuar kushte për realizimin e kompensimit më të shpejtë të viktimave të tregtisë me njerëz. Për fat të keq, këto dispozita ende nuk janë sendërtuar në praktikën e gjykatave të vendit. Në R. Të Maqedonisë nuk është sjellë vendim për dëmshpërbylim material të viktimave të tregtisë me njerëz apo prostitucion të dhunshëm.
- Dispozitat për konfiskimin e pronës apo dobisë pronësore të fituar me veprën penale, si dhe dispozitat për sigurim të përkohshëm të pronës apo mjeteve që janë në lidhje me atë vepër rrallë herë zbatohen në praktikën e gjykatave tona.

## Kohëzgjatja e procedurës penale

- Në më tepër se gjysma nga lëndët e vëzhguara bëhet fjalë për një person të akuzuar në procedurën në gjykatë dhe për një viktimitë të veprave të tregtisë me njerëz. Njëherësh në 75% nga lëndët, akuza ka të bëjë vetëm me një vepër penale.
- Në 1/3 e numrit të përgjithshëm të seancave të vëzhguara, për shkak të mos sigurimit të kushteve për mbajtjen e shqyrtimit kryesor, i njëjti ka qenë i shtyrë. Si shkak më i shpeshtë për shtyrjen paraqitet mos prania e të dëmtuarës/dëshmitare, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.
- Masa arrestim më së shpeshti (50% nga rastet) caktohet në lëndët në lidhje me veprën kontrabandë e migruesve.
- Përkundër gjerësisë së opsioneve që i ka në disponim gjykata për sigurimin e pranisë së të akuzuarit gjatë procedurës, është e dukshme tendenca që në praktikë më së shpeshti të përdoret masa paraburgim apo arrestim. Edhe pse masat tjera preventive për sigurimin e pranisë së të akuzuarit janë sjellë para më tepër se një viti, duket se të njëjtat në të vërtetë nuk janë sendërtuar në gjykatat tona themelore.



- Prania e viktimave dëshmitarë gjatë procedurës në gjykatat themelore ka qenë e siguar në 31% të rasteve. Andaj, në më tepër se gjysma e situatave, dëgjimi i viktimës është bërë jashtë shqyrtimit kryesor.
- Supozimi se seanca do të shtyhet për shkak të mos pranisë së palëve gjatë procedurës është arsyeja më e shpeshtë që gjykimi të realizohet në zyrën e gjykatësit.
- Edhe përkundër ndikimit të padiskutueshëm të thirrjes (njoftimit) mbi kohëzgjatjen e procedurës, përsëri mund të përfundojë se e njëjta nuk është faktor që vendos.
- Më tepër se gjysma e lëndëve në suaza të lëmit "tregti me njerëz" shtyhen në interval kohor më të gjatë se 30 ditë (më së shpeshti 31 deri 40 ditë).
- Andaj, në 20% nga numri i përgjithshëm i rasteve, shtyrja bëhet në interval mbi 60 ditë. Me këtë, lëndët "janë të dënuara" që të rifillojnë në pajtim me nenin 297 (paragrafi 5) nga LPP, që sjell në zgjatjen e panevojshme të procedurës.
- Shpejtësia me të cilën lëndët më të reja gjyqësore në lidhje me tregtinë me njerëz marrin shthurjen e tyre është shumë më e madhe në krahasim me lëndët që janë parashtruar para mesit të vitit 2004. Kjo sjell në përfundimin se efikasiteti i gjykatave në sanksionimin e kryerësve të veprave penale "Tregti me njerëz", "Ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit" dhe "Kontrabandë e migruesve" është rritur në vitin 2005.

## **Politika Ndëshkuese e Maqedonisë**

- Në gjysmën nga të gjitha dënimet efektive me burg në Republikën e Maqedonisë për veprat "Tregti me njerëz" nga viti 2002 deri 2004 dhe "Ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit" nga 2000 deri 2004, bëhet fjalë për gjatësi të dënimit e cila lëviz nën minimumin e posaçëm ligjor. "
- Butësia tejet e madhe e gjykatave gjatë matjes së dënimeve në domenin e tregtisë me njerëz tregon se praktika gjyqësore është në kundërshtim me konceptin e politikës ndëshkuese-juridike të R së Maqedonisë, e shprehur përmes dispozitave të KP për lartësinë e sanksioneve për vepra penale në sferën e tregtisë me njerëz. Ekziston disharmoni në mes peshës së veprës dhe lartësisë së sanksioneve të caktuara.
- Në më tepër se gjysmën e lëndëve të gjykuara, gjykata nuk ka shpallur aktakuzën në pajtim me dispozitat e nenit 344 nga LPP

## **Profili i kryerësit**

- Përpunimi statistikor i të dhënave në lidhje me personat e akuzuar në lëndët e vëzhguara në gjykatat themelore, tregon se kryerësi i mundshëm ka këto karakteristike: persona të gjinisë mashkullore me shkollë të mesme që i takon grupit së moshës prej 18 deri 25 vite ose prej 36 deri 40 vite, të nacionalitetit shqiptar, paraprakisht i gjykuar, pronar i ndonjë bari nate.

# 1

## *Të dhëna elementare*

### **1. Koalicioni "Të gjithë për gjykime të drejta"**

Koalicioni i shoqatës së qytetarëve "Të gjithë për gjykime të drejta"-Shkup paraqet organizatë në të cilën anëtarësojnë 22 OJQ nga tërë territori i Republikës së Maqedonisë:

MOST-Shkup, Forumi Arsimor Rinor- Shkup, SPPMD-Kavadarë, QZHD-Tetovë, ARKA-Kumanovë, FEMINA-Kumanovë. ADI-Gostivar, , Shtigjet Civile-Manastir, Shoqata për të drejtat e Romëve ARRP-Shtip, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut-Shkup, Shoqata për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës-Shkup, MEGJASHI- Shkup PHURT-Dellçevë, ROZPR-Shkup, ASVIN- Shkup, MPRC- Shkup, GIC Spektar-Shtip, FOKUS-Resnjë, Temis-Shkup, ANI-Shtip, Meseçina-Gostivar, Asociacioni Qytetar-Manastir

#### **Vizioni**

Organizatë e fuqishme dhe stabile, lëvizëse dhe partnere e institucioneve të sistemit në përpjekjen e Republikës së Maqedonisë që të lartësohet si vend në të cilin do të respektohen në tërësi të drejtat dhe liritë e njeriut me theks të veçantë në standardet për gjykime të drejta si kusht elementar për integrim në Unionin Evropian.

#### **Misioni**

Ndjekja e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut e veçanërisht të standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë përmes formave të ndryshme të veprimit në përpjekjen që të ritet niveli i implementimit të tyre, të iniciohen reforma institucionale dhe juridike si dhe të kthehet besimi i qytetarëve në gjyqësinë dhe në institucionet tjera të sistemit.

#### **Qëllimet e koalicionit**

Rritje e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, veçanërisht në sferën e standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë.

Forcimi i besimit të qytetarëve më institucionet e sistemit.

Identifikim i problemeve me të cilat ballafaqohen institucionit e sistemit dhe gjetja e mënyrës për tejkalimin e tyre.

Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për të drejtat e tyre të garantuara me kushtetutë, ligj dhe me dokumente ndërkombëtare.

## **Organizimi struktural i Koalicionit**

Trupi më i lartë i vendimit është Kuvendi i Koalicionit, ku çdonjëra nga organizatat anëtare të Koalicionit ka përfaqësuesin e saj.

Kryetari i Koalicionit i cili njëherësh është edhe Kryetar i Kuvendit, e paraqet dhe përfaqëson shoqatën.

Organi Ekzekutiv i Koalicionit është Bordi Ekzekutiv që përmban 7 anëtarë.

Për zbatim e vendimeve të veta, si dhe për realizimin e projekteve të Koalicionit kujdeset Drejtori Ekzekutiv

Zyrën Nacionale e përbën stafi kryesor i Koalicionit i cili punon sipas obligimeve të caktuara në dokumentet interne dhe konceptit të projektit që udhëheqin

## **Aktivitetet e Koalicionit**

Koalicioni është themeluar në Maj të vitit 2003, me qëllim të ritet besimi i opinionit në sistemin juridik dhe gjyqësinë, të identifikohen problemet e sistemit gjyqësor dhe të alarmohet për nevojën për reforma juridike dhe institucionale, të ritet respektimi i standardeve për gjykime të drejta në gjykatat e vendit dhe të njoftohet opinioni me standardet për gjykime të drejta.

Në suaza të projektit themelues "Implementimi i standardeve ndërkombëtare për gjykime të drejta në gjykatat e vendit dhe vlerësimi i funksionimit të gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë" gjatë vitit 2003 dhe 2004, 100 vëzhgues të Koalicionit, juristë, avokatë vëzhguan gjithsej 643 lëndë në 1010 seanca të sferës penale dhe 720 lëndë në 907 seanca të sferës civile, në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Maqedonisë

Si rezultat i analizës së bërë të rezultateve të fituara në pyetësorët për vëzhgim të lëndëve penale dhe civile, respektivisht në bazë të të dhënave nga përpunimi i bazës, u krijua raporti përfundimtar i Koalicionit.

Më 23.09.2004 në Shkup u mbajt një tryezë e rrumbullakët me qëllim që të prezantohen konkluzionet dhe rekomandimet e vëzhgimit njëvjeçar të lëndëve penale dhe civile në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Maqedonisë nga Raporti përfundimtar i Koalicionit. Në këtë tryezë morën pjesë edhe ekspertët nacional jurist në sferën civile dhe penale, përfaqësuesit më të lartë të gjyqësisë, Ministrisë për drejtësi të R të Maqedonisë, Shoqata e gjykatësve, Shoqata e Prokurorëve Publik, Këshilli Republikan Gjyqësor, zyra e Avokatit të Popullit, zyra e Këshillit të Evropës në Shkup, si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në sferën e funksionimit të gjyqësisë.

Me qëllim që të përforcohet struktura e Koalicionit, respektivisht të sigurohet përkrahje për zhvillimin e anëtarëve të saja organizative, të ritet bashkëpunimi si i brendshëm ashtu edhe i jashtëm me organizata dhe institucione të cilat punojnë, para se gjithash në përforcimin e sistemit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, me qëllim që të ndërtohet një sistem për shkëmbim të të dhënave kualitative të interesit të

dyanshëm. Koalicioni në Janar të vitit 2005 filloi me realizimin e projektit "Përforcimi i Kapaciteteve të Koalicionit".

Që të mundësohet këshillim juridik pa pagesë të viktimave të mundshme të sjelljes jo në rregull të policisë, të cilët kërkojnë ndihmë në dërgesën e ankesave zyrtare përmes mekanizmave të ndryshme administrative dhe juridike, Koalicioni u bashkëngjiti rrjetit të pesë OJQ-ve në vitin 2005, për të realizuar "Projektin për Përkrahje të të drejtave të njeriut"

## ***2. Projekti "Vëzhgimi i lëndëve në sferën e tregtisë me njerëz në Republikën e Maqedonisë"***

Me qëllim që të ndihmojë implementimin e Programit Nacional të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë<sup>1</sup> për luftën kundër tregtinë me njerëz dhe migrimin ilegal, Koalicioni "Të gjithë për gjykime të drejta" nga Nëntori i vitit 2004 filloi me implementimin e projektit "Vëzhgimi i lëndëve gjyqësore në lidhje me tregtinë me njerëz në Republikën e Maqedonisë"

Në të vërtetë, gjashtë vëzhgues të zgjedhur juristë dhe avokatë, me eksperiencë prej më tepër se një viti në vëzhgimin e proceseve gjyqësore, të cilët më 24 dhe 25 dhjetor 2004 morën pjesë në trajnimin e organizuar për të pasuruar dituritë e tyre në fushën e tregtisë me njerëz, në Janar të vitit 2005 filluan me vëzhgimin e lëndëve në gjykatat themelore të Republikës së Maqedonisë

Sipas temës së interesit të projektit, kujdesi i Koalicionit u drejtua kah lëndët në lidhje me veprat penale: "Tregti me njerëz" (neni 418 a Kodi Penal<sup>2</sup>), „Kontrabandë e migruesve (neni 418-b nga KP, Organizimi i grupit dhe shtytje për kryerjen e veprave "Tregti me njerëz" dhe "Kontrabandë e migruesve" (neni 418-v) "Vendosja e relacionit të robërisë dhe transport i personave nën relacion robërie" (neni 418), "ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit" (neni 191 nga KP).

Vëzhguesit pas vëzhgimit të realizuar, në bazë të të dhënave të mbledhura nga lënda plotësojnë pyetëtorin për vëzhgim specialist të përgatitur për vëzhgimin e lëndëve të sferës së tregtisë me njerëz dhe e dërgojnë në Zyrën Nationale të Koalicionit.


Të gjitha të dhënat për lëndët e vëzhguara vehen në një bazë të dhënash të përgatitur posaçëm për pyetëtorët për vëzhgim, e cila mundëson kryqëzimin dhe sistematizimin e tyre të mëtejshëm.

Duke qenë i vetëdijshëm për ndjeshmërinë e të dhënave nga lëndët në lidhje me tregtinë me njerëz dhe duke u përpjekur të sigurohet një balans mes parimit të diskrecionit të të dhënave dhe shkëmbimit të të dhënave të rëndësishme me qëllim të mundësohet një luftë më efikase kundër kryerësve të veprave penale në sferën e tregtisë me njerëz, Koalicioni sjelli Rregulloren për përcaktimin e shkallës së fshehtësisë së të dhënave.

Sipas kësaj rregullore, të gjithë aktorët e involvuar në procesin e vëzhgimit të lëndëve në lidhje me tregtinë me njerëz janë të obliguar të respektojnë parimin e fshehtësisë së të dhënave të cilat fitohen.

<sup>1</sup> Report by Barbara Limanowska, Trafficking in Human Beings in South-Eastern Europe, March 2005, page 138.

<sup>2</sup> Gazeta zyrtare e RM 37/96;80/99;4/02;43/03;19/04, në tekstin e mëtejshëm KP.



Raporti "Pengimi i tregtisë me njerëz në praktikën e gjykatave të vendit" paraqet rezultat të analizës së bërë në bazë të të dhënave të marra nga pyetësorët për vëzhgimin e lëndëve penale, respektivisht nga të dhënat që fitohen me përpunimin e bazës së të dhënave, si dhe prej hulumtimeve krahasuese të zgjidhjeve të ndryshme ligjore në lidhje me tema që kanë drejtpërdrejt të bëjnë me pozitën e viktimës në procedurën para gjykatës, dhe me efikasitetin e ndjekjes dhe sanksionimit të kryerësve të veprave penale në domenin e tregtisë me njerëz.

Në periudhën prej Janar deri në Shtator 2005, janë vëzhguar gjithsej 32 lëndë në 102 seanca kundër 83 kryerësve të veprave penale të fushës së tregtisë me njerëz.

Pjesa më e madhe e lëndëve në lidhje me "Tregtinë me njerëz" (neni 418-a nga KP) janë zhvilluar në Gjykatën Themelore të Tetovës, ndërsa lëndët në lidhje me veprën penale sipas nenit 191, "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit", dominojnë në Gjykatën themelore të Gostivarit. Në gjykatën themelore të Manastirit janë vëzhguar më së shumti lëndë që kanë të bëjnë me "Kontrabandë Migruesish"<sup>3</sup>.

<sup>3</sup> Prej gjithsej 27 gjykata themelore në R e Maqedonisë, vetëm në gjashtë gjykatat e përmendura paraprisht janë përfaqësuar lëndë lidhur me tregtinë me njerëz .

## 2

## *Normativi ligjor i dukurisë tregti me njerëz*

### *3. Kontrolli i krimit përmes vendosjes dhe zhvillimit të normativit efikas juridiko-ndëshkues të veprave penale tregti me njerëz dhe ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit*

Historia e Komunitetit ndërkombëtar është e përmbushur me një numër të madh të iniciativave dhe aktiviteteve që janë ndërmarrë me qëllim të zhdukjes së tregtisë me njerëz, si një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut. Një numër i madh dokumentesh, të përgatitura dhe miratuara nga OSBE, Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës, përpiqen t'u përgjigjen nevojave për definim të saktë të nocionit tregti me njerëz. Mirëpo, shumica e tyre kanë të bëjnë vetëm me tregtinë me gra dhe/ose vetëm për prostitucion të dhunshëm.

Një hap të rëndësishëm përparimtar paraqet Protokollin për preventivë, pengim dhe ndëshkim të tregtisë me persona, veçanërisht gra dhe fëmijë<sup>4</sup>, me të cilin plotësohet Konventa e Kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional. Definimi i veprës tregti me njerëz, që caktohet në këtë dokument, mundëson korniza mjaft të gjëra që të përfshihen të gjitha format e tregtisë me njerëz, siç janë, përveç eksploatimit seksual dhe punës së detyrueshme, robërisë, shërbimit dhe gjendjes robëruese. Njëkohësisht cakton se si viktime mund të paraqitet çdo person, jo vetëm grua ose vajzë. Andaj, nuk është e domosdoshme të kalohet kufi shtetëror, që do të thotë se sanksionohet edhe tregtia e brendshme me njerëz. Paralelisht me ndërrimin e formave në të cilat paraqitet krimi në lidhje me tregtinë me njerëz dhe determinantave të tij, kurse si pasojë e përvojave të përmbledhura më parë dhe synimi i përhershëm për gjetjen e mënyrave më të mira për zhdukjen e këtij lloji të krimit të organizuar, ndryshohen edhe zgjidhjen ligjore në vendet e botës<sup>5</sup>.

<sup>4</sup> Republika e Maqedonisë më 12 Dhjetor të vitit 2000 e nënshkroi Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të organizuar transnacional me protokollin për preventivë, zhdukje dhe dënim të tregtisë me njerëz, posaçërisht gra dhe fëmijë dhe protokollin kundër kontrabandimit të migruesve përmes rrugëve tokësore, ujore apo ajrore- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional me protokollin (komente, shtojca, sqarime dhe rekomandime), Ministria e drejtësisë.

<sup>5</sup> Statement of Mohamed Y. Mattar, a comparative Analysis of the Anti-Trafficking Legislation in Foreign Countries: towards a comprehensive and effective legal response to combating trafficking, 25 June 2003.

Edhe krahas tendencës së vazhdueshme për unifikimin e vlerave, standardeve, normave dhe mekanizmave me qëllim të sigurimit të mënyrës më efektive për zgjidhje globale të problemit, rregullorja ndëshkuese-juridike ndryshon nga shteti në shtet.

Disa legjislacione, parashohin sanksione vetëm për tregtinë me njerëz për prostitucion<sup>6</sup>, përderisa disa nga vendet që kanë nënshkruar Protokollin për preventivë, pengim dhe ndëshkim të tregtisë me njerëz, veçanërisht gra dhe fëmijë, duke pranuar pothuajse tërësisht definicionin për tregti me njerëz nga po ai dokument, në legjislacionet e veta nocionin tregti me njerëz e kanë përcaktuar shumë më gjerësisht<sup>7</sup>.

Për dallim nga legjislacionet e disa vendeve në të cilat nën tregti me njerëz nënkuptohet vetëm tregtia që përfshin tejkalimin e kufirit shtetëror, ekzistojnë edhe ligje ku nuk është caktuar rreptësisht a bëhet fjalë për të brendshme (në suaza të një shteti) apo tregti e jashtme me njerëz (me tejkalimin e kufirit të shtetit)<sup>8</sup>.

Nëse vepra bëhet ndaj ndonjë fëmije, respektivisht person të mitur, ndëshkimi i kryerësit është i paraparë ose si rrethanë rënduese në suaza të një neni ose si nen i veçantë, respektivisht vepër në kodin penal.<sup>9</sup> Kur veprën e kryen anëtar i ndonjë grupi të organizuar, bandë ose shoqatë tjetër, më së shpeshti kjo rrethanë merret si rënduese dhe shkakton dënim më të rëndë<sup>10</sup>

Qenia ligjore e veprës tregti me njerëz në disa kode ligjore kërkon realizimin e dobisë materiale ose të ndonjë lloji tjetër.<sup>11</sup>

Në numrin më të madh të legjislacioneve, si mënyrë për kryerjen e veprës parashikohen përdorimi i forcës, kërcënimet serioz ose gënjeshtër. Mirëpo, me këto, as prej së largu nuk parashihet llojllojshmëria e opsioneve që ekzistojnë në shtete të ndryshme.

<sup>6</sup> Kodi penal I Gjermanisë në nenin 180-b në kapitullin me titull Vepra penale kundër vetëpërcaktimit gjinor parasheh dënim me të holla ose dënim me burg jo më shumë se 5 vite, për atë që do të ndikojë mbi person tjetër, duke shfrytëzuar situatën e tij të pavolitshme të fillojë ose të vazhdojë të merret **me prostitucion**. Po ashtu, do të dënohet edhe ai që do të "...ndikojë mbi person tjetër, duke ditur situatën e tij pa rrugëdalje që rrjedh nga prezenca në shtet të huaj, **tu japë shërbime seksuale** personave të tretë.." (<http://www.legislationline.org/>)

Kështu edhe Kodi Penal I Çekisë, në nenin 204 e dënon deri në 3 vjet burg atë që "...inkurajon, detyron ose me dhunë e detyron që një person tjetër të merret me prostitucion ose të fitojë nga ai prostitucion..". Në nenin 246 nga po ai Kod, dënohet çdonjëri që "...e bind, inkurajon ose transporton grua në shtet të huaj për dhënie të shërbimeve seksuale.."

<sup>7</sup> Ashtu në Republikën e Moldavisë, me ndryshimet e Janarit të vitit 2003, neni 165 i cili mban titullin Tregti me njerëz, përfshin inkurajimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pranimin e personit, për shkak të eksploatimit seksual të komercializuar ose të pa komercializuar, punë të dhunshme apo shërbëtori, robëri ose forma të ngjashme me robërinë, nxjerrje organesh ose transplantim të indit dhe (ajo që e bën këtë dispozitë të ndryshme) përdorje të fytirës në konflikt të armatosur dhe aktivitete krimi. Ngjashëm edhe neni 149 i Kodit Penal të Ukrainës... për arsye eksploatimi seksual, përdorje në biznesin e pornos, përdorje të fytirës në konflikt të armatosur ose aktivitete krimi, punë të dhunshme, adoptim për shkaqe profitorie.." (<http://www.abanet.org/ceeli/publications/conceptpapers/humantrafficking/moldova.html>)

Kodi penal në Kolumbi në nenin 219, inkriminon edhe turizmin e seksit. Respektivisht, ndëshkohet ai që drejton, organizon ose promovon aktivitete turistike të cilat përfshijnë (keq)trajtim seksual të personave të mitur.

<sup>8</sup> Kodi penal i Holandës në nenin 250 a, "...ai ose ajo që rekruton, pranon ose grabit person tjetër për arsye... në shtet tjetër..". Në pajtim me Kodin penal të Federatës Ruse (neni 127, tregtia me njerëz), përcjellja e viktimës nëpër kufirin shtetëror ose mbajtja e paligjshme e atij personi në shtet të huaj, paraqet rrethanë rënduese, dhe për këtë, në vend të dënimit me burg prej 5 vjet, parashihet sanksion me burg prej 3 deri 5 vjet.

<sup>9</sup> Neni 173 nga Kodi Penal i Estonisë parasheh dënim me burg prej 1 deri 5 vjet për shitje dhe blerje të fëmijëve (nen i veçantë). Kodi penal i Ukrainës, sipas nenit 149 nga kapitulli 3 (vepër penale kundër lirisë, nderit dhe dinjitetit të personit), në paragrafin 2 cakton sanksion më të rëndë nëse vepra e formës elementare kryhet ndaj ndonjë personi të mitur (në vend se 3-8 vite, 5-12 vite burg). g:

<sup>10</sup> Kështu është në Kodin Penal të Sllovakisë dhe në kodin penal të Republikës së Çekisë...ai që veprën e bëri si anëtar i grupit së organizuar...

<sup>11</sup> Kodi Penal i Shqipërisë nga Janari i viti 2001 (neni 110a), parasheh dënim me burg prej 5 deri 15 vite për tregti me njerëz me qëllim për të realizuar interes material ose tjetër. Sipas Kodit penal të Austrisë, realizimi i profitorit është rrethanë plotësuese e cila rit lartësinë e sanksionit.

Ekziston një numër i vogël i shteteve që parashikojnë sanksione edhe për atë që përdorë shërbime seksuale, respektivisht shërbime të personit me të cilin bëhet tregti.

#### ***4. Vështrim i shkurtër historik i definimit të Tregtisë me njerëz dhe Ndërmjetësimin gjatë kryerjes së prostitucionit nëpër dispozitat ligjore në RM***

Vepra penale "Tregti me robër të bardhë" haset që nga Kodi Penal i Mbretërisë së Jugosllavisë<sup>12</sup> i vitit 1929 dhe në Kodin Penal të RSFJ të vitit 1951<sup>13</sup>. Kjo vepër përfshinte të gjitha veprimet siç janë dërgimi, dorëzimi, ndihma me qëllim që ndonjë person të dorëzohet ose shitet për kurvëri. Andaj, si viktimë mundëj të paraqitet ose mashkull ose femër, respektivisht edhe i rritur edhe i mitur.

Me ndryshimet e Kodit Penal në vitin 1959, vepra penale "Tregti me robër të bardhë" transformohet në vepër penale "Ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit" dhe i përfshiu veprat: inkurajim, detyrim, motivim, mashtrim të personave femra në prostitucion ose pjesëmarrje në çfarëdo mënyre, në dorëzimin e personit femër tek ndonjë person tjetër për qëllime prostitucioni. Njëherësh, inkriminohet edhe vepra e këtillë ndaj personit të mitur ose kryerja e veprës me përdorimin e forcës, kërcënimit ose mashtrimit.

Me dispozitën e këtillë, e cila edhe më tej vazhdon, e pa ndryshuar në thelb, deri në sjelljen e Kodit Penal në viti 1996, dënohet shtytja për kryerjen e prostitucionit për shkak të ndonjë interesi si dhe tregtia me persona femra për prostitucion.

Në këtë mënyrë lind përkufizimi i subjektit të tregtisë me robër të bardhë sipas zgjidhjeve të mëparshme ligjore, në përkufizim vetëm në persona "femra".

Kodi penal i vitit 1996, në nenin 191, i cili ka ngelur i pandryshuar deri sot, sanksionon atë që: "inkurajon, detyron, shtyn ose mashtron persona për prostitucion ose ai që në çfarëdo mënyre merr pjesë në dorëzimin e ndonjë personi tek ndonjë tjetër për kryerjen e prostitucionit."<sup>14</sup>

Këtu, legjislatura e përmirëson gabimin dhe cakton se çdo person (jo vetëm femër) mund të jetë subjekt i veprës.

Në paragrafin e dytë të këtij neni dënohet ai i cili për fitim i mundëson ndokujt tjetër shfrytëzimin e shërbimeve seksuale.

<sup>12</sup> I njëjti zbatohet edhe në territorin e RM-së

<sup>13</sup> Lj Arnaudovski dhe T Stojanovski, Tregti me njerëz-krim, Shkup, 2002

<sup>14</sup> Derisa pjesa e parë e alinesë 1 nga neni 191 është plotësisht i qartë dhe përfshin shtytjen e personave në prostitucion, në kuptimit më të gjerë të fjalës, pjesa e dytë.. ose në cilën do mënyrë tjetër merr pjesë në dorëzimin e personit .., ngrit çështjen e dallimit mes natyrës së veprës tregti me njerëz, që caktohet me nenin 418-a. Respektivisht, disa autorë të vendit mendojnë se "Pjesëmarrja në dërgimin e personit dikujt tjetër për prostitucion paraqet formë e tregtisë me njerëz" (D-r Vllado Kambovski, e drejta penale, pjesa e veçantë, faqe 218), por po ashtu mendojnë se "kjo pjesë e dispozitës është statuar në mënyrë mjaft sipërfaqësore dhe të përgjithësuar, kështu që len mundësi për interpretim të saj tejet të gjerë ose të ngushtë" (M-r Nikolla Tupançevski, Tregti me njerëz në të drejtën penale krahasuese dhe në të drejtën penale të RM-së, Revia maqedonase për të drejtën penale dhe kriminologji, faqe 113)



Paragrafi 3 parasheh dënim më të rreptë për atë i cili për të arritur fitim, me forcë ose me kërcënim serioz për përdorimin e forcës do të detyrojë ose me gënjeshtër do të shtyjë ndonjë person tjetër të jep shërbime seksuale<sup>15</sup>.

Rrethana kualifikuese ekzistojnë kur vepra e bërë ndaj personit të mitur, fëmijë, kur bëhet fjalë për dhunën në familje ose formë e organizuar e kryerjes së veprës.

Hap përpara që bën legjislacioni i Maqedonisë në këtë kod paraqet shtimi i nenit 418 nën kapitullin me vepra penale kundër njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare. Respektivisht, ky nen me titull "vendosje e raportit robërues dhe transport i personave në raport robërues" i cili në këtë formë të pandryshuar është ende pjesë e të drejtës sonë penale, e sanksionon kryerësin i cili duke shkelur rregullat e të drejtës ndërkombëtare, do të vejë tjetrin në raport robërues ose të ngjashëm, ose të mbajë në raport të tillë, të blejë, të shes, t'ia dorëzojë ndonjë personi tjetër ose ndërmjetësorë gjatë blerjes, shitjes ose dorëzimit të personit të tillë, ose të nxisë tjetrin t'ia shesë lirinë e vet ose lirinë e personit që e mban ose për të cilin kujdeset.

Njëkohësisht, sanksionohet çdonjëri që transporton persona të cilët gjenden në raport robërues ose të ngjashëm nga një shtet në ndonjë tjetër.

Më rëndë dënohet kryerja e veprës ndaj ndonjë personi të mitur.

Për ballafaqim më të suksesshëm me tregtarët me njerëz, njëkohësisht për harmonizimin e legjislacionit të vendit me Konventën e ratifikuar të KB-së kundër krimit të organizuar transnacional dhe dy protokolleve të saj, me ndryshimet e kodit penal në vitin 2002, u shtua një nen i ri 418-a me titull "Tregtia me njerëz". Me këtë nen, dënohet çdo njëri që inkurajon, transporton, përcjell, blen, shet, strehon ose pranon persona për eksploatim përmes prostitucionit ose forma tjera të eksploatimit seksual, punë të detyruar apo shërbim, robërie ose raport i ngjashëm me të, ose për transplantim të palejueshëm të pjesëve të trupit të njeriut, njëkohësisht duke përdorur forcën, kërcënime serioze ose forma tjera të detyrimit, rrëmbim, mashtrim, me keqpërdorim e pozitës dhe dobësisë së tjetrit, ose me pranimin e të hollave ose interesit tjetër për marrjen e pajtimit nga personi i cili ka kontrollin mbi person tjetër.

Për herë të parë janë shtuar dispozita për sanksionimin e marrjes dhe zhdukjes së dokumenteve të identifikimit në lidhje me tregtinë me njerëz.

Njëherësh u parapa dënim për çdo person që përdor i mundëson tjetrit shfrytëzimin e shërbimeve seksuale nga personi për të cilin dihet se është viktimë e tregtisë me njerëz.

Sanksion më rigoroz ishte paraparë nëse vepra është kryer ndaj fëmijëve ose personave të mitur dhe nëse bëhet fjalë për kryerje të organizuar të veprës.

Nuk mund të mos nënvizohet se neni 418a paragrafi 1 nënkuptonte marrje të tërësishme të tekstit nga neni 3 i protokollit për preventivë, pengim dhe dënim të tregtisë me njerëz, veçanërisht me gra dhe fëmijë me çka plotësohet Konventa kundër krimit të organizuar transnacional<sup>16</sup>. Ky nen pësoi ndryshime me hyrjen

---

<sup>15</sup> Formohet përshtypje se në situatë kur kemi përdorimin e detyrimit (force ose kërcënim serioz për përdorim force), si mënyrë për inkurajimin e personit për të eksploatuar në prostitucion, që paraqet një nga format më të shprehura në territorin e Maqedonisë, e po kjo do të thonë plotësim i objektit ligjor të dy veprave penale. Në veprën e nenit 418-a paragrafi 1 (vepër e kryerjes; inkurajon) dhe veprës nga neni 191 paragrafi 3.

<sup>16</sup> Përderisa nga njëra anë kompleksiteti i veprës përkatësisht spektri i gjere i veprimeve të përfshira në të, mundëson zvogëlim të shansit sjellje e përcaktuar negative nga praktika e llojllojshme që të mbetet e pambuluar, nga ana tjetër ndërlikueshmëria e veprës sjell nevojën e saktësisimit të qartë të raportit ndërmjet veprimeve të ndryshme prej të cilave përbëhet e njëjta.

në fuqi të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Kodit penal në vitin 2004. Respektivisht në nenin 418-a të KP-së të Maqedonisë thuhet:

- (1) **Ai që me forcë, kanosje serioze e vë në mashtrim ose me forma tjera detyrimi, grabitje, mashtrim, me shpërdorimin e pozitës së vet<sup>17</sup> ose të gjendjes së shtatzënisë, pafuqisë ose paaftësisë fizike ose mentale të tjetrit, ose me dhënien apo marrjen e të hollave ose të ndonjë interesi tjetër për të arritur marrjen e pëlqimit nga personi i cili ka kontrollin mbi një person tjetër<sup>18</sup> inkurajon, transporton dhe bart, blen, shet, strehon ose pranon persona për<sup>19</sup> eksploatim përmes prostitucionit ose formave të tjera të eksploatimit seksual, pornografisë, punës së detyruar ose punës së shërbyesit, robërisë, martesave të detyruara, fertilizimit të detyruar, adoptimit të paligjshëm ose ndonjë marrëdhënie tjetër të ngjashme ose transplantimit të palejueshëm të pjesëve të trupit të njeriut, do të dënohet të paktën me 4 vjet vuajtje burgu.**
- (2) **Ai që inkurajon, transporton, bart, blen, shet, strehon ose pranon fëmijë ose të mitur për eksploatim, do të dënohet me, të paktën 8 vjet burg.**
- (3) **Ai që do të marrë ose shkatërrojë letërnjoftim ose pasaportë ose ndonjë dokument tjetër të huaj identifikimi për kryerje të veprës nga pika 1 dhe 2 do të dënohet me burgim prej të paktën 4 vjet burg.**
- (4) **Ai që i shfrytëzon ose i mundëson ndokujt tjetër shfrytëzimin e shërbimeve seksuale nga person për të cilin ka dijëni se është viktimë e tregtisë me njerëz, do të dënohet prej 6 muaj deri 4 vjet burg.**
- (5) **Nëse vepra e pikës 4 kryhet me fëmijë ose të mitur kryerësi do të dënohet me të paktën 8 vjet burg.**
- (6) **Nëse veprën e pikës 1 e kryen person juridik, do të dënohet me të holla.**
- (7) **Mjetet dhe automjetet që janë përdorur për kryerjen e veprës, merren.**

Ndryshimi<sup>20</sup> solli ndëshkim më të rreptë për kryerësit e kësaj vepre penale si dhe shlyerje të dispozitave për sanksionim të organizatorit të kryerjes së veprës. Kjo e fundit tani rregullohet me nenin 418v nga KP ku, sanksionohet organizimi i grupit, bandës ose ndonjë shoqate tjetër për kryerje të veprës penale në fjalë, anëtarësimi në to si dhe thirrja, nxitja ose përkrahja e kryerjes së veprës.

<sup>17</sup> Edhe "forca" e cila përbëhet prej veprimit fizik për shkak të përballimit të rezistencës ekzistuese ose të pritur nga ana e viktimës, edhe "kanosja" e cila do të thotë vënie në dukje të ndonjë të keqeje realizimi i së cilës varet nga ajo se a do të reagojë viktimja në përputhje me vullnetin e tij, paraqesin mjete për ta detyruar viktimën në sjellje të caktuara. Në të vërtetë që të dyja sjelljet, ndonëse do të thonë përmbushje të qenies ligjore të veprës nga neni 139 të KP "detyrim" në veprën tregti me njerëz paraqesin vetëm mjet për realizimin e ndonjërisë prej qëllimeve të sipërpërmendura. Ajo që imponohet si pyetje, pjesërisht e natyrës estetike e pjesërisht të asaj praktike, është nevoja e ekzistimit të fjalëve – e vë në lajthitje. Meqë mashtrimi në të vërtetë paraqet vënia ose mbajtja e dikujt në lajthitje me anë të paraqitjes së rejsheve ose fshehjes së fakteve, aq më tepër nuk ka nevojë të përsëritjes së gjerave.

<sup>18</sup> Me këtë rast si subjekt mund të paraqitet si personi femër ashtu edhe ai mashkull përkatësisht si personi i rritur ashtu edhe ai i mitur, përkatësisht fëmija. Sa u përket indikatorëve për rrezikun e futjes së personave të rinj të popullatës së shkollës së mesme në tregtinë me njerëz shih "Vlerësimi i qëndrimeve dhe i njohurive të popullatës së shkollës së mesme për fenomenin e prostitucionit të fshehur dhe të tregtisë me njerëz", HOPS, Shkup, 2004, faqja 34

<sup>19</sup> Qëllimi i kryerësit është kushti i dytë kumulativ i cili patjetër të ekzistojë së bashku me ndonjë ose disa prej qëllimeve të radhitura më lart të kryerjes së veprës. Në të vërtetë qëllimi i kryerësit përmban ndërgjegjen se me personin bëhet tregti për shkak .....

<sup>20</sup> Për mangësitë e nenit. 418 të Kodit penal të vitit 2002 shih "Tregti me njerëz-Temis" Shkup, 2004.

Shtesë interesante paraqet paragrafi 3 në të cilën parashikohet lirim nga dënimi për çdo pjesëtar të shoqatës i cili do ta zbulojë atë.

Ligjvënësi ynë, me siguri duke u nisur nga qëndrimi se problemi i tregtisë me njerëz për eksploatim seksual nuk do të zvogëlohet deri sa nuk ndërmerren masa edhe kundër atyre personave të cilët e krijojnë nevojën e ekzistimit të tregut të këtillë, në alinenë 4 të nenit 418a, caktoi dënim të çdonjërit që shfrytëzon shërbime seksuale nga personi për të cilin ka njohuri se është viktimë e tregtisë me njerëz.

Në këtë mënyrë, me sanksionimin e çdonjërit që nuk do të lajmërojë veprën lidhur me tregtinë me njerëz sipas nenit 364 të KP dhe me sanksionimin e çdonjërit që shfrytëzon shërbime nga viktimat e tregtisë, ndoshta përmes ndryshimit të sjelljes njerëzore, veçanërisht të meshkujve, shfrytëzues të shërbimeve të eksploatimit seksual, mund të arrihen më të suksesshme në luftën kundër tregtisë me njerëz.

Risi paraqet edhe inkorporimi i veprës penale "Kontrabanda e migruesve" në nenin 418b ku thuhet:

- (1) Ai i cili me forcë ose me kanosje serioze se do të cenojë jetën ose sulmojë trupin, me grabitje, mashtrim, nga leverdia, me keqpërdorim të pozitës së vet zyrtare ose duke shfrytëzuar pafuqinë e ndokujt bart migrues jo legalisht nëpër kufirit shtetëror si dhe ai që bën, furnizon ose posedon pasaporta të rrejshme për qëllime të tilla, do të dënohet me burg prej të paktën 4 vjet<sup>21</sup>.**
- (2) Ai që rekruton, transporton, bart, blen, shet, strehon ose pranon migrues, do të dënohet me burg prej një deri në pesë vjet<sup>22</sup>.**
- (3) Ne së gjatë kryerjes së veprave nga paragrafët 1 dhe 2 rrezikohet jeta ose shëndeti i migruesit, ose me migruesin veprohet posaçërisht në mënyrë nënçmuese ose të vrazhdë, ose pengohet që ai ti shfrytëzojë të drejtat që i takojnë sipas të drejtës ndërkombëtare, kryerësi do të dënohet me të paktën tetë vjet burg.**
- (4) Nëse vepra nga paragrafët 1 dhe 2 është kryer me person të mitur, kryerësi do të dënohet me burg prej të paktën 8 vjet.**
- (5) Mjetet dhe automjetet e përdorura për kryerjen e veprës do të merren.**

---

<sup>21</sup> Ajo që menjëherë bie në sy është ngjashmëria me nenin 418 a të KP në pjesën e mënyrës së kryerjes së veprës (në të dyja veprat kemi përdorim të forcës, kanosje serioze, grabitje, mashtrim, shfrytëzim të paaftësisë së personit tjetër dhe keqpërdorim të pozitës së vet). Për dallimin mes këtyre dy neneve shiko: Migration connected with trafficking in women and prostitution, 25 April 2003, **Report**, Committee on Equal Opportunities for Women and Men, Rapporteur: Ms Zwerver, Netherlands, SOC ; 'Trafficking' and 'Smuggling' of Human Beings in Europe: Protection of Individual Rights or States' Interests <http://webjcli.ncl.ac.uk/2001/issue5/obok5.html>

<http://www.interpol.int/Public/THB/PeopleSmuggling/Default.asp>

Njëherësh veprimi i kryerjes së veprës nga 418 b paragrafi 1 të KP, që përbëhet nga transferimi jolegal i migrues nëpër kufirin shtetëror është njëri prej veprimeve të kryerjes të përfshirë me nenin 418 a paragrafi 1 (një aspekt më i ngushtë meqë ajo "migrues" mund të supsumohet nën atë "persona")


Dallimi kryesor ndërmjet këtyre dy veprave qëndron në paramendimin e kryerësit. Në të vërtetë, përdërisa te tregtia me migrues qëllimi i kryerësit është eksploatimi, respektivisht vendosjen e relacionit robërues, shërbëtori e detyruar etj.

<sup>22</sup> Me rëndësi për materien e lartpërmendur është edhe neni 402 i KP "Kalim i palejuar i kufirit shtetëror." Dallimi i kësaj dispozite me dispozitën nga paragrafi 2 i nenit 418 b kur është fjala për transferim nëpër kufirin shtetëror, përveç faktit që në rastin e parë kjo kryhet si një lloj profesioni (që nuk është e thënë të vlejë edhe për rastin e dytë, paraqet edhe fakti që personi i cili bën transferimin nga neni 402, përmban një karakteristikë plotësues në 418-b (dërgues). Pikërisht kjo karakteristikë kur kemi situatë të transferimit të migruesve përmes kufirit, disa herë (në formë të profesionit), i vë të dyja qeniet ligjore në specialitet dhe në këtë mënyrë i aktivizon rregullat e teorisë penale. Përkatësisht, personi do të përgjigjet në përputhje me dispozitën në nenin 418b të KP.

Nga gjithë ajo që u theksua më lartë mund të vërtetohet se Republika e Maqedonisë ka një normativ të pasur ligjor kur bëhet fjalë për inkriminimin e veprave penale në lidhje me tregtinë me njerëz. Mirëpo, parashtrahet pyetja vallë të gjitha këto dispozita kanë gjetur zbatim në praktikën e gjykatave të vendit, vallë janë plotësisht të diferencuara mes tyre, respektivisht vallë ekzistojnë përshkrimi të fuqishme dhe të qarta të qenieve ligjore dhe cilat janë problemet me të cilat ballafaqohen organet kompetente gjatë kualifikimit të ndonjë veproje sipas ndonjë norme të caktuar.

## 5. Tregtia me njerëz

Në pajtim me të dhënat e marra nga Entin shtetëror i statistikës numri i përgjithshëm i të paraqiturve, të akuzuar dhe të dënuar për veprë penale Tregti me njerëz, në territorin e Republikës së Maqedonisë pre vitit 2002 kur e njëjta është inkriminuar e deri në vitin 2004, shënon rritje rapide<sup>23</sup>.



Në vitin 2005 prej gjithsej 12 lëndëve të mbikëqyrura në lidhje me veprën penale tregti me njerëz, në të gjitha bëhet fjalë për shfrytëzim seksual. Është interesant e dhëna se në asnjë lëndë nuk ka qenë fjala për lidhjen e bashkëshortësisë me forcë, edhe pse në pajtim me botëkuptimet e vjetra në disa mjedise rurale në Maqedoni dhe në pajtim me informatat në mediumet e shkruara, mund të pritet që shifra e zezë e llojit të këtillë të tregtisë nuk është për t'u përcmuar.

Në Maqedoni nuk ka/nuk ka pasur lëndë gjyqësore lidhur me tregtinë me njerëz që bëhet për punë me forcë, fertilizim me forcë, adoptim joligjor ose ndonjë mënyrë të ngjashme me të, ose transplantimin e palejueshëm të pjesëve të trupit të njeriut<sup>24</sup>.

Në paragrafin 3 të nenit 418-a, parashihen sanksione për ata persona të cilët do të marrin ose do të zhdukin letërnjoftimi, pasaportë ose dokument tjetër identifikimi për shkak të kryerjes së veprës. Sipas po të njëjtit paragraf të këtij të këtij neni prej vitit 2002 e deri më tash në Republikën e Maqedonisë nuk është paraqitur asnjë fletëparaqitje penale<sup>25</sup>.

<sup>23</sup>Njëherësh ritet disharmonia në mes të numrit të personave të paraqitur dhe të dënuar. Sipas disa autorëve situata e këtillë karakteristike edhe për krimin e përgjithshëm në RM ndodh për dy supozime: ose numri i personave të paraqitur ritet për shkak të qëndrimit jo të ndërgjegjshëm të policisë e cila rastet i përpunon jo mjaft të dokumentuar dhe shumë lehtë bëjnë fletëparaqitje, ose fletëparaqitjet nuk gjejnë realizim në procedurën e prokurorisë e cila gjithnjë e më shumë ngadalësohet, Vlado Kambovski, E drejta Penale – Pjesa e përgjithshme, Shkup, 2004, faqe 247, ngjashëm Vllado Kambovski, Krimi i Organizuar, Shkup, 2005, faqe 138.


<sup>24</sup>Transplantimi i palejuar i pjesëve të trupit të njeriut është veprë e sanksionuar në nenin 210 të KP.

<sup>25</sup>Në përputhje me të dhënat e Entit Republikan të Statistikës (përfundimisht me vitin 2004).

## 6. Ndërmjetësimi në kryerjen e prostitucionit dhe tregtisë me njerëz

Të dhënat për gjendjen me numrin e personave të paraqitur, të akuzuar dhe të dënuar për veprë penale "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit" në periudhën prej vitit 2000 deri më 2004 në R të Maqedonisë janë konstantë në lëvizjen e kësaj dukurie. Oscilime të vogla ekzistojnë sa i përket numrit të personave të paraqitur në vitin 2003 kur shënohet rritje e vogël, si edhe në raport me personat e përgjithshëm të dënuar më vitin 2001 dhe 2002. Në të njëjtën kohë në këto dy vite për dallim prej tjerave, mund të konstatohet edhe rritja e shpërpjesëtimit ndërmjet personave të akuzuar dhe të dënuar.

Ndërmjetësim gjatë prostitucionit



Në vitin 2005 deri në fund të muajit shtator, para gjyqeve themelore në Maqedoni janë mbikëqyrë 14 lëndë në lidhje me veprën "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit". Gjatë analizës krahasuese të karakteristikave subjektive dhe objektive të veprave për të cilat është ngritur aktakuzë, përkatësisht është marrë aktvendim sipas neni 191, fitohet përshtypja juridike se diskriminimi ndërmjet këtyre dy veprave nuk është përcaktuar qartë në praktikë. Në të vërtetë, veprimet të cilat janë karakterizuar si veprë penale "Tregti me njerëz" në lëndë tjetër janë përfshirë me veprë penale "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së profesionit".

Shkaqet për trajtimin e këtyre të kësaj problematike mund të kërkohen në më shumë drejtime. Së pari duhet të merret parasysh tendenca mjaft logjike e aktakuzës të orientohet në pajtim me "me atë që mund të dëshmohej", e jo ajo që ndoshta tërë ngjarjen penale ta mbajë me vete. Më tutje, me rëndësi janë ndryshimet që ndodhën me ndryshimet ligjore në këtë lëmi në vitin 2002 dhe 2004, si dhe shpejtësinë me të cilën përshtatet praktika me këto ndryshime.

Nëse kësaj i shtohet çështja e vlefshmërisë së përkohshëm të ligjeve në Maqedoni, përkatësisht merret parasysh se ngjarjet në një numër jo aq të rëndësishëm të lëndëve të cilat sot e përjetojnë shturjen gjyqësore para gjyqeve tona themelore që kanë ndodhur para vitit 2002, përkatësisht para se të inkriminohej vepra "Tregti me njerëz", duket se pak punët komplikohen<sup>26</sup>.

Në të vërtetë, duke marrë parasysh se zbatohet Kodi penal i cili ka qenë në fuqi gjatë kohës së kryerjes së veprës, ato veprime të kryera para vitit 2002, të cilat po të ndodhnin sot do të radhiteshin nën kategorinë ligjore të veprës penale "Tregti me njerëz", tash radhiten nën veprën "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit" nga shkakut se atëherë vepra "Tregti me njerëz" as që ka ekzistuar.

<sup>26</sup> Dragan Tumanovski, Tregtia me njerëz, Revia Gjyqësore, 2002, nr.4, faqe.33.

## 7. Kontrabanda me migrues dhe tregtia me njerëz

Në bazë të të dhënave modeste nga gjithsej gjashtë lëndë të mbikëqyra në lëmin e kontrabandës së migruesve, mund të përfundohet se të gjitha aktakuzat i dedikohen paragrafit 2 të nenit 418-b të KP.

Në të vërtetë, është fjala për transportin e mërgimtarëve (shtetas të Shqipërisë, Turqisë dhe Perusë) për kompensim i cili lëviz prej 400-7500 denarë<sup>27</sup> me qëllim të kalimit ilegal të kufirit maqedono-grek. Numri i vogël i lëndëve lidhur me veprën penale "Kontrabandë me mërgimtarë" që është pasojë e faktit që e njëjta relativisht vonë është inkorporuar në KP, paraqet bazë të pamjaftueshme për miratimin e çfarëdo qoftë konkluzionesh<sup>28</sup>. Megjithatë, se praktika gjyqësore tashmë ballafaqohet me probleme të caktuara në temën përkatëse, na tregon shembulli vijues:

**Në një lëndë të vëzhgvar para gjykatës themelore në Tetovë (Tet 006) është marrë akt i vendimit në pajtim me të cilin dy persona lirohen nga aktakuza sipas nenit 418-b paragrafi 2 (veprim në ekzekutim strehim mërgimtarësh). Vepra (është fjala për veprë të përhershme penale) ka filluar në muajin prill 2002. dhe gjendja e saj kundërligjore ka zgjatur deri në muajin 11 2004. Duke u nisur nga neni 30 i KP në pajtim me të cilin vepra është bërë në kohën kur kryerësi ka punuar ose ka qenë i detyruar të punojë pa marrë parasysh kur është krijuar pasoja si dhe të nenit 3 të PK i cili parasheh se ndaj kryerësit do të zbatohet ligji që ka qenë në fuqi gjatë kohës së kryerjes së veprës, por nëse ligji ndryshon do të vlejë ligji që është më i butë për kryerësin, gjyqi ka konsideruar se meqë inkriminimi i veprës kontrabandë mërgimtarësh është kryer me ndryshimet ligjore në muajin prill 2004, d.m.th. në kohën kur është kryer vepra e njëjta nuk është paraparë si e tillë, se të akuzuarit nuk mund të përgjigjen për atë veprë.**

Te veprat e përhershme penale (siç është vepra "Kontrabandë me mërgimtarë", veprim të kryerjes – strehimit të të njëjtëve), si kohë e kryerjes së veprës konsiderohet kohëzgjatja e gjendjes kundërligjore, përkatësisht si kohë e veprimit konsiderohet e veprimit konsiderohet deri sa kryerësi e ka mbajtur ose e ka mënjanuar gjendjen kundërligjore<sup>29</sup>.

Në të kundërtën do të vinim në shthurje absurde në situata të ngjashme që gjendja paraprake kundërligjore të zgjasë, kurse kundër kryerësve të mos mund të ndërmerren kurrfarë reperkusionesh.

<sup>27</sup> Prej 6-125 EUR.

<sup>28</sup> Për aktivitetet e MPB-së në fushën e kontrabandës së migruesve, shih: [www.mvr.gov.mk](http://www.mvr.gov.mk).

<sup>29</sup> Vllado Kambovski, Vepra ndëshkuese të përhershme dhe vepra ndëshkuese të gjendjes, E drejta ndëshkuese, Shkup 2004, f.454.




## 3

## Të drejtat e viktimës

Varësisht nga ajo se viktima e veprës penale "Tregti me njerëz" ose "Ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit", në procedurën para gjykatës në fazën e shqyrtimit kryesor paraqitet vetëm si dëshmitar, si person i dëmtuar ose në mënyrë kumulative si dëshmitar dhe person i dëmtuar është përcaktuar pozita proceduese e të njëjtës, d.m.th. vëllimi dhe lloji i aktiviteteve të cilat mund t'i ndërmerret në procedurën para gjyqit, përkatësisht të drejtat që i takojnë sipas procedurës së LPP<sup>30</sup>.

Në 73% të lëndëve, viktima ka paralajmëruar kërkesë pronësore-juridike, deri sa në 27% paraqitet vetëm si dëshmitar në procedurë<sup>31</sup>.



### E drejta për kompensim

Viktima e tregtisë me njerëz, si "person ndonjë e drejtë personale ose private e të cilit është cenuar ose rrezikuar me veprën penale"<sup>32</sup>, me paraqitjen e propozimit për realizimin e kërkesës pronësore-juridike d.m.th. kompensim të dëmit<sup>33</sup>, në procedurën penale merr pozitën e subjektit procesor<sup>34</sup>. Domethënë, viktima e cila paraqitet si person i dëmtuar në procedurë, edhe pse nuk është bartëse te asnjërës nga funksionet themelore në procedurën penale, përkatësisht nuk është procedurë procedimi, ka rol mjaft aktiv dhe mundësi të ndikojë në rrjedhën e gjyqimit<sup>35</sup>.

<sup>30</sup> (Gazeta Zyrtare e RM 15/97;44/02;74/04 ) në tekstin e mëtejshëm LPP

<sup>31</sup> Duke marrë parasysh faktin se është fjala për lëndë ende të pa përfunduara, është reale të pritet që përqindja e lëndëve në të cilat paralajmërohet kërkesë pronësore juridike të rritet.

<sup>32</sup> neni. 139, p. 5 i LPP

<sup>33</sup> Kërkesa pronësore juridike mund të paraqitet si për kompensim të dëmit ashtu edhe për kthimin e sendeve ose të suprimimit të punës së caktuar juridike. Shik kreun 6

<sup>34</sup> Vanko Pavlovski, Pozita e të dëmtuarit në procedurën penale, Revia gjyqësore 1996, nr 5, faqe. 30

<sup>35</sup> Ivanço Stojanov, I dëmtuari si subjekt i tërthortë në procedurën penale, Revia maqedonase për të drejtën ndëshkimore dhe kriminologji faqe 51.



Me vetë faktin se në të njëjtën kohë personi i dëmtuar paraqitet edhe si dëshmitar gjatë procedurës, me këtë nuk ndryshon dukshëm pozita proceduese e viktimës. Përbashëtim paraqet dispozita e nenit 55 paragrafi 3 i LPP në pajtim me të cilin e drejta e të dëmtuarës për të shikuar lëndët dhe shkrimet të cilat shërbejnë si mund të kufizohet deri në momentin kur ajo do të vihet në pyetje si dëshmitar.<sup>36</sup>

Mirëpo, kur viktima është vetëm dëshmitar në procedurë, por jo edhe person i dëmtuar, situata pak ndryshon. Gjegjësisht, si dëshmitar thirret person për të cilin dihet se do të mund të jep njoftim për veprën penale, për kryerësin ose për rrethana tjera të rëndësishme. Personi është i detyruar t’i përgjigjet ftesës së gjykatës dhe të shprehet personalisht.

Domethënë, derisa pjesëmarrja e të dëmtuarës në procedurë zhvillohet vullnetarisht dhe varet vetëm nga dëshira e saj të kyçet në proces, pjesëmarrja e dëshmitarit është e domosdoshme dhe varet nga vlerësimi i lirë i gjykatës për nevojën për të dëgjuar atë.

Mirëpo, kjo e fundit vetëm në rast se viktima ende qëndron në R të Maqedonisë. Nëse viktima veç më është kthyer në vendin amë, paraqitja e saj në gjykatën e Maqedonisë, në pajtim me marrëveshjet bilaterale mes Maqedonisë dhe vendit nga i cili ka prejardhje viktima, varet nga vullneti i lirë.

Nga gjithsej 15 lëndë të gjykuara në lidhje me veprat penale ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit dhe tregtisë me njerëz, në periudhën prej Janarit deri në Shtator të vitit 2005<sup>37</sup>, asnjë kërkesë për dëmshpërblim pronësoresh juridik nuk është realizuar. Në disa lëndë pritet sjellja e aktakuzës plotësuese në lidhje me të njëjtën.


Në R të Maqedonisë vetëm në dy lëndë deri në fund të Shtatorit 2005 është gjykuar dëmshpërblim material në lartësi prej 98.023 den.

## E drejta për person të autorizuar

Viktima si person i dëmtuar në procedurë mund të realizojë të drejtën e tij përmes personit të autorizuar. Person i autorizuar është ai që ka pëlqimin të ndërmer veprime procedimi gjatë veprimeve procedimi të procedurës penale në emër dhe në interes të viktimës.

Në të gjitha lëndët e vëzhguara në lidhje me "Tregtinë me njerëz" dhe "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit" në të cilat viktimit paraqitet si person i dëmtuar gjatë procedurës, atë e përfaqëson person i autorizuar<sup>38</sup>.

Andaj, personi i autorizuar, në 24% nga numri i përgjithshëm i seancave nuk është paraqitur në procedurën para gjykatës.



<sup>36</sup> Ligji përcakton edhe renditjen e marrjes në pyetje nëse i dëmtuari paraqitet edhe si dëshmitarë në procedurë. Në të vërtetë, dëgjimi do të kryhet menjëherë pas marrjes në pyetje të të akuzuarit.

<sup>37</sup> Në Republikën e Maqedonisë deri më tani nuk është marrë vendim për kompensim të dëmit jo material viktimës së tregtisë me njerëz në lëndët në gjykatat themelore.

<sup>38</sup> Në RM nuk ekziston mënyrë institucionale e dhënies së ndihmës juridike. Në të gjitha lëndët në lidhje me tregtinë me njerëz viktimat (vetëm me shtetësi të huaj) kanë qenë të përfaqësuar nga persona të angazhuar nga organizata ndërkombëtare e migrimit (IOM).

Në lëndën e vëzhguar në Gjykatën Themelore të Tetovës (Tet 005) në lidhje me veprën penale 418-a, në seancën e parë, personi i autorizuar i të dëmtuarës ka qenë i detyruar nga gjykatësi të sjellë autorizimin nga viktimata për seancën e ardhshme e cila është caktuar për tre ditë më vonë. Për arsjeja se personi nuk ka pasur mundësi të sjellë autorizim për periudhë aq të shkurtë, edhe pse gjykata ka konstatuar se ka ekzistuar autorizim nga viktimata në hulumtim, personi i autorizuar nuk ka pas rol aktiv gjatë procedurës. Aktakuza e lëndës është sjellë në po atë seancë, kurse, duke pasur parasysh se propozim për realizimin e kërkesës pronësoro juridike nuk është parashtruar (viktimata nuk është e pranishme), viktimës nuk i është mundësuar e drejta për dëmshpërblim.

Kur viktimata paraqitet vetëm si dëshmitar gjatë procedurës, nuk ka të drejtën për person të autorizuar.

## E drejta e viktimës që të jetë e pranishme

Viktimata, që paraqitet si e dëmtuar gjatë procedurës, në pajtim me nenin 273 paragrafi 1 nga LPP, thirret në shqyrtimin kryesor. Andaj, duke pasur parasysh se në rastet e vëzhguara, viktimata thirret në shqyrtimin kryesor, pasi që paraprakisht u ka kthyer nga shteti amë, ftesa dërgohet në pajtim me dispozitat e LPP për dhënien e ndihmës ndërkombëtare juridike dhe realizimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për lëndët penale juridike.

Në suazat e 26 lëndëve të përcjella (nga gjithsej 32)<sup>39</sup> në lidhje me veprat penale "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit" dhe "Tregtisë me njerëz" vetëm në 17 raste (nga gjithsej 54 viktimata<sup>40</sup>) me ndihmën e qendrës SECI<sup>41</sup> është mundësuar prania e viktimave dëshmitarë gjatë procedurës. Andaj, në 54% nga këto, bëhet fjalë për shtetase të Moldavisë, 8% të Republikës së Shqipërisë, 8% të Serbisë dhe Malit të Zi (Kosovë), 15% të Romanisë dhe 15% të Republikës së Maqedonisë. Në 9 situata, për shkak të mungesës së kushteve për realizimin e shqyrtimit kryesor, gjykatësi ka sjellë vendim për shqyrtim të të dëmtuarës/viktimës/dëshmitarit jashtë shqyrtimit kryesor.

## Të informuarit në lidhje me të drejtat e saj

Përderisa viktimata nuk ka vënë propozim për realizimin e kërkesës pronësoro juridike deri në ngritjen e aktakuzë procedurës penale, gjykata e informon se atë propozim mund ta vejë deri në kryerjen e shqyrtimit kryesor.

Viktimata e cila thirret si dëshmitar në procedurën, para se të jep qëndrimin e saj, medoemos ti tërhiqet vëmendja se është e obliguar të flet të vërtetën dhe nuk guxon të hesht për asgjë, e njëherësh t'i tërhiqet vëmendja se dhënia e qëndrimit të rrejshëm paraqet veprë penale. Gjatë procedurës në gjykatat tona, viktimës dëshmitar asnjëherë nuk i tërhiqet vëmendja.

Viktimata-dëshmitar, po ashtu, medoemos të informohet se nuk është e detyruar të përgjigjet pyetjeve të veçanta, nëse është e dukshme se me atë do të mbarojë, do të shkaktojë dëm të konsiderueshëm materia ose do të shkaktojë ndjekje penale për atë apo ndonjë të afërmin e saj.

<sup>39</sup> Gjashtë lëndë i përkasin veprës penale, kontrabandë të migruesve".

<sup>40</sup> Të gjitha janë persona të gjinisë femërore.

<sup>41</sup> Me rëndësi thelbësore për sigurimin e pranisë së dëshmitarëve viktimata të tregtisë me njerëz në procedurën gjyqësore në R të Maqedonisë ka qendra SECI (Southeast European Cooperative Initiative). Ajo paraqet mision të pavarur diplomatik me status të personit juridik ndërkombëtar regjistruar në Bukuresht – Rumani, që vepron në bazë të Marrëveshjes për bashkëpunim dhe preventive në pengimin e krimit tej kufitar. Në vitin 2004 Sektorit për Bashkëpunim ndërkombëtar në Sektorin e Krimit të organizuar në MPB janë dorëzuar 20 kërkesa për gjetjen e 48 dëshmitarëve-viktimata të tregtisë me njerëz ose për prostitucion të detyruar (10 prej GJTH Gostivar; 6 prej GJTH Tetovë; 2 prej GJTH Ohër dhe nga një në GJTH Shkup dhe GJTH Strugë). Si rezultat i veprimit të qendrës SECI në Bukuresht janë gjetur 15 dëshmitarë të kërkuat (11 janë pajtuar që të dëshmojnë).

Nga gjithsej 32 lëndë të vëzhguara në lidhje me tregtinë me njerëz në të gjitha gjykatat themelore në Maqedoni në 9<sup>42</sup> nga ato, dëshmitarit nuk i është vënë në dije kjo e drejtë, edhe pse në nenin 223 paragrafi 2 parashihet ky obligim<sup>43</sup>. Në 74% të rasteve të mos informimit bëhet fjalë për dëshmitar viktimë e tregtisë me njerëz.

Viktimës do ti bëhet e ditur e drejta për përkthyes nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet procedura.

## **E drejta për të propozuar dëshmi të reja**

Viktima ka të drejtë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të propozojë të nxjerrin fakte të reja dhe të gjenden dëshmi të reja<sup>44</sup>

Në pajtim me analizat e të dhënave nga lëndët e vëzhguara, në më tepër se ¾ e rasteve, gjatë shqyrtimit kryesor, personi i autorizuar i viktimës nuk ka propozuar gjetjen e dëshmive të reja.

Në një lëndë të vëzhguar në gjykatën themelore të Gostivarit (Gov 007) në lidhje me veprën penale ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit, personi i autorizuar me parashtrimin me shkrim për kërkesë për dëmtim ka kërkuar nga gjykata po atë ditë të caktohet ekspertizë neuro-psikiatrike për dëm jo material, me faktin se viktima ka qenë e pranishme. Për shkak të pamundësisë së dukshme që të organizohet kjo, propozimi i personit të autorizuar është refuzuar.

Në lëndë që është vëzhguar në gjykatën themelore në Tetovës (Tet 001) në lidhje me veprën penale 418-a, personi i autorizuar i të dëmtuarës gjatë tentimit të inkuadrohet në procedurë me dhënien e propozimit për nxjerrjen e ndonjë dëshmisë, ka qenë i ndërprerë me arrogancë nga mbrojtësi i njërit nga të akuzuarve, me shpjegim se ai ka të drejtë vetëm të shtrojë kërkesë pronësoro juridike, jo edhe të kyçet në procedurë. Personi i autorizuar është tërhequr, kurse kryetari i këshillit ka vazhduar më tutje me procesin e nxjerrjes së dëshmive<sup>45</sup>.

## **E drejta për tu parashtruar pyetje dëshmitarëve, ekspertëve dhe të akuzuarve**

Viktima/e dëmtuar gjatë procedurës, me leje nga kryetari i këshillit mundet në mënyrë të drejtpërdrejtë t’u parashtrrojë pyetje dëshmitarëve dhe ekspertëve. Kjo e drejtë është përdorur në 1/3 e rasteve të vëzhguara<sup>46</sup>

## **E drejta për të arsyetuar kërkesën pronësoro juridike**

E dëmtuara ka të drejtë, pas përfundimit të procedurës së dëshmive, jo vetëm të arsyetojë kërkesën pronësoro juridike, por edhe të ndërmerë qëndrim dhe ti analizojë dëshmitë e nxjerra nga të cilat jo vetëm që varet përgjegjësia penale e të akuzuarit por edhe fati i kërkesës pronësoro juridike.

---

<sup>42</sup> Në një lëndë në gjykatën themelore të Tetovës, në procesverbal vetëm është konstatuar se dëshmitari është informuar për të drejtën nga neni 223 i LPP, pa kumtuar në të vërtetë.

<sup>43</sup> Prej gjithsej 8 lëndëve në të cilat dëshmitari nuk ka qenë i informuar për të drejtën që të mos përgjigjet në pyetje të caktuara, në gjashtë prej tyre bëhet fjalë për dëshmitarë viktimë në procedurë

<sup>44</sup> neni. 314 p. 5 nga LPP


<sup>45</sup> Në këtë mënyrë e drejta e të dëmtuarës që të propozojë dëshmi në situatën konkrete i është shkurtuar

<sup>46</sup> Zakonisht i autorizuari i të dëmtuarës në procedurë i shtron pyetje dëshmitarit viktimë. Vetëm në një lëndë të vëzhguar janë shtuar pyetje edhe të akuzuarit lidhur me gjendjen e tij materiale me qëllim që të precizohet kërkesa për kompensim të dëmit.

Në lëndët e vëzhguara të Koalicionit, personi i autorizuar i viktimës së dëmtuar, më së shpeshti në mënyrë të shkruar ka parashtruar kërkesën pronësoro juridike. Vetëm në tre raste, kjo kërkesë ka qenë gojarisht e arsyetuar në fjalët përfundimtare të shqyrtimit.

Në lëndët e vëzhguara nga Koalicioni, i autorizuari i viktimës së dëmtuar, më së shpeshti me shkrim e paraqet kërkesën pronësore juridike. Vetëm në tre raste e njëjta ka qenë e arsyetuar gojarisht në fjalët përfundimtare gjatë shqyrtimit.

## E drejta e përkthimit



Viktima qoftë të paraqitet si dëshmitar ose si i dëmtuar në procedurë ka të drejtë në përkthyes pa pagesë, nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e procedurës<sup>47</sup>. Edhe pse

Problemi me përkthimin adekuat në gjuhën e viktimës e cila më së shpeshti është i huaj, përmendet si ndër problemet më të mëdha me të cilat përballet gjyqësia posaçërisht në sferën e tregtisë me njerëz, megjithatë, sipas analizës sonë mund të

vërehet se përkthimi gjatë marrjes në pyetje të viktimës, ka qenë në nivel të kënaqshëm. Vetëm në një rast përkthimi i siguruar për shkak të marrjes në pyetje të viktimës si dëshmitar, ka qenë me cilësi të dobët. Në të dy lëndët viktimat, shtetas i huaj, ka deklaruar se e kupton gjuhën maqedonase dhe me këtë gjuhë është shërbyer në shqyrtimin kryesor.<sup>48</sup>

## E drejta e mbrojtjes

Me futjen e nenit 223-a në Ligjin e procedurës penale, dëshmitarit i mundësohet ta shkurtojë paraqitjen e të dhënave personale (emrin dhe mbiemrin, emrin e babait, profesionin, vendqëndrimin, moshën dhe raportin me të akuzuarin) nëse supozohet se me dhënien e dëshmisë ose përgjigjes në pyetje të caktuar, do ta vinte në rrezik serioz të jetës, shëndetit ose integritetit fizik, veten ose ndonjë person të afërt .

Njëherësh dëshmitarit i cili e ka shkurtuar paraqitjen e të dhënave të lartpërmendura, nëse konfirmohet se ka bazë ekzistimi i rrezikut, në afat prej 24 orësh i sigurohet mbrojtje përmes përfshirjes në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve.<sup>49</sup>

Përveç përfshirjes në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve në përputhje me legjislacionin tonë, mund të ndërmerren edhe veprime që kanë të bëjnë me mënyrën e posaçme të marrjes në pyetje të dëshmitarit. Veprimet kanë të bëjnë me marrjen në pyetje të dëshmitarit vetëm në prani të prokurorit publik dhe gjyqtarit hetues, përkatësisht kryetarit të këshillit, në vend që të sigurojë mbrojtjen e identitetit të tij, përveç nëse me pëlqimin e dëshmitarit këshilli nuk vendos ndryshe që marrja në pyetje të bëhet përmes gjykatës ose me shfrytëzimin e mjeteve të tjera teknike adekuate të komunikimit<sup>50</sup>.

<sup>47</sup> neni. 7 p.2 nga LPP

<sup>48</sup> Në dy lëndë të vëzhguara në gjykatën themelore në Manastir dhe në Gj.Th në Gostivar, viktime është shtetase e Maqedonisë

<sup>49</sup> Shih Kreun Mbrojtja e dëshmitarëve

<sup>50</sup> neni. 270-a p.3 nga LPP

Mënyra e posaçme e marrjes në pyetje të dëshmitarit përmes gjykatës në ndonjë vend tjetër, përveç gjykatores, deri më tash nuk është përdorur në asnjë lëndë të mbikëqyrrur.

Në periudhën e nxjerrjes së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin (LNP) e Ligjit të procedurës penale (LPP)<sup>51</sup> deri në muajin shtator 2005, në kuadër të të gjitha lëndëve të vëzhguara, marrja në pyetje e dëshmitarit përmes video konferencës është zhvilluar vetëm në një rast.

## **E drejta e gjykimit në të cilin është përjashtuar publiku**

Duke marrë parasysh ndjeshmërinë e lëndëve lidhur me tregtinë me njerëz, e duke u nisur para së gjithash nga nevoja për t’i ikur viktimizimit sekondar të viktimës, çështja e përjashtimit të publikut gjatë tërë shqyrtimit ose vetëm gjatë dhënies së dëshmisë nga e njëjta, meriton vëmendje të veçantë.

LPP yni në nenin 280 parasheh mundësinë e përjashtimit të publikut, ndër të tjera edhe për shkak të mbrojtjes së moralit dhe të personalitetit të dëshmitarit ose të dëmtuarit, si dhe për shkak të mbrojtjes së interesave të të miturit<sup>52</sup>.

Në pajtim me të dhënat nga vëzhgimi i lëndëve vetëm në tre lëndë është marrë vendim për përjashtimin e publikut. Në rastin e parë është fjala për mbrojtjen e interesave të viktimës së mitur, në rastin e dytë me propozimin e palëve, përkatësisht të mbrojtësve të të akuzuarve publiku është mënjeluar nga gjykatëria gjatë kohës së dhënies së dëshmisë së viktimës së dëmtuar në procedurë, ndërsa në rastin e tretë është përjashtuar publiku gjatë tërë shqyrtimit për shkak të mbrojtjes së moralit dhe jetës personale të dëshmitarit të dëmtuar.

Meritojnë vëmendje edhe të dy situatat kur mbrojtësit e të akuzuarve në procedurë kanë kërkuar mënjanimin e personave të sigurimit të cilët kanë shoqëruar viktimën me arsyetim se të njëjtët mund të ndikojnë në dhënien e dëshmisë së të dëmtuarës-dëshmitare. Në rastin e dytë kryetari i Këshillit gjyqësor duke u shprehur negativisht lidhur me çështjen e përjashtimit të publikut (shqyrtimi është publik) i ka lutur personat e sigurimit që të tërhiqen një rresht prapa ulëses së viktimës. Në rastin e dytë vendimi për përjashtimin e publikut nuk është marrë, kurse përfaqësuesit e sigurimit të viktimës<sup>53</sup> janë lutur të tërhiqen nga gjykatëria.

Largimi i personave nga gjykatëria, në praninë e të cilëve viktimat është ndier më e sigurt dhe të cilët gëzojnë besimin e saj, është në kundërshtim me praktikën e mirë për mbrojtjen e dëshmitarëve gjatë procedurës.

Vëzhguesve të Koalicionit vetëm në një rast nuk u është lejuar që të hyjnë në zyrën e gjykatësit në të cilën është mbajtur seanca, me arsyetim se lënda do të shtyhet.

## **Mundësia për marrjen në pyetje të viktimës pa praninë e të akuzuarit**

Këshilli në situata të jashtëzakonshme mund të vendosë ta largojë përkohësisht të akuzuarin nga gjykatëria nëse viktimat- dëshmitarë refuzon të japë deklaratë në praninë e tij ose nëse rrethanat vënë në dukje se në praninë e tij nuk do ta flasë të vërtetën.<sup>54</sup>

---

<sup>51</sup> Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për procedurë penale (Gazeta Zyrtare e Rm 74/04) të 22.10.2004, në tekstin e mëtejshëm LNP të LPP

<sup>52</sup> Vetëm në katër raste është fjala për viktimë të mitur (prej gjithsej 54 personave)

<sup>53</sup> Dy përfaqësues të ministrisë së punëve të brendshme dhe një person zyrtar i autorizuar nga Rumania

<sup>54</sup> Sipas ligjit Gjerman për Procedurë Penale, neni 247, përjashtimi i të akuzuarit gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit lejohet kur: ekziston frika se dëshmitari nuk do ta thotë të vërtetën është përfshirë një barë serioze e mirëqenies së dëshmitarit i cili është më i vogël se 16 vjeç, ekziston rreziku ekstrem nga keqësimi serioz i shëndetit të dëshmitarit, OSBE/ODIHR, Mekanizma Nacionale për udhëzim, Bashkim i përpjekjeve për mbrojtjen e të drejtave të personave që janë objekt i tregtisë, 2004, Doracak Praktik.

Në kuadër të lëndëve të vëzhguara në asnjë situatë viktimë- dëshmitar nuk ka refuzuar të japë dëshmi në praninë e të akuzuarit, e as që Këshilli ka vendosë ta përjashtojë të akuzuarin nga gjykatorja.

## **Trajtimi i viktimës pa e mëshiruar dhe me respekt**

Mënyra e marrjes në pyetje të viktimës – dëshmitar në shqyrtimin kryesor mund të ketë rëndësi esenciale për zhvillimin e procedurës dhe të njëjtën kohë për përcaktimin e ekzistimit, kualifikimit të veprës penale, si dhe për përcaktimin e përgjegjësinë së kryerësit. Marrja në pyetje e dëshmitarit gjatë procedurës përbën një materie mjaft të ndjeshme, veçanërisht nëse dëshmitari i takon ndonjërit nga grupet e dëshmitarëve të lëndueshëm.<sup>55</sup> Duke u nisur nga karakteristikat e veçanta psikofizike të dëshmitarit<sup>56</sup> grua<sup>57</sup>, agresioni dhe dhuna të cilave u është nënshtruar gjatë eksploatimit, intimidimit me të cilin është ndjekur kryerja e veprës si dhe për shkak të karakteristikave individuale, arsimimit dhe nivelit intelektual të viktimës, është e domosdoshme që të gjitha subjektet gjatë procedurës<sup>58</sup> të sillen në mënyrë adekuate<sup>59</sup>. Në të vërtetë, jo vetëm që trajtimi i viktimës me respekt paraqet një imperativ të domosdoshëm për shoqërinë e cila si parësore e ka respektimin e të drejtave themelore të njeriut, mënyra e këtillë ndonjë herë paraqet parakusht për rehabilitimin e viktimës dhe rianimimin e aftësisë së saj për kthim në jetën normale, e në të njëjtën kohë reflektohet në formimin e vullnetit të saj që të ndihmojë në procedurën gjyqësore<sup>60</sup>.

## **Konkluzion:**

**LPP mundëson kornizë përkatëse për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimës gjatë procedurës, qoftë të paraqitet ajo si dëshmitar ose si person i dëmtuar. Megjithatë, jo konsekuenca në zbatimin e dispozitave ligjore (veçanërisht atyre të përfshirë me LNP të LPP) të cilat i dedikohen: mbrojtjes dhe mënyrës së veçantë të marrjes në pyetje të dëshmitarit në procedurë, vendosjes sipas kërkesës për kompensimin e dëmit në kuadër të procedurës penale, informimit të viktimës për të drejtat e saj dhe para së gjithash, mundësimin të rolit më aktiv në procesin kundër kryerësve të veprave penale lidhur me tregtinë me njerëz shkakton dobësimin e pozitës së viktimës në procesin gjyqësor.**

## **Rekomandim:**

**Ekziston nevojë për ndërtimin e një mekanizmi të bazuar mbi ligj ose akt nënligjor i cili do të mundësojë qasje të shpejtë të të gjitha viktimave (jo vetëm të viktimave shtetase të huaja) deri të ndihma adekuate juridike në procedurën kundër kryerësve të veprave penale.**

<sup>55</sup> Sipas disa autorëve në kategorinë dëshmitarë të ndjeshëm hyjnë: Dëshmitarët me pengesë në zhvillim, dëshmitarët me hendikep fizik, dëshmitarët me pengesa mentale dhe dëshmitarët që vuajnë nga frika dhe stresi

<sup>56</sup> Ndjeshmëria e shprehur më shumë ose më pak, vëzhguesi i shpejtë dhe mendjemprehtë i anëve afektive dhe seksuale të ngjarjes, e shpreh kanë ndikim vendimtar në jetën psikike dhe në reagimet e saj... Matovski, E drejta Ndëshkimore e Procesit, Pjesa e përgjithshme 2003 Shkup

<sup>57</sup> Në të gjitha lëndët e vëzhguara viktimat e tregtisë me njerëz janë femra

<sup>58</sup> Agim Miftari, Etika Profesionale në gjyqësi, prokurori dhe avokaturë dhe relacionet e tyre të ndërsjella, Revia gjyqësore, 2002, nr.3 faqe 22

<sup>59</sup> Oliver Baçanoviç, Policia dhe viktimat Shtip, 1998

<sup>60</sup> Doracak për trajnim "zhvillim i modelit për trajnimin dhe PP në sferën e luftës kundër tregtisë me njerëz"-2003.



## 4

*I akuzuari***8. Profili i të akuzuarit**

Duke marrë parasysh faktin se veprat penale "Tregti me njerëz", "ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit" dhe "kontrabandës me mërgimtarë" i kryejnë persona edhe femra dhe meshkuj të grupmoshave të ndryshme dhe me të kaluar, me arsimim e rreth të ndryshëm, përkatësisht persona që vepronë individualisht ose në grupe të vogla e deri te ata që janë pjesë të rrjetit ndërkombëtar mjaft kompleks dhe të organizuar mirë, është joreale të pritet se do të mund të përcaktohet një profil unik i kryerësve të këtyre veprave penale.

Megjithatë, përpunimi i të dhënave lidhur me personat e akuzuar në lëndët e vëzhguara para gjykatave themelore, në mënyrë sipërfaqësore mund të paralajmërojë se cilat karakteristika i posedojnë më shpesh kryerësit eventualë të këtyre veprave në kuadër të territorit të Maqedonisë.

**Struktura gjinore**

Pjesëmarrja e gjinisë femërore në popullatën e kryerësve të veprave penale lidhur me tregtinë me njerëz më Maqedoni mungon plotësisht. Në të vërtetë, në asnjë lëndë të vëzhguar nga ana e Koalicionit ( edhe pse në deklaratat e viktimave- dëshmitarë përmendet në mënyrë incidentale pjesëmarrja e personave femra<sup>61</sup> në formë të ndihmës së kryerësve të veprës), nuk është paraqitur aktakuzë kundër personit femër.


**Struktura e moshës**

Kufiri i moshës së personave të akuzuar lëviz prej 18 deri në 40 vjet. Me këtë rast grupmoshat prej 18 deri 25 vjet dhe prej 36 deri në 40 vjet mbizotërojnë me një numër më të madh të personave të akuzuar. Edhe pse është logjike rënia e numrit të kryerësve eventualë të veprave pas moshës 40 vjeçare ( grupi me numër më të vogël personash), befason e dhëna se në periudhën prej moshës 25 deri 35 vjeçare të jetës,

<sup>61</sup> Në lëndët e vëzhguara në GjTh Gostivar (Gos 001 dhe Gos 005) përveç të akuzuarit në ngjarjen kriminale paraqitet edhe një person femër e cila i pranon viktimat dhe informon se për ta janë dhënë shumë ta mëdha parash dhe se të njëjtat duhet të kthehen, përkatësisht të përpunohen". Ky person femër i pranon paratë nga klientët dhe e organizon dhënien e shërbimeve seksuale në barin e natës.




kur njeriu gjendet në fazën e pjekurisë së plotë dhe me energji dhe aftësi maksimale për aktivitet jete dhe pune, numri i personave të akuzuar zvogëlohet madje edhe për diç më shumë se gjysma në krahasim me grupet e para (për nga numri i personave).




### Përbërja nacionale

Personat e akuzuar të nacionalitetit shqiptar dominojnë madje me 74 % të numrit të përgjithshëm të të akuzuarve. Me përjashtim të një lënde ku të gjithë personat e akuzuar janë maqedonas, në të gjitha lëndët e vëzhguara, në kuadër të ngjarjes së njëjtë kriminale, maqedonasit paraqiten si bashkëkryerës së bashku me personat e nacionalitetit shqiptar.




### Niveli arsimor

Në mesin e personave të akuzuar dominojnë ata me arsimim të mesëm. Ndërkaq, pjesëmarrja e personave pa arsimim dhe personave dhe me arsimim të lartë në numrin e përgjithshëm të personave të akuzuar në kuadër të lëndëve të vëzhguara është minor, numri i personave të akuzuar me arsimim fillor vjen menjëherë pas atyre me arsimim të mesëm.




## Vendi i banimit

Si mbështetje të informatës së njohur mirë se vatra të tregtisë me njerëz në Maqedoni janë rajoni i Tetovës dhe Gostivarit, paraqet edhe fakti se numri më i madh i personave të akuzuar rrjedhin (jetojnë) pikërisht në këta rajone. Është i lartë edhe numri i personave të akuzuar të cilët kanë vendbanimi në Manastir, megjithatë për dallim nga qytetet e Tetovës dhe të Gostivarit prej nga më shpesh janë personat për ndërmjetësim me rastin e prostitucionit dhe tregtisë me njerëz, në Manastir vendbanim kanë kryesisht personat e akuzuar për veprë penale kontrabandë me mërgimtarë.





## Profesioni

Në numrin më të madh të rasteve në lëndët lidhur me tregtinë me njerëz bëhet fjalë për persona të akuzuar të cilët paraqiten si pronarë të bareve dhe kafeneve të natës.




## Recidivizmi

Recidivizmi si karakteristikë e jo efikasitetit të veprimit special- preventiv të dënimit mban shkallën e lartë edhe në veprat lidhur me tregtinë me njerëz. Në të vërtetë në 39% të rasteve bëhet fjalë për persona të akuzuar të cilët në mënyrë paraprake janë dënuar (mjaft shpesh për vepra të njëjta ose të ngjashme). Vetëm në 4% të situatave në lëndët lidhur me tregtinë me njerëz, personi i akuzuar paraqitet si ndihmës në 1: veprat penale.



## 9. Të drejtat e të akuzuarit në procedurën para gjykatës


Edhe përpos asaj se vëmendja e këtij hulumtimi nuk është drejtuar në pozitën e të akuzuarit në procedurën para gjykatës në lëndët nga fusha e tregtisë me njerëz, e as në shkallën vlerësimit të respektimit të të drejtave që i janë garantuar në pajtim me dokumentet e vendit dhe ato ndërkombëtare, megjithatë imponohet nevoja që vetëm në mënyrë të shkurtër të komentohen disa gjendje të cilat janë regjistruar në procesin e vëzhgimit. Në të vërtetë në 31% të situatave është kërkuar dhe është siguruar përkthim për të akuzuarin i cili nuk e kupton dhe nuk e flet gjuhën maqedonishte ( me shpesh nga gjuha shqipe në gjuhën maqedonishte).



Sa i përket këshillimit të të akuzuarit për **të drejtën e heshtjes**, imponohet konkluzioni se kryesisht e njëjta respektohet në procedurën para gjykatave themelore. Përrjashtim bëjnë situatat kur i akuzuari nuk është i informuar drejtpërdrejtë për të drejtat e tij, po e njëjta është shënuar në procesverbal nga ana e gjykatësit. Për fat të keq e vetmja situatë në të cilën është protestuar kundër praktikës së këtillë ka tërhequr me vete pasoja të padëshirueshme.

Në të vërtetë në lëndën e vëzhguar para Gjykatës themelore në Tetovë (Tet 008), në lidhje me veprën penale nga neni 418-a në KP, tregti me njerëz gjykatësi ka diktuar në procesverbal se i akuzuari e shfrytëzon të drejtën e mbrojtësit, të drejtën se nuk do të mbrohet me heshtje, si edhe atë se e ka kuptuar aktakuzën, pa e pyetur gojarisht. Për këtë ka kundërshtuar mbrojtësi duke insistuar që të futet në procesverbal se i akuzuari nuk është deklaruar në mënyrë të prerë! Në pyetjen e gjykatësit që i është bërë të akuzuarit se a e ka kuptuar aktakuzën dhe a është i përgatitur në aspektin shëndetësor që të japë deklaratë në shqyrtimin kryesor, ka pasuar përgjigja prej të akuzuarit se nuk e ka të njohur pse akuzohet, dhe se është njeri i sëmurë i cili momentalisht mjekohet! Gjykimi është shtyrë për 25 ditë me qëllim të konstatimit të aftësisë së të akuzuarit që të japë deklaratë. Shqyrtimi vijues në të cilin është i pranishëm edhe neuropsikiatri, shtyhet për 33 ditë për shkak të mungesës së të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij. Herën tjetër për shkak të mungesës së neuropsikiatrit i cili është ftuar me rregull, megjithatë nuk është paraqitur në seancën kryesore, shqyrtimi përsëri shtyhet për 78 ditë.

Personat e akuzuar rrallë herë e shfrytëzojnë të drejtën e heshtjes



E drejta e të akuzuarit që të jetë **i pranishëm në gjykim** respektohet në lëndët lidhur me tregtinë me njerëz. Në të vërtetë prej gjithsej 83 personave të akuzuar vetëm 2 persona gjykohen në mungesë. Në të dy rastet është fjala për persona të cilët janë në arrati.

Kryesisht, personat e akuzuar vetë zgjedhin **mbrojtësin e vet**<sup>62</sup>. Në disa situata në të cilat mbrojtësi u është caktuar me detyrë zyrtare i njëjti së shpejti është zëvendësuar me tjetër sipas zgjedhjes së vet.<sup>63</sup>

### **Konkluzion:**

**Përpunimi statistikor i të dhënave lidhur me personat e akuzuar në lëndët e vëzhguara para gjykatave themelore, jep të kuptohet se kryerësi eventual i ka këto karakteristika: person i gjinisë mashkullore me arsimim të mesëm i cili i përket grupmoshës prej 18 deri në 25 vjeç ose prej 36 deri në 40 vjeç, të kombësisë shqiptare, paraprakisht i dënuar, pronar i barit të natës.**

---

<sup>62</sup> Nikola Matovski, Roli i mbrojtësit në procedurën penale, Makedonska kniga, 1981, Shkup.

<sup>63</sup> Vetëm në një lëndë i akuzuari është mbrojtur vetë në procedurën në gjykatë.



## 5

*Mbrojtja e dëshmitarëve*

Dëshmitarët, veçanërisht dëshmitarët viktimë të tregtisë me njerëz kanë rëndësi esenciale për ndjekjen dhe sanksionimin me sukses të kryerësve të veprave penale lidhur me tregtinë me njerëz.

Meqë dëshmitarë viktimë rrallë herë i ekspozohen rrezikut nga intimidimi dhe kërcënimet për hakmarrje nga ana e trafikantëve me njerëz, sigurimi i masave speciale mbrojtëse është domosdoshmëri, nga njëra anë për shkak të sigurimit të deklaratës së dëshmitarit, të dhënë në procedurën policore ose në hetuesi, përkatësisht sigurimi i të njëjtës në shqyrtimin kryesor, pengimi i viktimizimit të serishëm e para së gjithash për shkak të mbrojtjes faktike të dëshmitarit para shqyrtimit, gjatë shqyrtimit dhe pas përfundimit të shqyrtimit nga ana tjetër.

Megjithatë gjatë zgjedhjes së masave mbrojtëse të personit i cili posedon informata me rëndësi për procedurën penale dhe jeta, shëndeti, liria ose prona e të cilit i ekspozohen rrezikut, dhe gjatë zgjedhjes së mekanizmave dhe mënyrës së implementimit të tyre në legjislaturë dhe praktikën e institucioneve kompetente, duhet ti kushtohet kujdes balancuar ndërmjet të drejtës së mbrojtjes së dëshmitarit dhe të drejtave të akuzuarit për gjykim publik dhe marrjes në pyetje të dëshmitarit<sup>64</sup> i cili e ngarkon<sup>65</sup>.

Organet për zhdukjen dhe sanksionimin e krimit të organizuar në rritje, duke përfshirë edhe tregtinë me njerëz, gjithnjë e më tepër ballafaqohen me problemin e refuzimit të dëshmisë ose ndryshimit të deklaratës nga ana e dëshmitarit për shkak të frikës nga hakmarrja. Në numrin më të madh të rasteve dëshmia e dëshmitarit/viktimës<sup>66</sup> në lëndët e tregtisë me njerëz paraqet dëshmi kyç për prokurorinë dhe prej saj varet në mënyrë të drejtpërdrejtë suksesi i procedurës kundër tregtarëve.<sup>67</sup>

<sup>64</sup> G. Kalajxhiev, E drejta e të akuzuarit që t'i sigurohet prani dhe marrje në pyetje e dëshmitarëve në dobi të tij, vjetor i fakultetit juridik në Shkup 1996/98, vëllimi 38, faqe. 571

<sup>65</sup> Sipas nenit 6 (3) nga Konventa Evropiane për të drejta të njeriut, i akuzuari ka të drejtë t'i marrë vetë në pyetje ose të autorizojë dikë tjetër që ti marrë në pyetje dëshmitarët të cilët e ngarkojnë, si dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në dobi të vet nën të njëjtat kushte që vlejnë për dëshmitarët të cilët e ngarkojnë. Parimisht të gjitha dëshmitë e prokurorisë duhet të paraqiten në praninë e të akuzuarit në shqyrtim publik me qasje në argumentet e palës kundërshtare. Prej asaj që u përmend më lartë fitohet përshtypja se dhënia e dëshmisë në lëndën penale nga ana e dëshmitarit, identiteti i të cilit është fshehur nën masa speciale mbrojtëse paraqet shkelje të dispozitave të KEPNJ. Amnesty International i kundërvihet shfrytëzimit të deklaratave të dëshmitarëve anonim-Gjykime të drejta-doracak, 22.2.1. Dëshmitarë anonim, faqe 148.)

<sup>66</sup> Një person mund të jetë dëshmitarë edhe pse nuk është viktime e tregtisë me njerëz dhe anasjelltas, mund të jetë viktimë e të mos dëshmojë në procedurën në gjykatë. Në disa raste këto dy kategori përputhen

<sup>67</sup> "Gatishmëria e viktimës të dorëzojë fletëparaqitje në polici dhe të veprjë si dëshmitarë në procedurë është thelbësore për hetimin dhe ndjekjen e tregtarëve me njerëz"- konkluzion nga mbledhja e mbajtur në Silloveni, mars 2003 me rastin e "masave të veçanta për mbrojtjen e viktimave të tregtisë me njerëz të cilët paraqiten si dëshmitarë në procedurë"- Pakti i stabilitetit-Evropa juglindore.

Në kuadër të aktivitetit ndërkombëtar për krijimin e mekanizmit preventiv dhe represiv për shpartallimin efikas të krimit të organizuar, duke përfshirë edhe tregtinë me njerëz, janë miratuar një numër i madh dokumentesh, Konventash (me protokolle), deklarata, porosi<sup>68</sup>.

Legjislaturat nacionale si përgjigje të sfidave të shtruara nga fenomeni ndërkombëtar i quajtur krim i organizuar në fushën e mbrojtjes së njerëzve të cilët paraqiten si dëshmitarë në procedurë, parashikojnë dispozita më të ndryshme edhe atë në kuadër të Ligjit për procedurë penale<sup>69</sup> (në vendet me drejtësi kontinentale) përkatësisht si akte<sup>70</sup> të veçanta (në vendet me drejtësi anglosaksone) të cilat paraqesin bazë mbi të cilën ndërtohet praktika e gjykatave si dhe në kuadrin e ligjeve të veçanta.

Në rastin e parë bëhet fjalë më shpesh për dispozita të cilat i dedikohen mbrojtjes së identitetit dhe anonimitetit gjatë hetimit dhe shqyrtimit kryesor para gjykatës në lëndët penale, derisa me ligjet e veçanta rregullohen kushtet për inkuadrimin e dëshmitarit në programet e veçante për mbrojtje<sup>71</sup>.

---

<sup>68</sup> **Konventa e Kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional**<sup>68</sup> në nenin 24 (mbrojtja e dëshmitarëve) parasheh obligimin që çdo shtet anëtare të miratojë masa përkatëse në kudër të mundësive të tij për sigurimin e mbrojtjes efikase nga hakmarrja potenciale ose kërcënimi i dëshmitarëve të cilët dëshmojnë në procedurat penale, si dhe për farefisën e tyre ose për persona tjerë të afërt me ta, ku është përshtatet. Njëherësh Konventa i obligon shtetet anëtare që ti shqyrtojnë mundësitë për hyrjen në marrëveshje ose aranzhime me shtete tjera për rikthimin e personave të përfshirë në tekstin e sipërpërmendur.

Dispozitat në nenin 25 të Konventës verifikojnë obligimin që çdo shtet të ndërmarrë masa përkatëse në kudër të mjeteve të veta që të sigurojë ndihmë dhe mbrojtje të viktimave<sup>68</sup> për vepra ndëshkimore të përfshira me Konventën, veçanërisht në rastet e kanosjes nga hakmarrja dhe kërcënimi.

**Protokoli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e tregtisë me njerëz, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, me të cilin plotësohet Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional** në nenin 6t.1 e obligon çdo shtet-anëtare, që në raste përkatëse dhe në atë masë e cila mundëson në pajtim me të drejtën e vendit të mbrojtje privatësinë dhe identitetin e viktimave të tregtisë me njerëz, përfshirë këtu edhe inter alia, duke miratuar procedura ligjore për sigurimin e sekretit. Në nenin 6 paragrafi 5 rregullohet obligimi që çdo shtet anëtare garantojë siguri fizike viktimave të tregtisë me njerëz deri sa ata janë në territorin e tij.

<sup>69</sup> Legjislacioni **Portugez** (akti i miratuar më 14 korrik 1999) rregullon miratimin e masave për mbrojtjen e dëshmitarëve në procedurën penale kur jeta e tyre ose integriteti fizik, liria ose prona janë në rrezik për shkak të pjesëmarrjes së tyre në sigurimin e dëshmitarëve për fakte që janë objekt i hetimit. Njëherësh ky ligj parasheh mbrojtjen e personave të cilët bëjnë pjesë në kategorinë e lëndueshme bile edhe kur rreziku siç u përshkrua më parë, nuk ekziston (një person mjaft i ri ose mjaft i moshuar, me probleme shëndetësore, ose kur dëshmohet kundër ndonjërit nga familja e vet ose kundër dikujt në raport me të cilin dëshmitari është në pozitë të nënshtruar).

Në mars të vitit 2003 u nxlr ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve nën kërcnim dhe dëshmitarëve të lënduar të Bonjës dhe Hercegovinës

Për dallim nga dy ligjet e mëparshme, ky ligj përfshin dy kategori personash: dëshmitarë siguria e të cilëve është rrezikuar ose siguria e familjes së tyre, për shkak të pjesëmarrjes së tyre në procedurën penale që shprehet nëpërmjet kërcënimeve ose formave tjera të intimidimit, dhe dëshmitarëve të lënduar të cilët fizikisht ose psikikisht janë të traumatizuar nga ngjarjet e përfshira me veprën penale ose me veprat penale ose vuajnë nga një gjendje e atillë mentale e cila i bën mjaft të ndieshëm, dhe fëmijëve dhe të miturve

<sup>70</sup> Në pajtim me veprën 24 të aktit juridik të Anglisë të miratuar më vitin 1999, dëshmi nëpërmjet video linkut mund të jepet në dy raste:

Kur dëshmitari është jashtë vendit dhe kur në procedurë dëshmitari është fëmijë.

Ligjshënësi në Zelandën e Re ka intervenuar dy herë në kahje të sigurimit të dispoziatave të nevojshme për rregullimin e anonimitetit të dëshmitarëve në procedurë, për herë të parë në vitin 1986 në mënyrë primare që të mbrohen agjentët të cilët punojnë në fshehtësi dhe më vonë në vitin 1997 kur masat e mbrojtjes u zgjeruan edhe te llojet tjera të dëshmitarëve. Me këto akte u ndërta një suazë e qartë dhe precize për mbrojtjen e identitetit të dëshmitarit.

Gjykatësi mund të japë urdhër dhe orientime për mbrojtjen e anonimitetit të dëshmitarit dhe atë: për shkak të përjashtimi të opinjonit, vënies së pëlhurës ndërmjet dëshmitarit dhe të të akuzuarit, dhënies së deklaratës nëpërmjet video linkut

<sup>71</sup> Si kriteret për klasifikimin e viktimës dëshmitarë si të përshtatshme për inkuadrin në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve, janë paraparë disa nga këto që vijnë: shkalla e rrezikut, lloji i veprës për të cilën gjykohet, pjesëmarrja në procedurë të jetë në bazë vullnetare, viktimat-dëshmitarë do të duhej të kishte mundësi të japë dëshmi valide dhe të njejtën ta përsërisë në procedurën para gjykatës, domosdoshmërinë e dëshmisë për procedurë, përshtatshmërinë e dëshmitarit, çmimit të programit.


## 10. Normativa e vendit në lëmin e mbrojtjes së dëshmitarit

Për dëshmitar, në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë penale të Maqedonisë personi për të cilin besohet se do të mund të japë informatë për veprën penale dhe kryerësin, si dhe për rrethanat tjera të rëndësishme.

Çdo person i thirrur si dëshmitar është i obliguar të dëshmojë<sup>72</sup>. Nga kjo rregull ekzistojnë përjashtime në situatat kur një person i caktuar nuk guxon të merret në pyetje si dëshmitar dhe kur në rrethana të veçanta persona të caktuar lirohen nga obligimi që të dëshmojnë. Në rastin e parë është fjala për person i cili me deklaratën e vet do ta cenonte obligimin për ruajtjen e sekretit zyrtar ose ushtarak ose për mbrojtës të akuzuarit për atë që i është besuar si mbrojtës të vetin. Në rastin e dytë paraqiten persona të cilët mund të dëshmojnë por nuk është e domosdoshme:

- Bashkëshorti ose personi me të cilin bashkëjeton i akuzuari;
- Faresi i të akuzuarit për nga gjaku në vijë të drejtë, faresi në vijë anësore përfundimisht deri në brezin e tretë si dhe faresi me krushqi, përfundimisht deri në brezin e tretë;
- I adoptuari dhe adoptuesi i të akuzuarit;
- Rrëfimtari fetar për atë që ia ka rrëfyer të akuzuarit ose person tjetër;
- Avokati, mjeku, punëtori social, psikologu ose ndonjë person tjetër për faktet për të cilat kanë kuptuar gjatë kryerjes së punës së vet, për të cilat janë të obliguar ta ruajnë si sekret atë që e kanë kuptuar gjatë kryerjes së profesionit të vet.

Po ashtu personi i cili me dëshminë e vet do ta ekspozonte veten ose farefisin e vet të afërt në një turp të rëndë, dëm të konsiderueshëm material ose ndjekje penale (edhe pse obligimi për dëshmi mbetet) nuk është i obliguar tu përgjigjet pyetjeve të caktuara.



Prej gjithsej 32 lëndëve të vëzhguara lidhur me tregtinë me njerëz para të gjitha gjykatave në Maqedoni, në 9<sup>73</sup> prej tyre dëshmitari njoftuar për të drejtën që të mos përgjigjet për pyetje të caktuara nëse besohet se me këtë do ta ekspozonte veten ose farefisin e vet në turp të rëndë, dëm material ose ndjekje penale, edhe pse në nenin 223, paragrafi 2 ky obligim është paraparë<sup>74</sup>.

Deri në nxjerrjen e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji për procedurë penale në vitin 2004 nuk ekzistonte dispozitë me të cilën mund të lirohej nga dëshmia ose nga përgjigja e pyetjeve të caktuara personi për të cilin ka ekzistuar rreziku nga frikësimi, kërcënimimi ose rreziku për jetë, shëndet ose integritet fizik. Edhe pse në pajtim me logjikën e gjërave, nëse një person lirohet nga dhënia e përgjigjes në pyetje të

<sup>72</sup> Nëse dëshmitari gjendet në Republikën e Maqedonisë

<sup>73</sup> Në një lëndë të vëzhguar në gjykatën themelore në Tetovë, në procesverbal vetëm është konstatuar se dëshmitari është njoftuar me të drejtën nga neni 233 i LPP, me këtë rast i njëjti nuk është informuar me të vërtetë.

<sup>74</sup> Prej gjithsej 9 lëndëve në të cilat dëshmitari nuk është informuar për të drejtën që të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara, në gjashtë bëhet fjalë për dëshmitarë viktime në procedurë.



caktuara që të mos i ekspozohet dëmit material, pavarësisht se sa është ai i konsiderueshëm aq më tepër do të duhej të lirohej nga përgjigje në situata kur jeta e tij është vënë në pyetje.

Me shtimin e nenit 223-a në LPP përkatësisht me mundësimin që dëshmitari ta shkurtojë paraqitjen e të dhënave personale (emrin dhe mbiemrin, emrin e babait, profesionin, vendqëndrimin, moshën raportin me të akuzuarin)<sup>75</sup> nëse besohet se me dhënien e dëshmisë ose të përgjigjes në pyetje të caktuar, do ta ekspozonte veten ose ndonjë person të afërt të tij në rrezik serioz për jetën, shëndetin ose integritetin fizik, bëhet një hap përpara drejt mundësimin të mbrojtjes së dëshmitarëve, duke i përfshirë edhe dëshmitarët/viktima në lëndët e tregtisë me njerëz si kategori posaçërisht e ndjeshme.

Dëshmitarit, i cili ka shkurtuar paraqitjen e të dhënave të sipërpërmendura, nëse verifikohet se është me bazë ekzistimi i rrezikut, në afat prej 24 orësh i sigurohet mbrojtje nëpërmjet inkuadrimit në Programin për mbrojtjen e dëshmitarëve (neni 270b).

Kjo do të thoshte që ndaj dëshmitarit në fjalë nuk zbatohen dispozitat për realizimin e mënyrës së veçantë të marrjes në pyetje dhe pjesëmarrjes në procedurë (neni 270a)<sup>76</sup>, që është jologjike veçanërisht kur merren parasysh vështirësitë me të cilat është përcjellë inkuadrimi në Programin për mbrojtje dhe çmimi i kushtimit të së njëjtës.

Gjatë vëzhgimit 8 mujor të lëndëve lidhur me tregtinë me njerëz në të gjitha gjykatat themelore në Maqedoni, nuk është vërejtur ndonjë rast i shkurtimit të paraqitjes së të dhënave nga dëshmitari gjatë procedurës<sup>77</sup>, që na çon të konkludojmë se ose nuk ka ekzistuar rrezik serioz për jetën, shëndetin ose integritetin fizik të dëshmitarit (që do të ishte habi duke marrë parasysh ndjeshmërinë e temës së vëzhguar, shkallën e lartë të dhunës me të cilën është ndjekur tregtia me njerëz, si dhe vlerësimin e shkallës së lartë të rrezikut për dëshmitarët të cilët vendosin të dëshmojnë gjatë procedurës në gjykatë<sup>78</sup>), ose dëshmitari nuk është informuar për të drejtën që të shkurtojë paraqitjen e të dhënave personale (edhe pse duke marrë parasysh faktin se dëshmitari/viktimë rreth 70% të lëndëve është përfaqësuar nga i autorizuari gjatë procedurës, do të mund të supozohej se për të njëjtën do të informohej).

Në LPP nuk ka dispozitë e cila në mënyrë të prerë imponon obligimin që dëshmitari të informohet për të drejtën që të shkurtojë paraqitjen e të dhënave të përmendura më lartë.<sup>79</sup>

Me mjete tjera teknike të komunikimit nënkuptohet frekuenca telefonike ose video konferenca<sup>80</sup>. Në të vërtetë dëshmitari ose eksperti mund të merren në pyetje në këtë mënyrë nëse gjenden në territorin e ndonjë shteti tjetër. Me këtë rast, gjatë marrjes në pyetje përveç dispozitave të LPP, zbatohen edhe dispozitat e Protokollit të dytë plotësues të Konventës evropiane për ndihmë ndërkombëtare-juridike në materien penale.

<sup>75</sup> Ndodh që në lëndët në lidhje me tregtinë me njerëz që viktima të mos japë të dhëna për ndonjë person të afërt me të (shpeshherë për person i cili ka ndihmuar që të ikë nga personi i cili ka bërë tregti me të) me qëllim të ikjes nga rrezikimi eventual i këtij personi (domethënë jo ato të dhëna të përcaktuara në nenin 223 p 3). Legjislatura jonë nuk ka dispozitë me të cilët do të mbrohej identiteti i këtij personi, përveç nëse i njëjti nuk paraqitet në rolin e dëshmitarit. Mos insistimi i gjykatës për dhënien e të dhënave për personin e këtyllë – ndihmës të viktimës, mund të përshëndetet si reagim përkatës në lëndët konkrete.

<sup>76</sup> Veprimet kanë të bëjnë me dëgjimin e dëshmitarit vetëm në praninë e prokurorit publik dhe gjykatësit hetues, përkatësisht kryetarit të këshillit në një vend që garanton mbrojtjen e identitetit të tij nëse në pajtim me dëshmitarin, këshilli nuk vendos ndryshe që dëgjimi të bëhet nëpërmjet gjykatësit, ose me përdorimin e mjeteve tjera teknike për komunikacion dhe mjeteve tjera përkatëse për komunikacion.

<sup>77</sup> Vetëm në një lëndë viktima/dëshmitarë ka refuzuar të japë të dhëna për vendbanimin në vendin amë, megjithatë i njëjti nuk është në situatë në përputhje me nenin 223-a. Me këtë rast procedura ka vazhduar pa insistim për përgjigje.

<sup>78</sup> Shiko faqen 41 – Nevoja për mbrojtjen e dëshmitarëve në Maqedoni

<sup>79</sup> Sipas nenit 5 pjesa 1 i Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve nën kërcënim dhe dëshmitarëve të lëndueshëm të Bosnjë e Hercegovinës, gjykatësi, prokurori publik dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë me detyrë zyrtare e këshillon dëshmitarin i cili do të mund të ishte nën kërcënim ose dëshmitarë i lëndueshëm për masat e mbrojtjes të cilat ekzistojnë sipas dispozitave të ligjit.

<sup>80</sup> Sipas nenit 295a të LPP, të inkuadruar me ndryshimet e vitit 2004.

Sa i shfrytëzon praktika në gjykatat tona themelore autorizimet ligjore të parapara me LNP të LPP dhe me çfarë shpejtësie mund t'i implementojë dhe sendërtojë, mund të vlerësohet nëpërmjet të të dhënave vijuese. Në të vërtetë në periudhën e nxjerrjes së LNP të LPP deri në muajin qershor 2005 në kuadër të lëndëve të vëzhguara sipas nenit 418-a dhe b; "Tregtia me njerëz" dhe "Kontrabanda me mërgimtarë" si dhe neni 191 "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit", marrja me pyetje e dëshmitarit ose e ekspertit nëpërmjet video konferencës<sup>81</sup> është zbatuar vetëm në një rast.

**Në Republikën e Maqedonisë më 28.04.2005 në Gjykatën themelore në Tetovë, në lëndën lidhur me veprën penale ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit nga neni 191 i KP, për herë të parë është bërë marrja në pyetje e dëshmitarit nëpërmjet video konferencës. Pajisja nëpërmjet të cilës është siguruar ndërlidhja audio dhe vizuale me viktimën e vendosur në lokalin e gjykatës në shtetin amë, është vendosur në mënyrë që Këshilli gjyqësor së bashku me prokurorin publik, të autorizuarin e të dëmtuarës dhe mbrojtësit e të akuzuarve, kanë mundur të kenë shikim vizual në dhënien e deklaratës së viktimës/dëshmitarë, deri sa të akuzuarit dhe publiku kanë pasë mundësi që vetëm ta dëgjojnë të njëjtën.**<sup>82</sup>

Njëherësh, mënyra e veçantë e marrjes në pyetje të dëshmitarit nëpërmjet gjykatës në lokal të veçantë që ndryshon nga gjykatorja, deri më tash në asnjë lëndë të vëzhguar nuk është përdorë.

Dispozita nga neni 312 i LPP e cila në rrethana të jashtëzakonshme i lejon këshillit që të vendosë që i akuzuari të largohet nga gjykatorja, nëse dëshmitari refuzon të japë deklaratë në praninë e tij ose rrethanat paralajmërojnë se nuk do ta flasë të vërtetën, po ashtu nuk gjeti zbatim në asnjërën nga lëndët e vëzhguara të Koalicionit.

Republika e Maqedonisë e nxori Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve në maj të vitit 2005. I njëjti do të zbatohet prej janarit të vitit 2006.

## ***11. Nevoja për mbrojtjen e dëshmitarëve në Maqedoni***

Sa është shpeshtësia e frikësimit të dëshmitarëve në procedurën para gjykatave të R. të Maqedonisë, d.m.th. sa kërcënimet për hakmarrje janë mundësi e afërt reale dhe sa shpesh realizohen, vetëm mund të supozohet.

Megjithatë, sjellja e caktuar e disa dëshmitarëve gjatë procedurës direkt ose tërthorazi të çojnë në përfundimin se kjo ekziston.

**Në lëndën e vëzhguar në Gjykatën themelore Shkup 1 lidhur me veprën penale Tregti me njerëz, sipas nenit 418a, të pesë palët e dëmtuara, shtetas të huaj, nuk kanë qenë të pranishëm në shqyrtim sepse pas kërcënimit se**

<sup>81</sup> Gjatë një gjykimi në Prizren (Kosovë), gjykatësi, prokurori dhe minimumi i personalit të nevojshëm e kanë dëgjuar dëshmitarin në lokal të veçantë, e kanë lexuar procesverbalin e dëshmisë së dëshmitarit dhe pastaj janë kthyer në lokalin përkatës me qëllim që të bëjë pyetje plotësues të cilat i ka propozuar mbrojtja. Në këtë mënyrë është ruajtur anonimiteti i dëshmitarit në relacion me mbrojtjen.

Në këtë rast dëshmitari i vendosur në lokal të veçantë nëpërmjet mikrofonit ka mund ta përcjellë shqyrtimin dhe t'u përgjigjet pyetjeve të shkruara. Problem me rastin e dytë është që gjykatësi nuk ka mundësi ta shohë sjelljen e dëshmitarit gjatë dhënies së dëshmisë. "Mbrojtja e dëshmitarit në sistemin e legjisllacionit penal"-raport i OBSE Misioni në Kosovë.

<sup>82</sup> Realizimi i konferencës së parë video në Maqedoni nëpërmjet të cilës u siguroa dëgjimi i viktimës – dëshmitarë në procedurën në gjykatën themelore në Tetovë u bë i mundshëm me përpjekjet e përbashkëta të SEKI qendrës, MPB të R të Maqedonisë, MPB të R të Moldavisë, Prokurorisë Publike të RM, Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës Themelore në Tetovë dhe FBIN.

t’i presin venat nëse nuk kthehen në shtetet e tyre, nëpërmjet Ministrisë së punëve të brendshme është realizuar kthimi i tyre. Në gjykatë janë lexuar deklaratat e tyre të dhëna para gjykatësit hetues.

Në lëndën e vëzhguar para Gjykatës themelore në Gostivar që zhvillohet për veprë penale ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit sipas nenit 191 paragrafi 1 të KP dëshmitari (e dëmtuara)<sup>83</sup> në shqyrtimin kryesor ka mohuar plotësisht deklaratën e vet të dhënë në procesverbal para gjykatësit hetues. Ajo ka deklaruar se i akuzuari është i pafajshëm dhe se nuk është e saktë se është detyruar në prostitucion. Po ashtu ka deklaruar se nuk i kujtohet se çka ka thënë me saktësi para gjykatësit hetues. Deklaratën e vërtetuar te notari e dhënë disa muaj pas dhënies së dëshmisë para gjykatësit hetues, në të cilën ka deklaruar se i akuzuari nuk është fajtor, e ka pranuar për të veten.

Për deri sa mbrojtësi i të akuzuarit ka vërtetuar se dëshmitari ka dhënë deklaratë të dytë para gjykatësit hetues, gjykatësi dhe prokurori publik kanë mohuar se ekziston një deklaratë e tillë. Në kërkesën e prokurorit publik nga gjykatësi hetues është marrë njoftim me shkrim i cili ka vërtetuar se dëshmitari vetëm një herë ka dhënë deklaratë dhe se deklarata e dhënë para noterit 4 muaj më vonë është dërguar por nuk është pranuar prej gjykatësit hetues, nga shkaku se e dëmtuara tashmë është marrë në pyetje.

*...Meqë dëshmitari mohonte plotësisht deklaratën e vet të dhënë para gjykatësit hetues, u fitua përshtypja se ajo është mjaft e frikësuar dhe nuk deshi të dëshmonte kundër të akuzuarit. Deri sa jepte deklaratën ishte e hutuar....shënim i vëzhguesve të pranishëm në shqyrtim.*

## Sigurimi i ndërtesës së gjykatës

Për mbrojtjen e ndërtesës së gjykatës dhe të personave brenda saj është përgjegjëse policia e formuar në vitin 1996.

Me të udhëheq kryetari i gjykatës i cili është i obliguar të përgatisë plan javor për sigurimin e seancave me vlerësim për nevojën e pranisë në gjykim, qoftë në mënyrë permanente ose herë pas here, ose për nevojën për marrjen paraprake në pyetje të të gjithë pjesëmarrësve në procedurë gjatë ardhjes në gjykatë.<sup>84</sup>

Personat e privuar nga liria, të arrestuar ose të dënuar në gjykatë i dorëzohen policisë gjyqësore nga organet kompetente dhe anasjelltas.

Në të gjitha gjykatat themelore në Maqedoni janë vënë detektorë për metal në derën e hyrjes të ndërtesës<sup>85</sup>. Në ata gjykata ku janë ndjekur lëndët lidhur me tregtinë me njerëz, kontrolli në hyrje të ndërtesës gjyqësore është në nivel të kënaqshëm.

Në lëndën lidhur me nenin 418 të KP të vëzhguar në gjykatën themelore në Tetovë<sup>86</sup> (Tet 007) dy prej 10 të akuzuarve, nuk janë lënë të hyjnë nga sigurimi i gjykatave. Më qëllim të shmangies së kësaj skene në seancën e ardhshme, të gjithë të akuzuarit kanë marrë ftesa.

<sup>83</sup> Dëshmitari (e dëmtuara) është shtetase e huaj, me një foshnjë të moshës shtatë vjeçe. Babai i fëmijës, shqiptar, shtetas i R të Maqedonisë, me të cilin është njohur në barin e natës së të akuzuarit dhe me të cilin ka jetuar në bashkësi jashtë martesë thuhet katër vjet, është vrarë në vitin 1999.

<sup>84</sup> neni. 270 i rregullores gjyqësore (Policia Gjyqësore)

<sup>85</sup> Sipas Judicial Reform Index for Macedonia november 2003, paksa e rëndomtë e Policisë Gjyqësore është që ti lëshojë qytetarët rreth detektorit ose të mos reagojë në zhurmën e pajisjes. Konkluzioni ynë u dedikohet vetëm gjykatave ku janë vëzhguar lëndët lidhur me tregtinë me njerëz.

<sup>86</sup> Në Gjykatën themelore të Tetovës, masat për sigurimin e ndërtesës gjyqësore janë ashpërsuar dukshëm.

Gjatë vëzhgimit 8 mujor nuk janë vërejtur incidente lidhur me problematikën e sigurimit adekuat të ndërtesës gjyqësore dhe të personave brenda saj. Sigurimi përherë është i pranishëm në gjykimet që kanë të bëjnë me lëndët e arrestimit.

Në të 17 rastet në të cilat viktimat ka qenë e pranishme, edhe atë 8 herë në shqyrtimin kryesor dhe 9 herë jashtë shqyrtimit kryesor, sigurimi ka qenë në nivel solid. Në të vërtetë, përveç sigurimit gjyqësor<sup>87</sup>, përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, shpesh herë ka qenë i pranishëm edhe sigurimi i vendit nga është viktimat.<sup>88</sup>

Është vërejtur vetëm një incident kur vëzhguesit e Koalicionit janë kërcënuar nga ndonjëri prej pjesëmarrësve në procedurë që të tërhiqen nga ndjekja e lëndës në fjalë.

## Përkufizime hapësinore


Gjykatat themelore në Maqedoni kryesisht nuk janë të siguruar me lokal të veçantë ku do të qëndronte dëshmitari pa u konfrontuar me të akuzuarin në kohën para fillimit të shqyrtimit. Megjithatë, përkufizimi hapësinor nuk guxon të jetë shkak për mos ndërmarrjen e të gjitha masave të mundshme për reduktimin e viktimizimit sekondar të viktimës.

**Në gjykatën themelore në Gostivar (Gos 001) në lëndën e vëzhguar lidhur me veprën penale nga neni 418a të KP, viktimat/dëshmitar është vendosur në lokalin e policisë gjyqësore deri në fillimin e shqyrtimit kryesor**

Praktika në disa gjykata që seanca të mbahet në zyrën e gjykatësit, dhe nëse vërtetohet ekzistimi i kushteve për mbajtjen e shqyrtimit që eventualisht pjesëmarrësit të vendosen në gjykatore, do të duhet larguar veçanërisht nëse është e pranishme edhe viktimat.

Në 12% të seancave veprimet janë realizuar në zyrën e gjykatësit.

Kushtet e punës në gjykatore të gjykatave themelore në të cilat është bërë vëzhgimi, lëvizin prej më të këqijave deri në më të shkëlqyeshmet.



Edhe pse rrallë, megjithatë ndodh që gjykatortja në cilën gjykohen veprat penale lidhur me tregtinë me njerëz është e vogël dhe e ngushtë pa hapësirë të mjaftueshme për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë.

Prandaj ndonjë herë jo vetëm që nuk mund të ruhet rendi i vendeve të përcaktuara në pajtim me ligjin, për të akuzuarin dhe mbrojtësit e tij, prokurorin publik, për të dëmtuarin ose të autorizuarin e tij, për dëshmitarët dhe ekspertët, por ndodh që edhe i akuzuari të qëndrojë pranë personave nga publiku, përkatësisht personat pjesëmarrës në procedurë të mos jenë fizikisht të ndarë nga njëri tjetri.

Edhe pse në pajtim me nenin 303-a palët duhet të ulen përballë kryetarit të këshillit edhe atë i akuzuari dhe mbrojtësi i tij nga ana e tij e majtë, kurse prokurori publik ose akuzuesi i autorizuar, i dëmtuari ose i autorizuari i tij nga ana e tij e majtë, kurse dëshmitarët dhe ekspertët merren në pyetje në vendin e përcaktuar

<sup>87</sup> Përjashtim bën një shqyrtim i një lënde para gjykatës themelore në Manastir në të cilën nuk ka pasur përfaqësues të policisë gjyqësore në gjykatore, në të cilën opinioni është përjashtuar

<sup>88</sup> Vetëm në një lëndë ku viktimat ka qenë e pranishme, është siguruar edhe prania e punëtorit social.

në anën e djathtë të kryetarit të këshillit, të kthyer kah i akuzuari dhe akuzuesi, në praktikën e gjykatave tona themelore jo dispozitë nuk respektohet. Në të vërtetë bile edhe atje ku ekzistojnë kushte për riorganizimin e gjykatës, e njëjta nuk zbatohet.

Ndonjëherë ndodh që përkundër pajisjes së gjykatës me kompjuter, për shkak të shfrytëzimit të makinës mekanike të shkrimit, të vështirësohet përcjellja përkatësisht dëgjimi i shqyrtimit.

## **Konkluzione:**

Në më shumë se një të katërtën e lëndëve dëshmitari i shqyrtimit kryesor nuk është i informuar për të drejtën që të mos përgjigjet në pyetje të veçanta nëse është i sigurt se me këtë do ta ekspozonte veten ose ndonjë farefis në turp të rëndë, dëm material ose ndjekje penale edhe pse ky obligim është paraparë në pajtim me nenin 223 paragrafi 2 i LPP. Në 75% të lëndëve fjala është për marrjen në pyetje të dëshmitarit/viktimë në procedurë.

Në asnjë rast dëshmitari në lëndën lidhur me tregtinë me njerëz nuk e ka shkurtuar paraqitjen e të dhënave personale ( në pajtim me dispozitën nga neni 223-a të LPP) që është paraparë për situata kur besohet se me dhënien e dëshmisë ose të përgjigjes në pyetje të caktuara do të ekspozonte veten ose ndonjë person të afërt me të në rrezik serioz për jetën, shëndetin ose integritetin fizik. Njëherësh nuk ka ndodhur që dëshmitari të refuzojë të japë deklaratë në praninë e të akuzuarit kurse në mënyrë automatike edhe të shfrytëzohet dispozita e nenit 312 të LPP në pajtim me të cilin i akuzuari në një situatë të këtillë mund të largohet nga gjykatëria.

Marrja në pyetje e dëshmitarit ose e ekspertit nëpërmjet të video konferencës është bërë vetëm një herë në një lëndë në Republikën e Maqedonisë.

Mënyra e posaçme e marrjes në pyetje të dëshmitarit nëpërmjet gjykatës në lokal që ndryshon nga gjykatëria (të rregulluar me dispozitën 270-a të LPP) deri më tash nuk është përdorur në asnjë lëndë të vëzhguar.

Kontrolli i hyrjes në ndërtesën e gjykatës në gjykatat themelore në të cilat janë vëzhguar lëndë lidhur me tregtinë me njerëz është në nivel të kënaqshëm. Njëherësh në të gjitha situatat në të cilat prania e viktimës në shqyrtimin kryesor është siguruar, është organizuar edhe mbrojtja fizike përkatëse qoftë nga ana e pjesëtarëve të MPB, sigurimit nga shteti prej nga vjen viktimja ose nga policia gjyqësore.

Mundësitë hapësinore të gjykatave janë të limituara dhe kjo paraqitet si faktor për rritjen e gjasës për viktimizim sekondar të viktimës së tregtisë me njerëz. Gjykatoret e vogla nuk lejojnë realizimin e ndryshimeve në LPP të përcaktuara në nenin 303-a në pajtim me të cilin radhitja e uljes së pjesëmarrësve në procedurë është përcaktuar ndryshe në krahasim me periudhën paraprake.

## **Rekomandime:**

Është i domosdoshëm respektimi konsekuent i dispozitës së nenit 223 të LPP në pajtim me të cilën dëshmitari do të paralajmërohet se nuk është i detyruar tu përgjigjet pyetjeve të veçanta nëse ekzistojnë gjasa se me këtë do të ekspozonte veten ose ndonjë farefis të vetin në turp të rëndë, dëm material ose ndjekje penale.

Dëshmitari do të duhej të informohej për të drejtën që të shkurtojë paraqitjen e të dhënave personale (emrin dhe mbiemrin, emrin e babait, profesionin, vendqëndrimin, moshën dhe raportin me të akuzuarin) nëse me këtë do të ekspozonte veten ose ndonjë person të afërt me të në rrezik serioz për jetën, shëndetin ose integritetin fizik.

Nëse dëshmitari shkurton paraqitjen e të dhënave në fjalë kurse vlerësohet se rreziku ekziston, do të duhej të ekzistonte mundësi për zbatimin e dispozitave për mënyrën e veçantë të marrjes në pyetje të dëshmitarit në procedurë, e jo vetëm të dispozitave për përfshirje në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve. Vlerësimi i shkallës së rrezikimit dhe mënyrën e mbrojtjes duhet të bëhet në pajtim me situatën konkrete.

Është i domosdoshëm përpunimi më konkret ligjor i mënyrës së veçantë të marrjes në pyetje dhe pjesëmarrjes së dëshmitarëve në procedurë kur ekzistojnë rrethanat e nenit 270-a. Me këtë do të mundësohej mbrojtja më e shpejtë dhe më ekonomike e viktimës së tregtisë me njerëz/dëshmitarë në procedurë, posaçërisht në periudhën deri në hyrjen në fuqi edhe përpunimit të Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Sigurimi i hapësirës adekuate për gjykim posaçërisht për lëndë me shkallë të ndjeshmërisë, siç janë ato në kudër të tregtisë me njerëz, paraqet domosdoshmëri për shmangien e viktimizimit sekondar të viktimave, si dhe sigurimin e marrjes së dëshmisë cilësore në procedurën kundër kryerësve të këtij lloji të veprave penale.

Përgatitja e një doracakut për të drejtat e dëshmitarëve në procedurë<sup>89</sup> mund të kontribuojë drejt afirmimit të të drejtave të të gjithë personave të cilët thirren si dëshmitarë në lëndët në gjykatat themelore. Afirmimi çon drejt njohjes së të drejtave, kurse e njëjta drejt përgatitjes më të madhe të qytetarëve (gjithsesi edhe të viktimave të tregtisë me njerëz) për paraqitje dhe participim në procedurën në gjykatë.

<sup>89</sup> <http://www.usdoj.gov/usao/tnw/brochures/vw handbook/vw handbook.html>) Victim and Witness handbook.



## 6

*Kompensimi i viktimave*

Reforma e legjislacionit ndëshkimor në drejtim të mbrojtjes së interesit të viktimës<sup>90</sup>, para së gjithash qasjes së viktimës kah sistemi i drejtësisë ndëshkimore dhe zbatimit të saj efikas, restituimi, kompensimi, ndihma sociale dhe mbrojtja nga viktimizimi sekondar, u iniciua nga një numër i madh instrumentesh ndër kombëtare<sup>91</sup>.

Në vendet e Unionit Evropian detyrimi për kompensim të dëmit të shkaktuar me kryerjen e veprës penale i takon, para së gjithash, të akuzuarit. Viktima në procedurë civile me padi private është e autorizuar të paraqesë kërkesë për kompensimin e dëmit të pësuar material dhe jo material. Me këtë rast, për shkak të shpejtimit dhe lehtësimit të procesit për mundësimin e kompensimit, një pjesë e vendeve anëtare parashikojnë dispozita në bazë të të cilave viktimat/e dëmtuara mund të paraqesë kërkesë për kompensim të dëmit në procedurë penale<sup>92</sup>. Rëndom realizimi i kërkesës është i lidhur me përmbushjen e kushteve të caktuara.<sup>93</sup>

Shpesh ndodh që viktimat të mos jetë në gjendje ta realizojë të drejtën e vet për kompensim për dëmin e pësuar, qoftë të punohet për kryerës të panjohur të veprës penale, për mungesë të dëshmive për ngritjen e aktakuzës kundër tij ose është në pyetje paaftësia e kryerësit që ta paguaj kompensimin. Për këtë arsye disa prej vendeve anëtare, në situata të tilla e parashikojnë mundësinë që shteti ta kompensojë viktimën<sup>94</sup>.

<sup>90</sup> Kambovski Vlado, Kthimi i të drejtës ndëshkimore ndaj viktimës së veprës, Reforma ndëshkimore juridike para sfidave të shekullit XXI, Shkup, 2002, faqe 198

<sup>91</sup> **Konventa Evropiane për dëmshpërblimin e viktimave të veprave penale** me në nenin 2 parasheh obligimin për shtetin që në situata kjo nuk është e mundshme prej burimesh tjera që financiarisht ti zhdëmtojë viktimat të cilat kanë pësuar lëndime të rënda trupore ose çrregullime të gjendjes shëndetësore si pasojë e veprave penale me dhunë, si dhe personave të afërt të viktimave të cilat kanë vdekur prej veprash të këtitilla. Me këtë rast kompensimi do të bëhet edhe në situata kur kryerësi i veprës penale nuk mund të ndiqet penalisht ose të dënohet. **Direktiva për kompensimin e viktimave të veprave penale** të Komisionit Evropian, i obligon të gjitha anëtarë që deri më 1 korrik 2005 të përpunojnë sistemin nacional i cili do tu garantojë kompensim të drejtë dhe adekuat të viktimave të veprave penale. Njëherësh direktiva obligon që kompensimi i viktimave të mund të realizohet lehtë pavarësisht nga vendi, dmth shteti ku është kryer vepra, me ndihmën e krijimit të sistemit për bashkëpunim ndërmjet etniteteve nacionale i cili do të implementohet prej 1 janar 2006

<sup>92</sup> Në **Austri dhe Belgjikë**, aktakuzat për zhëmtimin e viktimave të krimit paraqiten para gjykatës penale në kudër të procedurës penale përveç kur rasti mund të zgjidhet vetëm para gjykatës civile (Austri) ose në raste të veçanta kur aktakuza paraqitet para gjykatave civile (Belgjikë)

<sup>93</sup> Një numër i madh legjislacionesh kanë klauzolën "Nëse vendosja sipas kërkesës për kompensimin e dëmit nuk ndikon në prolongimin e tepërt të procedurës"

<sup>94</sup> Viktimat në Angli dhe Uells nuk mund të paraqesin kërkesë për kompensim në kuadër të procedurës penale, mirëpo kjo edhe nuk nevojitet. Në të vërtetë, gjykatat penale janë të obliguara (under the Powers of Criminal Courts (Sentencing) Act 2000) të urdhërojnë pagesën e kompensimit nga ana e të akuzuarit në të gjitha lëndët ku ka lëndimi fizik, humbja ose dëmi rezulton nga vepra penale. Gjykatat janë të obliguara të deklarohen për shkaqet gjithnjë kur nuk do të urdhërojnë kompensimin e viktimës në procedurë



Në disa vende fitimi i kompensimit është i lidhur me ekzistimin e rrethanave të plotësuese si për shembull: lloji i veprës penale<sup>95</sup> për të cilën është fjala, lartësia e dëmit që kërkohet e kështu me radhë<sup>96</sup>.

## 12. Kompensimi i dëmit për viktimat në Maqedoni

Në republikën e Maqedonisë, kompensimi i viktimës së tregtisë me njerëz mundësohet përmes shfrytëzimit të institutit konfiskim prone ose letërsi pronësore nga kryerësi i veprës penale dhe kthimi i leverdisë të dëmtuarit përkatësisht viktimës në procedurën penale.

Përkundër qëndrimit të përcaktuar qartë të bashkësisë ndërkombëtare dhe legjislacionit të vendit<sup>97</sup> për detyrimin e shtetit për kompensimin e viktimës, nëse kryerësi i veprës nuk mund ta bëjë këtë, në Maqedoni nuk ekziston fond shtetëror për dëmshpërblimin e viktimës e as dispozita për detyrimin e gjykatës që të caktojë dëmshpërblimin nga e njëjta.

Në të vërtetë, gjykata me vendim me të cilin është konfirmuar kryerja e veprës penale do të urdhërojë konfiskimin e leverdisë pronësore të përfituar me të.<sup>98</sup> Me këtë rast leverdia pronësore mund të jetë në të holla, sende të tundshme dhe të patundshme me vlerë si dhe çdo pronësi tjetër, pronë ose aktivë, të drejta materiale dhe jo materiale.<sup>99</sup> Në rast se nuk mund të bëhet konfiskimi i tyre, kryerësit do t'i konfiskohet ndonjë pronë tjetër që i përgjigjet leverdisë së përfituar pronësore.<sup>100</sup>

Ajo që është konfiskuar i kthehet të dëmtuarit e nëse nuk ka të dëmtuar, bëhet pronë e shtetit. Nuk mund e të mos vërehet statusi i privilegjuar i (të drejtat dhe detyrimet) e shtetit. Në të vërtetë, në situatat kur kryerësi nuk mund ta kompensojë viktimën, shteti nuk e korrigjon mosbalancimin e parimit të drejtësisë, kurse në situata kur i dëmtuari është i panjohur, mjetet hyjnë në buxhetin e RM.

Prej gjithsej 15 lëndëve të gjykuara lidhur me vepra penale, "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit dhe tregtisë me njerëz", në periudhën prej janarit deri në shtator 2005, vetëm në një lëndë gjykata duke marrë aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, ka urdhëruar konfiskimin e leverdisë pronësore të fituar me veprën penale "ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit".

Kompensimi i viktimës realizohet me paraqitjen e kërkesës pronësore-juridike. Propozimi për realizimin e kërkesës pronësore-juridike në procedurën penale i dërgohet organit të cilin dërgohet edhe fletëparaqitja penale ose te gjykata te e cila zhvillohet procedura, më së voni deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor

<sup>95</sup> "Criminal justice act" të Irlandës nga viti 1993, gjykata mund të marrë vendim për kompensimin e viktimës nga ana e të akuzuarit me marrjen e aktgjykimit për çdo vepër penale.

<sup>96</sup> Shih Kanevçev M. Viktimologjia-Mësimi për viktimën, Vjetar i Fakultetit për Siguri 2000/2001 fq 97.

<sup>97</sup> Në pajtim me nenin 168 të Ligjit për Marrëdhënie obliguese, për dëmin e krijuar nga ndonjë vepër ndëshkimore me dhunë, kur kryerësi është i panjohur (i pa identifikuar), përgjigjet shteti. Shteti është i obliguar të kompensojë dëmin e bërë prej veprave ndëshkimore me dhunë edhe në rastin kur kryerësi është i njohur, por nuk ka mjete për jetë

<sup>98</sup> Liljana <sup>98</sup>Liljana Ingilizova-Ristova, konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional dhe dënimi-konfiskim i pronës, Revia Gjyqësore, 2002 nr.4, fq 47

<sup>199</sup> neni 98 (p 1) nga KP

<sup>100</sup> Në të njëjtin nen (p 2 dhe 3) rregullohet konfiskimi nga persona të tretë të të cilët është transferuar dobia pa kompensimin përkatës, nëse nuk kanë ditur, por kanë mundur ose kanë qenë të obliguar të dinë se është fituar me vepër penale ose pavarësisht se kanë ditur ose kanë mund të dinë në situatë kur është fjala për lëndë të cilat janë shpallur trashëgimi kulturore ose raritete natyrore, si dhe atyre për të cilat i dëmtuari është i lidhur personalisht.

në gjykatën e shkallës së parë. Kërkesa pronësore-juridike mund të jetë për kompensim të dëmit, kthim të sendeve ose shlyerje të punës së caktuar juridike.

Për kërkesën pronësore-juridike vendos gjykata penale. Në të vërtetë, **me aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor**, gjykata vendos tërësisht ose pjesërisht për kërkesën pronësore-juridike. Nëse dëshmitë në procedurën penale nuk japin bazë të mjaftueshme për të vendosur tërësisht ose të pjesërisht për kërkesën pronësore-juridike, kurse për sigurimin plotësues të tyre ekziston rrezik i vazhimit të paarsyeshëm të procedurës penale, gjykata me aktgjykim vendos vetëm për bazën, ose bazën dhe pjesërisht shumën e kërkesës pronësore – juridike kurse për shumën e kërkesës pronësore juridike ose pjesën që mbetet nga kjo shumë, do të marrë aktgjykim plotësues.

Nëse shumën e kërkesës pronësore-juridike nuk mund të vërtetohet me dëshmi tjera ose zbatimi i dëshmitë të tilla do të çonte drejt zhegjitjes së konsiderueshme të procedurës, gjykata me aktgjykim plotësues do të vendosë për shumën e kërkesës pronësore-juridike ose për pjesën e saj duke caktuar kompensim juridik<sup>101</sup>

Deri në nxjerrjen e Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për procedurë penale, gjykatësi me aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, në procedurën penale mund të vendoste tërësisht për kërkesën pronësore-juridike ose **vetëm pjesërisht** kurse për pjesën tjetër ta dërgojë palën e dëmtuar në kontest<sup>102</sup> civil.

Me inkorporimin e detyrimit të obligueshëm për gjykatën që të vendosë për kërkesën pronësore-juridike në procedurë penale në të cilën vendos edhe për konfiskimit të dobisë pronësore, evitohet problemi lidhur me përcaktimin e lartësisë së dobisë së konfiskuar dhe kërkesën pronësore juridike (marrja e vendimit për konfiskim të bëhet para se të përcaktohet dëmi real) si edhe i shmanget pozitës së pavolitshme në të cilën gjendet i dëmtuari<sup>103</sup> sepse me këtë rast paraqitet vetëm si paditës në procedurë civile e cila jo rrallë zgjat shumë.<sup>104</sup>

Kërkesa pronësore juridike në lëndët e tregtisë me njerëz më së shpeshti i dedikohet kompensimit të dëmit material (kompensimit të dëmit në rast të lëndimit trupor ose çrregullimit të shëndetit)<sup>105</sup> dhe dëmit jo material<sup>106</sup> (kompensim për dhembjet e pësuar fizike, për dhembje të pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, cenimit të autoritetit, nderit, lirisë ose të drejtave të personit si dhe për frikë)<sup>107</sup>.

Duke mos përcëmuar vëllimin e problemeve të cilat paraqiten gjatë përcaktimit të lartësisë së dëmit material, mund të thuhet lirisht se gjatë caktimit të dëmit jo material në raste të mungesës së praktikës në lëmin e tregtisë me njerëz të njëjtat multiplikohen.

Në të vërtetë, viktimat si rezultat i maltretim të vazhdueshëm brutal fizik dhe psikik nga ana e trafikuesve me njerëz<sup>108</sup>, shpesh herë u ekspozohen lëndimeve, depresioneve, pagjumësisë, shqetësimit dhe shokut

<sup>101</sup> neni 101 LNPLPP

<sup>102</sup> Në R të Maqedonisë deri tani nuk është realizuar dëmshpërblim për viktimë të tregtisë me njerëz në asnjë procedurë civile.

<sup>103</sup> N N. Mrvik, Kompensimi i dëmit në procedurën penale-ndërmjet reparacionit dhe retribucionit, -Revija e kriminalistikës, kriminologjisë dhe veprës penale, 1994,nr.2,fq.273

<sup>104</sup> Raporti përfundimtar i Koalicionit "Të gjithë për gjykime të drejta" gjykim në afat të arsyeshëm

<sup>105</sup> neni 184 nga Ligji për marrëdhënie Obligative

<sup>106</sup> Në lëndët para gjykatave tona bazë e kërkesës për kompensimin e dëmit material të viktimave të tregtisë me njerëz, më së shpeshti është:dhembja e pësuar shpirtërore për shkak të sulmit mbi nderin dhe autoritetit, për shkak të përkufizimit të lirisë së lëvizjes, frikës së pësuar juridike-relevante; dhembjes së pësuar fizike

<sup>107</sup> neni 189 nga Ligji për marrëdhënie Obligative.

<sup>108</sup> Sipas të dhënave të raportit të IOM 2004 (Changing patterns and trends of trafficking in persons in the Balkan region) për lëvizjen e përqindjes së viktimave të cilat kanë paraqitur keqpërdorim në qendrën e transitit në Shkup, mund të konkludohet

postraumatik<sup>109</sup>. Për shkak të detyrimit për marrëdhënie seksuale me një numër të madh klientësh, rritet mundësia që të infektohen me sëmundje seksualisht të transmetueshme. Jo rrallë ndodh që bëjnë aborte që gjithsesi ndikon në gjendjen e organeve riproduktive. Kushtet e këqija higjienike, ushqimi i dobët janë faktorë që ndikojnë në gjendjen e përgjithshme të viktimës.

**Në një lëndë të vëzhguar në gjykatën themelore në Tetovë lidhur me nenin 418a të KP viktimë pas hyrjes në Maqedoni dy ditë ka qenë e mbyllur dhe e detyruar të japë shërbime seksuale, është rrahur dhe ushqyer vetëm me bukë dhe ujë. Gjatë tentimit që të ikë është kapur nga i dënuari është rrahur dhe është lënë lakuriqe 2 orë në mal. Gjatë tentimit për vetëvrasje me prerjen e venëve, me intervenim mjekësor në ordinancë private në fshatrat përreth ka shpëtuar.**

**Në një lëndë tjetër të vëzhguar në gjykatën themelore në Tetovë lidhur me nenin 418-a të KP viktimës si pasojë e përdorimit të forcës nga të akuzuarit i është nevojitur intervenimi i stomatologut. E njëjta pasi ka mbetur shtatzënë, i është nënshtruar abortit në një ordinancë private.**

Në kuadër të qendrës transitore në Maqedoni ekzistojnë tri ekipe profesionale të cilat në radhët e veta kanë edhe psikolog, të obliguar t’i japë viktimës përkrahje psikosociale. D.m.th. vlerësimin e parë për gjendjen e viktimës e bëjnë persona profesionistë në kuadër të qendrës. Problemi qëndron aty se mendimi i këtyre personave deri më tash nuk është trajtuar si dëshmi në procedurën<sup>110</sup>.

**Në lëndën e vetme në të cilën është urdhëruar të merret raporti prej IOM (dokumentacion mjekësor) për të dëmtuarën dëshmitare në procedurë, të vëzhguar në gjykatën themelore në Tetovë (Tet 001) lidhur me nenin 418-a të KP, përkundër urgjencës së gjykatësit raporti është marrë bile pas seancës së tretë të lëndës.**

Ekspertiza më shpesh e urdhëruar shumë vonë në kuadër të procesit gjyqësor, nëse është e mundshme, duke marrë parasysh faktin se viktimë më së shpeshti depërtohet në vendin amë, nuk mund ta pasqyrojë gjendjen e parë psikike të viktimës që mund të ketë rëndësi të madhe për përcaktimin e lartësisë së dëmit.

**Në një lëndë të vëzhguar në gjykatën themelore në Tetovë (Tet 004) lidhur me nenin 418a të KP, viktimë/e dëmtuara, shtetase e huaj, para gjykatësit hetues ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe ka paralajmëruar kërkesë pronësore-juridike duke mos përcaktuar me këtë rast lartësi dhe bazë.**

**I autorizuar i të dëmtuarës në shqyrtimin kryesor e ka specifikuar kërkesën pronësore-juridike duke i caktuar bazat vijuese për kompensimin e dëmit jo material: dhembje e pësuar shpirtërore për shkak të goditjes së nderit dhe autoritetit, për shkak të përkufizimit të lirisë së lëvizjes, për shkak të frikës së pësuar juridike relevante dhe për shkak të dhembjes së pësuar fizike. Njëherësh ka propozuar që shumica të caktohet në bazë të ekspertizës neuropsikiatrike ose në bazë të rregullores së shtëpive të sigurimit.**

---

se përdorimi i forcës fizike ndaj viktimave të tregtisë me njerëz është në rritje e sipër. Në të vërtetë 31% nga numri i përgjithshëm i viktimave ka qenë fizikisht të malltretuar në vitin 2001, 57% në vitin 2002, 67% në v 2003.

<sup>109</sup> Në "Indeksin e Kelnit për rreziqe" janë të numëruara: Lloji i ndodhisë, ndarje në gjendje traumatike, përgjigje të institucioneve, frika nga vdekja në gjendje traumatike, kohëzgjatja e të njëjtës dhe lëndimet fizike, respektivisht marrëdhëniet e mbyllura me kryerësin.-Doracak për trajnim në suaza të programit së gjithmbarë për trajnim Këmbim dhe bashkëpunim të grupit operative të Paktit për Stabilitet në lidhje me Luftën kundër tregtisë me njerëz.

<sup>110</sup> Në trajnimin e specializuar në lidhje me tregtinë me njerëz dhe migrimit ilegal, e organizuar për gjykatësit e gjykatave themelore të Maqedonisë më 24 dhe 25 Qershor të vitit 2005, nga ana e IOM, u imponua si konkluzion i diskutimeve në këtë temë se anamneza e këtyre persona profesional ndoshta duhet të trajtohet si dëshmi "Adekuate". Në këtë drejtim është edhe rekomandimi i prof dr Gjorgji Haxhi Angellkovski-neuropsihijatër në trajnimin e mbajtur për vëzhgues të Koalicionit për ndjekjen e lëndëve nga fusha e tregtisë me njerëz. Në të vërtetë, mendimet e personelit i cili është në kontakt direkt me viktimën pas pranimit të saj në qendrën e transitit paraqesin bazë adekuate për përgatitjen e gjetjes eksperte dhe mendimit të personit ekspert për procedurë para gjykatës.


Në shqyrtim është ftuar edhe personi ekspert, psikolog i Qendrës për punë sociale në Tetovë, megjithatë vetëm për të dhënë mendim për aftësinë e të dëmtuarës që të dëshmojë.

Propozimin e mbrojtësit të të akuzuarit t'i bëhet ekspertizë plotësuese neuropsikiatrike të dëmtuarës, e cila është marrë një herë në pyetje në seancën paraprake, gjykatësi e ka hedhur poshtë si të pabazë.

Në aktgjykim me të cilin të akuzuarit shpallen fajtorë, sa i përket kërkesës pronësore-juridike, e dëmtuara udhëzohet n. Procedurë civile sepse " vepra penale ka ndodhur në periudhën kur nuk kanë qenë në fuqi ndryshimet në LPP, dhe do të zbatohen dispozitat e LPP të vjetër sepse janë më të volitshme për kryerësit".

Për dallim nga e drejta ndëshkimore materiale ku vlejnë dispozitat e ligjit që kanë qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, në të drejtën proceduese vlejnë dispozitat e ligjit që janë në fuqi në kohën e gjyqimit të veprës.<sup>111</sup>

Nëse prej momentit të fillimit të shqyrtimit deri në përfundimin e tij Ligji ndryshon, nuk shfrytëzohen dispozitat e ligjit i cili është më i butë për kryerësin ( siç është situata në të drejtën ndëshkimore materiale) por në procedurën e rregullt ndëshkimore (hetuesi, ngritje të aktakuzës, shqyrtim kryesor dhe shpallja e aktgjyqimit, procedura pas mjeteve të rregullta ligjore) "Ligji i mëvonshëm zbatohet në mënyrë të obligueshme."<sup>112</sup>



<sup>111</sup> Nikola Matovski, Vlefshmëri sipas kohës, e drejta ndëshkuese e procesit, pjesa e përgjithshme, 2003 fq 85.

<sup>112</sup> Kambovski, E drejta ndëshkuese, pjesa e përgjithshme, Shkup 2004.

Në pajtim me këtë që u tha duket se teoria ndëshkimore juridike është në disproporcion me nenin 594 të dispozitave kalimtare dhe përfundimtare të LPP<sup>113</sup>, sipas të cilit procedurat penale që nuk kanë përfunduar sipas dispozitave të LPP të vjetër do të përfundohen sipas dispozitave të ligjit më të vonshëm nëse ato janë më të volitshme për kryerësin<sup>114</sup>.

Mosgatishmëria e gjykatësve që të marrin qëndrim sa i përket çështjes së kompensimit të dëmit jo material viktimave të tregtisë me njerëz, rezulton me të dhënë dështuese sipas të cilës në gjithsej 15 lëndë të zgjidhura lidhur me veprat penale "ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit" dhe "tregtisë me njerëz" në periudhën prej janarit deri në shtator 2005 për asnjë kërkesë nuk është marrë vendim pozitiv. Të njëjtit lëvizim në lartësi prej 100.000 deri në 2000.000 denarë.

Vendim për kompensimin e dëmit material viktimave të tregtisë me njerëz dhe prostitucion me dhunë, deri në fund të muajit korrik 2005 është marrë vetëm në 2 lëndë. I njëjti i dedikohet shumës prej 98.023 den.

**Në një lëndë të vëzhguar në gjykatën themelore në Tetovë (tet 006) lidhur me veprën penale sipas nenit 418-a dhe 418-a të KP, me marrjen e aktgjykimit në të cilin njëri nga të akuzuarit shpallet fajtor, gjykatësi ka përcaktuar që të kompensohet shpenzimet materiale në lartësi prej 98.023,00 denarë. Kjo është lënda e parë ku është vendosur pozitivisht sa i përket kërkesës së këtillë.**

Për shkak të kërkesës pronësore-juridike në procedurën penale mund të caktohen masa të përkohshme për sigurimin e kërkesës pronësore-juridike që është krijuar për shkak të kryerjes së veprës penale.

Në të vërtetë, në pajtim me nenin 203-a të LPP gjykatësi hetues ose këshilli me vendim mund të përcaktojë sigurim të përkohshëm<sup>115</sup> të pronës ose të mjeteve që janë në lidhje me veprën penale.<sup>116</sup>

Me këtë rast, prona dhe mjetet që janë lëndë e sigurimit vihen nën mbikëqyrje të gjykatës.

Deri më tash në lëndët e vëzhguara nga ana e Koalicionit, në asnjë lëndë nuk është bërë sigurimi i pronës ose i mjeteve lidhur me veprën penale, që habit edhe më shumë veçanërisht nëse merret parasysh se tregtia me njerëz është një nga format më të paguara të krimit të organizuar dhe se kriminelët shfrytëzojnë çdo lloj mënyre të mundshme për mbulimin e pronës (për shembull, përmes bartjes personave të afërt të tij e ngjashëm). Por, duke marrë parasysh se viktima nuk mund të kompensohet në mënyrë tjetër përveç nga prona e kryerësit, është më se i nevojshëm kumtimi i masave për sigurim të përkohshëm të pronës.

## **Konkluzione:**

**Në gjykatat themelore në Maqedoni përkundër mundësive mjaft të gjera të dhëna me ligj për kompensimin e viktimave të tregtisë me njerëz, ende nuk është zbatuar dhe zhvilluar praktika për sigurimin e kompensimit të dëmit material dhe jo material të bërë me kryerjen e veprës.**

---

<sup>113</sup> Sipas tekstit të pastruar, dispozitë që nuk ekziston në LPP, duke përfshirë edhe dy novelat

<sup>114</sup> Formulimi i këtillë në nenin 597 nga LPP, pa përcaktimin preciz cilat janë ato situata në të cilat lejohet përdorimi i "ligjit më të butë për kryerësin" shkakton kritikë të ashpër nga ana e pjesëmarrësve në këshillimit e Shoqatës për të drejtën penale dhe kriminologji të Maqedonisë në temën: Politika juridike ndëshkuese në Republikën e Maqedonisë ( 21-23 shtator 2005).

<sup>115</sup> Nën sigurimin e përkohshëm të pronës ose mjeteve nënkuptohet edhe ngrirje e përkohshme, konfiskim, mbajtje të fondeve, llogarive bankiere dhe transaksioneve financiare ose leverdive nga vepra penale..

<sup>116</sup> ...Kur janë plotësuar kushtet për konfiskimin e pronës ose interesit pronësor, gjykata me shërbim zyrtar do të urdhërojë masa të përkohshme për sigurim..neni.489 nga LPP.

Me përcaktimin e obligimit të detyrueshëm për gjykatësin që me aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, të vendosë edhe për kërkesën pronësore juridike në procedurën penale, qoftë menjëherë qoftë me marrjen e vendimit plotësues, ligjvënësi ka krijuar kushte për realizimin e kompensimit më të shpejtë viktimave të tregtisë me njerëz. Për fat të keq këto dispozita ende nuk janë sendërtuar në praktikën e gjykatave të vendit. Në R. Të Maqedonisë nuk është marrë vendim për kompensimin e dëmit material viktimave të tregtisë me njerëz ose prostitucionit me dhunë.

Dispozitat për konfiskimin e pronës ose dobisë pronësore të fituar me vepër penale si dhe dispozitat për sigurimin e përkohshëm të pronës ose mjeteve që janë në lidhje me këtë vepër, zbatohen rrallë herë në praktikën e gjykatave tona.

## **Rekomandime:**

Megjë viktima e tregtisë me njerëz për shkak të mosekzistimit të fondeve shtetërore për zhdëmtim nuk mund të kompensohet në mënyrë tjetër përveç se nga prona e kryerësit, është më se e qartë nevoja shfrytëzimit më të shpeshtë të dispozitave të KP për konfiskimin e pronës dhe të dobisë pronësore të fituar me vepër penale si dhe e dispozitave për sigurimin e përkohshëm të pronës ose të mjeteve që janë në lidhje me atë vepër. Konfiskimi i fitimeve kriminele njëherësh mund të ketë edhe veprim më të fuqishëm frikësues se sa dënimi me burg i cili në Maqedoni për shkak të politikës së butë të gjykatave me rastin e matjes së dënimit, më së shpeshti lëviz nën minimumin e veçantë ligjor.

Respektimi i dispozitave nga Ligji për procedurë penale që i dedikohen kërkesës pronësore juridike, paraqet imperativ të domosdoshëm për sigurimin e mbrojtjes së interesit të viktimës përkatësisht të forcimit të pozitës së saj në procedurën para gjykatës.

Shfrytëzimi i mendimit (ekspertizës) të personave profesionistë që janë të obliguar për dhënien e përkrahjes psikologjike viktimave, menjëherë pas pranimit të tyre në Qendrën transitorë, si mjet dëshmuës në procedurë, veçanërisht në kushtet kur nuk është kryer ekspertizë tjetër e gjendjes psikologjike të viktimës para se e njëjta të kthehet në vendin amë, paraqet një zgjidhje të dëshiruar për shkak të caktimit të bazës dhe shumës së kompensimit të drejtë viktimave në tregtinë me njerëz.



## 7

# Zgjatja e procedurës

Në procedurën penale Gjykata është e obliguar ti ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të pengimit të zgjatjes së procedurës dhe pengimit të keqpërdorimit të të drejtave të cilat u takojnë personave që marrin pjesë në procedurë.

Procedura e shpejtë dhe efektive nga njëra anë, duhet të mbrojtë të drejtën e të akuzuarit për mbrojtje cilësore dhe efektive, por nga ana tjetër duhet ta pengojë humbjen e dëshmive të cilat e ngarkojnë, veçanërisht nëse merret parasysh fakti se një nga instrumentet më të forta në luftën kundër tregtarëve me njerëz paraqet dëshmia e viktimës, kurse sigurimi i pranisë së saj shpesh herë është e lidhur me vështirësi të mëdha. Në të njëjtën kohë zgjatja e procedurës shpie në zvogëlimin e gjasave të viktimës për kompensim të drejtë për dëmin e pësuar material dhe jo material.

Një numër i madh faktorësh, individualë dhe kumulativë, ndikojnë në zgjatjen e procedurës në lëndët lidhur me tregtinë me njerëz në radhë të parë duke u nisur nga të ndërlikuarit e lëndës (numri i akuzave, numri i të akuzuarve, dëshmitarët dhe sigurimi efikas i pranisë së tyre në gjykatë), sjellja e të akuzuarit, sjellja e palëve në kontest, përkatësisht (keq)përdorimi i të drejtave të dhëna në pajtim me ligjin, fakti se i akuzuari /të akuzuarit është/janë ose nuk janë në paraburgim, sjellja e gjykatësit dhe administrata gjyqësore, e deri te pajisja teknike e gjykatave.

## 13. Të ndërlikuarit e lëndës


Në pajtim me të dhënat e marra nga vëzhgimi i lëndëve penale në lëmin përkatës, është verifikuar se në kuadër të një lënde ndodh që si të akuzuar të paraqiten një numër më i madh i njerëzve edhe atë më shpesh për një vepër penale.<sup>117</sup>

Megjithatë, numri i lëndëve në të cilat paraqiten më tepër persona të akuzuar, në raport me lëndët të cilat zhvillohen kundër një të akuzuari, është shumë më i vogël, që na shpie në përfundimin se faktori "numër

<sup>117</sup> Në 25% të lëndëve bëhet fjalë për akuzë për 2 vepra penale (kontrabandë e migruesve me falsifikimin e dokumenteve (2), Tregtia me njerëz dhe ndërmjetësimi gjatë kryerjes së prostitucionit (2) Tregti me njerëz dhe kontrabandë e migruesve (1) Tregti me njerëz dhe falsifikim i dokumenteve (1), Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit dhe keqpërdorimi i detyrës zyrtare (1)).




të akuzuarish” jo gjithnjë ka rol vendimtar në procesin e zgjatjes së procedurës. Gjithsesi nga kjo ekzistojnë përjashtime:



Në një lëndë të vëzhguar para Gjykatës themelore në Tetovë (Tet 007) në lidhje me veprën penale tregti me njerëz, të akuzuar paraqiten 10 persona. Në seancën re parë të vëzhguar të pranishëm kanë qenë 7 persona të akuzuar, për 2 nuk ka pasë dëshmi për thirrje të rregullt, ndërsa një person është thirrur në rregull megjithatë mungon. Në seancën e ardhshme kanë munguar 4 prej 10 të akuzuarve. Gjendja ishte e pandryshuar edhe në seancën e tretë vijuese të kësaj lënde (një person ka qenë në arrati), në të cilën gjykatësi ka marrë vendim për arrestimin e 2 personave të akuzuar. Përfundimisht në gjykimin të ardhshëm është siguruar prania e 9 prej 10 personave (një person edhe më tutje ka qenë në arrati), megjithatë kësaj radhe shkak për shtyrje ka qenë mungesa e njërit prej mbrojtësve, kurse është fjala për mbrojtje të obligueshme.

Sa i përket numrit të viktimave, në 52% të lëndëve të përgjithshme, si viktimë në procedurë paraqitet një person.




Verifikimi i gjendjes faktike e cila përfshin ngjarjen penale dhe karakteristikat e personit i cili gjykohet si dhe gjendja juridike e cila do të thotë gjetje të dispozitës juridike e cila duhet të zbatohet në situatën e caktuar faktike gjatë gjykimin të çdo lëndë penale, paraqet aktivitet më të rëndësishëm të gjykatës.

Verifikimi i drejtë i fakteve realizohet me zbatimin dhe vlerësimin e fakteve. Nga lënda e dëshmisë<sup>118</sup>, nga lloji dhe numri i mjeteve dëshmuese<sup>119</sup> si dhe nga mënyra e zbatimit të tyre varet vëllimi i punës së gjykatës dhe organeve tjera në procedurë si dhe shpejtësia me të cilën realizohet procedura

<sup>118</sup> Në pajtim me neni 314 paragrafi 2 nga LPP, dëshmimi i përfshin të gjitha faktet për të cilat gjykata mendon se janë të rëndësishme për gjykim të rregullt. Mënyra e këtillë e përgjithshme për rregullimin e lëndës së dëshmimit është rezultat, para së gjithash, i pa mundësisë të vendosen rregulla të përgjithshme për të gjitha situatat e ndryshme në praktikë, si dhe i nevojës t’i mundësohet gjykatës ti filtrojë faktet më pak të rëndësishme nga ato më të rëndësishmet, me qëllim të eliminimit të rizikut nga prolongimi tejet i madh i procedurës.

<sup>119</sup> LPP nuk i numëron në mënyrë taksative mjetet e veçanta të dëshmisë, por vetëm përmban dispozita sipas të cilave gjykata sjell aktin e gjykimin vetëm mbi fakte dhe dëshmi që janë nxjerrë në shqyrtimin kryesor dhe njëherësh është i obliguar që me ndërjegje të vlerësojë çdo dëshmi në veçanti dhe në lidhje me dëshmitë tjera, kurse në bazë të vlerësimi të tillë të nxjerr përfundim vallë ndonjë fakt është i dëshmuar. (neni.339).



Analiza e lëndëve të vëzhguara tregoi se në shqyrtimin kryesor më së shpeshti krahas shikimit në dëshmitë materiale bëhet edhe marrja në pyetje e dëshmitarit si dhe leximi i deklaratës së dëshmitarit nga procesverbali. Përderisa leximi i konstatimit dhe mendimit të ekspertit është bërë vetëm në 3 lëndë,

dëgjimi i drejtpërdrejtë i ekspertit është paraqitur si mënyrë e zbatimit të dëshmisë vetëm në dy lëndë


Llojshmëria e madhe e të dëshmimeve materiale të cilat paraqiten në lëndët e kryerjes së tregtisë me njerëz, pengon klasifikimin e tyre të saktë. Krahas të dhënave për identitetin dhe vendin e të akuzuarit ose të dëmtuarës siç janë për shembull ekstrakti nga evidenca ndëshkimore, fotokopjet nga dokumentet personale dhe leja e vozitjes, shkresa nga sektori për bashkëpunim ndërkombëtar NCB Interpol-Shkup, shkresa nga sektori i punëve të brendshme, telegram nga aeroporti Petrovec, kërkesa për dhënien e lejes për qëndrim të përkohshëm, kërkesa për vendosje në qendrën transitore, më së shpeshti kryhet edhe zbatimi i dëshmimeve me leximin e procesverbaleve për veprime të ndërmarra proceduese, si për shembull: procesverbali për njohjen e lëndëve dhe të personave, procesverbali për dorëzimin e sendeve të marra, procesverbali për pranimin e fletëparaqitjes penale nga e dëmtuara, procesverbali për bastisjen e banesës- shtëpisë, procesverbali për ballafaqimin me të akuzuarin. Me dëshmitë e përmendura as për së afërmi nuk shteren të gjitha solucionet e mundshme të cilat i jep praktika..

## Konkluzione:


Në më tepër se gjysmën e numrit të përgjithshëm të lëndëve të vëzhguara është fjala për një person të akuzuar në procedurën në gjykatë dhe për një viktimë të veprave lidhur me tregtinë me njerëz. Në të njëjtën kohë në 75 % të lëndëve aktakuza i dedikohet vetëm një veprë penale.

## 14. Arsyet për shtyrjen e procesit gjyqësor

Kohëzgjatja e seancave paraqet indikatorë përkatës për të përcaktuar se sa shpesh shtyhen seancat gjyqësore. Siç mund të shihet nga tabela e mëposhtme në të shumtën e rasteve seancat kanë zgjatur më pak se 15 minuta. Kjo shpie në përfundimin se seancat më shpesh shtyhet menjëherë, pa filluar shqyrtimi kryesor.



Si arsye për shtyrjen e shqyrtimit kryesor<sup>120</sup> në praktikën tonë, në lëndët e vëzhguara lidhur me tregtinë me njerëz janë paraqitur arsyet që vijojnë:



## Prania

Sigurimi i pranisë së aktorëve relevantë në procedurë ndikon në cilësinë dhe zgjatjen e procesit gjyqësor e me këtë edhe në shkallën e respektimit të standardit ndërkombëtar dhe të vendit "gjykim në afat të arsyeshëm"

Sa reflektohet mungesa përkatësisht prania në shqyrtimin kryesor e të akuzuarit, prokurorit publik, dëshmitarëve, të dëmtuarës dhe ekspertit ndaj zhegjitjes së procedurës mund të verifikohet nëse numri i shlyerjeve të shqyrtimit kryesor vihet edhe në korrelacion me praninë e çdo personi të lartpërmendur veç e veç.

### 1. I akuzuari dhe masat për sigurimin e pranisë së tij

Mungesa e të akuzuarit/akuzuarve është arsye për shtyrjen e shqyrtimit në 21% të rasteve.


Me ndryshimet e reja të LPP në pjesën e masave për sigurimin e pranisë së të akuzuarit dhe për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale, përveç masave ekzistuese: ftesë, arrestim, premtim i të akuzuarit se nuk do të largohet nga vendqëndrimi, garancia dhe paraburgimi, të cilët përsuan ndryshime të caktuara, janë përfshirë edhe "**Masa të tjera preventive**" për sigurimin e pranisë së të akuzuarit si dhe masa **paraburgim shtëpiak**.

Në masat e tjera preventive bëjnë pjesë: ndalimi i braktisjes së vendbanimit përkatësisht vendqëndrimit, obligimi i të akuzuarit që të paraqitet herë pas here te personi i caktuar zyrtar ose te organi kompetent shtetëror, marrja e përkohshme e dokumentit të udhëtimit ose e ndonjë dokumenti tjetër për kalimin e kufirit shtetëror, përkatësisht ndalimi e dhënies së tij dhe marrja e përkohshme e lejes së vozitjes, përkatësisht ndalimi dhënies së saj.

<sup>120</sup> Jovan Proevski, Milan Krckovski, Prolongimi dhe ndërprerja i shqyrtimit kryesor, Ligji për Procedurë Penale-shpjegime, komente, praktikë gjyqësore dhe shembuj për zbatim praktik, Akademik, Shkup, 1997, fq291.

Duke marrë parasysh se masa të caktuara detyrimi në masë të konsiderueshme e përkufizojnë lirinë e qytetarëve dhe bien ndesh me parimin e presumpcionit të pafajësisë së të akuzuarit, do të thotë që në situatën kur një person do të shpallet i pafajshëm atëherë edhe përkufizimet më të vogla paraqesin shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara të qytetarit e njëherësh duke u nisur nga domosdoja e pamundësisë të pengimit të procedurës dhe të shmangies së represionit penal nga ana e disa personave, imponohet nevoja e gjetjes së një balance më adekuate në mes të kënaqjes së interesave individuale dhe interesit të shoqërisë që të mbrohet nga krimi.


Sa shpesh janë përdorur dhe cilat masa janë përdorur për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në lëndët lidhur me tregtinë me njerëz mund të konkludohet prej të dhënave që vijojnë:



Në të vërtetë, në suaza të 32 lëndëve të vëzhguara, nga gjithsej 83 persona të akuzuar<sup>121</sup>, masa e paraburgimit<sup>122</sup> e cila paraqet formën më të rëndë të detyrimit procesor<sup>123</sup> i shqiptohet vetëm në rast se ndonjë masë më e butë nuk mund ti mbrojë interesat e procedurës penale, është caktuar vetëm ndaj dhjetë personave (12%)<sup>124</sup>

Në përputhje me nenin 183 të LPP, kohëzgjatja e paraburgimit duhet të sillet në kohën më të shkurtër të domosdoshme<sup>125</sup>, kurse të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale duhet të veprojnë me urgjencë të veçantë<sup>126</sup>.

#### Merka pritvor soglasno krivi~noto delo



Në lëndën e vëzhguar në gjykatën themelore në Strugë (Str 001), në lidhje me veprën penale tregti me njerëz në të cilin personi i akuzuar është në paraburgim prej 14.12.2004 shqyrtimi i mbajtur më 9.03.2005 shtyhet për 44 ditë në përputhje me arsyetimin nga ana e gjykatësit, mospasje të terminit të lirë.

<sup>121</sup> Gjashtë persona të akuzuar nga gjithsej 83, janë tani më në burg..

<sup>122</sup> Stojanov I., Bazat për përcaktimin e paraburgimit në procedurën penale të Maqedonisë, Vjetor i fakultetit për siguri, 2000/2001, fq38

<sup>123</sup> K. de Rover, Paraburgim, në shërbimin për mbrojtje, të drejtat e njeriut dhe e drejta humanitare për forcat policore dhe të sigurisë MKCM, fq.237

<sup>124</sup> Andaj në këtë numër nuk hyn edhe 6 migrues ndaj të cilëve është caktuar paraburgim dhe të cilët janë shpallur si fajtor për vepër penale falsifikim i dokumenteve, për të cilën është gjykuar bashkë me vepër kontrabandim i migruesve. Është interesant e dhëna në një numër më të madh të rasteve se janë paraburgosur migruesit të cilët kanë qenë të kontrabanduar, për dallim nga atë të cilët kanë bërë kontrabandim..


<sup>125</sup> Nikola Matovski, Zgjatja e paraburgimit, Sistemi i procedurës ndëshkuese në RM, Vjetor i fakultetit të drejtësisë në Shkup, 1999/2001 vëllimi 39 libri 2, fq221

<sup>126</sup> Pavel Manev, Vërejtje dhe propozime në lidhje me paraburgimin, Revia Maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji, 1995, fq97; Cvetan Cvetkovski, Mundësi kushtetuese dhe kufijtë e përcaktimit ligjor të paraburgimit dhe të masave tjera për sigurimin e pranisë së të akuzuarit, Revia Maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminalistikë, 1995, fq 49.

Analiza e të dhënave tregoi se në numrin më të madh të rasteve kohëzgjatja e paraburgimit lëviz prej 75 deri 90 ditë<sup>127</sup>

Në tre lëndë masa e paraburgimit ka zgatur deri në 30 ditë. Në dy raste në përputhje me nenin 175 paragrafi 3 është zëvendësuar me masë më të butë përkatësisht me garancinë si dhe me premtimin e të akuzuarit se nuk do të braktisë vendbanimin përkatësisht vendqëndrimin.

Korniza kohore e paraburgimit




Në gjashtë lëndë<sup>128</sup> për 9 personat e akuzuar (11% nga numri i përgjithshëm i të akuzuarve të cilët, edhe pse janë ftuar në rregull, nuk janë paraqitur në shqyrtimin kryesor dhe mungesën e vet nuk e kanë arsyetuar, është dhënë urdhëresë për arrestim.

Në një lëndë të vëzhguar në gjykatën themelore Tetovë (tet 008) në lidhje me veprën penale tregti me njerëz për të akuzuarin për të cilin paraprakisht ishte dhënë urdhëresa për arrestim, kishte arritur njoftimi te gjykatësi nga SPB Tetovë se nuk mund ta gjejnë. Ndërkaq i akuzuari është paraqitur në seancë, kurse mbrojtësi i tij ka dorëzuar vërtetim se i njëjti ka qenë në spitalin e Ohrit në rehabilitim dhe prandaj nuk ka ardhur në seancën paraprake. Pasi gjykatësi nuk ka dërguar ftesë për ta sjellë të akuzuarin e dyte në të njëjtën lëndë i cili gjendet në vuajtjen e dënimit me burg në SHNP në Idrizovë duke supozuar se seanca në fjalë do të shtyhet e më qëllim që të mos bëhen shpenzime të panevojshme për rrugë, përfundimisht e njëjta vërtetë është shtyrë për shkak të mungesës së të akuzuarit të dytë.

Premtim të të akuzuarit se nuk do ta braktisë vendbanimin, përkatësisht vendqëndrimin me paralajmërim se do të përcaktohet paraburgimi në rast të shkeljes së obligimit të marrë është kërkuar nga katër të akuzuar.

## 2. Mungesa e viktimës

Mungesa e viktimës/dëshmitar/i dëmtuar paraqet arsye e shpeshtë (22%) për shtyrjen e procedurës<sup>129</sup>.



<sup>127</sup> Në vitin 1992, zgjatja mesatare e paraburgimit nga dita e paraburgimit deri në fillim e gjykimit në Angli ka qenë 11 javë, G. Klajxiev, Të drejtat e personit të paraburguar në gjykim të shpejtë, Bezbednost, 1994, nr.1 fq 55

<sup>128</sup> Pas dy tentimeve të pasuksesshme që të sigurohet prania e dhjetë të akuzuarve në një lëndë në gjykatën themelore të Tetovës për seancës e tretë është dhënë urdhër për arrestimin e tre nga të akuzuarit

<sup>129</sup> Duke filluar nga domethënia e jashtëzakonshme e dëshmisë së viktimave të tregtisë me njerëz për epilogun e procedurës penale, duke marrë parasysh para së gjithash faktin se kryesisht janë përjashtime të vogla, bëhet fjalë për shtetase të huaja,

Në suaza të 26 lëndëve të ardhshme (nga gjithsej 32) në lidhje me veprat penale "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit" dhe "Tregtisë me njerëz", vetëm në 17 raste<sup>130</sup> (nga gjithsej 54 viktima) me ndihmën e qendrës SEKI është mundësuar prania e viktimave dëshmitarë në procedurë. Andaj, në 9 situata për shkak të mungesës së kushteve për mbajtjen e shqyrtimit kryesor, njëherësh edhe për shkak të pengesave të mëdha në lidhje me sigurimin e pranisë së viktimave/dëshmitarë përsëri për seancën e ardhshme, gjykatësi ka sjell vendim për shqyrtim të të dëmtuarit/viktimës/dëshmitarit jashtë shqyrtimit kryesor.

Në një lëndë (Gos 001) të vëzhguar në gjykatën themelore të Gostivarit në lidhje me nenin 418a nga KP, prania është siguruar vetëm për njërën nga katër viktimat/dëshmitarë në procedurë. Sepse gjykimi është shtyrë për shkak të mungesës së të akuzuarit i cili nuk ka qenë i ftuar në mënyrë korrekte, gjykatësi ka urdhëruar dëgjim të viktimës nga Bullgaria jashtë shqyrtimit kryesor.

Në lëndën (Ohër 002) e vëzhguar në gjykatën themelore në Ohër në lidhje me nenin 418 a i KP, në shqyrtim ka qenë e pranishme vetëm një viktimë/dëshmitarë në procedurë. Sepse gjykata është shtyrë pas propozimit të mbrojtësve për të përgatitur mbrojtjen në lidhje me përcaktimin e akuzës nga prokurori publik, gjykatësi ka urdhëruar dëgjimin e viktimës jashtë shqyrtimit kryesor.

Sipas nenit 322 i LPP, këshilli mund të urdhërojë që dëshmitari, ardhja e të cilit në shqyrtim kryesor është dukshëm e penguar apo e pamundur, qëndrimi i të cilit është i rëndësishëm për procedurën, të dëgjohej jashtë shqyrtimit kryesor.

Përdorimi i kësaj dispozite ligjore në situata kur prania e viktimave/dëshmitarëve është e përcjellë me shpenzime të mëdha financiare, maltretim plotësues të viktimës, aktivizim të sistemit për bashkëpunim ndërkombëtar<sup>131</sup>, së paku deri në momentin e sjelljes së bazës ligjore për sigurimin e qëndrimit të viktimës gjatë kohës që zgjat procedura<sup>132</sup>, paraqet solucion logjik dhe të nevojshëm.

dhe që shpeshherë atëkohë janë kthyer në vendin amë (sipas të dhënave të IOM, përqindja e viktimave të tregtisë me njerëz të cilën nuk kanë pasur dokumente të vlefshme që do të thotë edhe qëndrim ilegal në Maqedoni në periudhën prej vitit 2000 deri sot, lëviz prej 53% deri 88%), rregullimi i çështjes së dërgimit të ftesës për dëshmi, respektivisht sigurimi i pranisë së viktimës/dëshmitar, meriton kujdes. Me qëllim që të sigurohet bashkëpunim më i ngushtë në gjyqësi dhe lehtësimi i shkëmbimit të ndërsjellët juridik, Maqedonia, përveç Konventave që ka nënshkruar, ka nënshkruar edhe disa marrëveshje bilaterale për dhënien e ndihmës juridike në procedurat penale. Kështu në **marrëveshjen mes Qeverisë së Maqedonisë dhe Republikës së Kroacisë për ndihmë juridike në procedurat penale dhe civile**<sup>129</sup>, palët në marrëveshje detyrohen "...të dërgojnë dhe sigurojnë në formë të shkruar, shkëmbajnë njoftime për çështje të legjislaturës dhe evidencës ndëshkuese dhe të kryejnë veprime të veçanta hulumtuese, dërgimin e materijaleve të dëshmisë, dëgjimin e të akuzuarve, dëshitarëve, palëve, ekspertëve, kontroll gjyqësor në ekspertizë etj.." sipas nenit 28 nga **Marrëveshje për bashkëpunim juridik bë lëndë penale dhe civile** mes R të Maqedonisë dhe Turqisë<sup>129</sup>, nëse organi gjyqësor nga ana lutës vlerëson se është e nevojshme prania e dëshmitarit, ai shkruan këtë në kërkesën e tij për dërgimin e ftesës gjyqësore. Andaj, mos prania e dëshmitarit nuk i nënshtrohet ndëshkimit në të holla apo ndonjë sanksioni tjetër. Dispozita me të cilat rregullohet se në ftesën e dëshmitarit nuk guxon të ketë kërcënim me masë të detyrimit në rast të mos paraqitjes në gjykatë, përmbajnë të gjitha marrëveshjet bilaterale në këtë sferë.

<sup>130</sup> Bëhet fjalë për viktimë, shtetase të huaja

<sup>131</sup> Marrëveshjet bilaterale të rëndësishme për ballafaqim me problemin e tregtisë me njerëz që R e Maqedonisë ka nënshkruar me vende të ndryshme mund të ndahen në disa kategori dhe atë marrëveshje: për ndihmë juridike në lëndët penale (dhe civile), ekstradicion, kthim, respektivisht marjen e personave hyrja e të cilëve dhe/ose qëndrimi është në kundërshtim dispozitat ligjore, ekzekutimit të ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në lëndët penale, bashkëpunim në luftën kundër terrorizmit, tregtisë së ndaluar me drogë dhe krimin të organizuar, bashkëpunim me Ministrinë për punë të brendshme të Maqedonisë dhe Ministrive të punëve të brendshme të shteteve tjera etj.

<sup>132</sup> Sigurimi i qëndrimit legal i viktimave të tregtisë me njerëz në vendet në të cilat është zhvilluar tregtia ka domethënie kyçe nga dy aspekte: e para, për shkak të sigurimit të mbrojtjes cilësore të viktimës dhe të drejtat e saj dhe e dyta, për shkak të sigurimit të mjetit efikas për ndjekje penale dhe sanksionim të kryerësve të veprave penale në lidhje me tregtinë me njerëz. Statusi i shtetaseve të jashtme (lëvizja dhe qëndrimi) në Republikën e Maqedonisë rregullohet me Ligjin për lëvizje dhe qëndrim të të huajve.<sup>132</sup>, si dhe me rregulloren për kryerjen e punëve të Ministrisë për punë të brendshme<sup>132</sup>. As në Ligj, as në rregullore, nuk ekzistojnë dispozita të cilat saktësisht do të kenë të bëjnë me viktimat e tregtisë me njerëz dhe sipas të cilave do të ishin trajtuar më ndryshe nga trajtimi që ka qdo i huaj në Republikën e Maqedonisë.

Leximi i qëndrimit të viktimës/dëshmitar të dhënë para gjykatësit hetues ndodh në numër shumë më të madhtë rasteve sesa dëgjimi i saj në shqyrtimin kryesor<sup>133</sup>

Arsyet për të cilat është sjellë vendim që të lexohet qëndrim i dhënë paraprakisht i dëshmitarit, dhe jo me dëgjim të drejtpërdrejtë, janë shumë të ndryshme:

Në lëndën (Gos 001) e vëzhguar në gjykatën themelore të Gostivarit në lidhje me nenin 418 të KP, pas deklaratës së pranuar nga MPB se njëri nga katër dëshmitarët viktimë është gjetur por nuk dakordohet të dëshmojë, këshilli ka sjellë vendim për refuzim të propozimit të mbrojtësit për dëgjim të drejtpërdrejtë të saj.<sup>134</sup>

Në lëndën (Tet 002) të ndjekur në gjykatën themelore të Tetovës në lidhje me nenin 191 të KP, organet shtetërore nuk kanë qenë në mundësi të gjejnë të dëmtuarën në procedurë. Të gjithë pjesëmarrësit në procedurë, në pyetjen se vallë është e nevojshme të sjellet ajo, janë përgjigjur se s’ka nevojë për këtë.

Në lëndën (Tet 005) të vëzhguar në gjykatën themelore të Tetovës në lidhje me nenin 418-a nga KP, Zëvendësi i prokurorit publik ka propozuar sjelljen e të dëmtuarës/viktimë për shkak të ballafaqimit me të akuzuarit. Arsyet ka qenë dallimi tejet i madh i deklaratës të akuzuarve me deklaratën e të dëmtuarës të dhënë në procesverbalin e hetimit. Gjykata ka refuzuar propozimin me n:shpjegim se viktimë është vendosur në Qendrën e Transitit<sup>135</sup> më tepër se pesë muaj dhe për atë kohë është mundur të bëhet ballafaqim.

### **3. Prokuroria Publike**

Nga gjithsej 102 seanca të vëzhguara, prokurori publik ose zëvendësi i tij nuk janë paraqitur në katër<sup>136</sup>. Arsyet për mungesën e tyre nuk janë të njohura.

Në lëndën e vëzhguar në gjykatën themelore në Gostivar (Gos 002), në seancën e parë të vëzhguar, zëvendësi i prokurorit publik përmes telefonit ka marrë pjesë në procedurë. Respektivisht, pasi që viktimë/dëmtuar/dëshmitar në procedurë nuk ka qenë e pranishme në seancën në fjalë, zëvendësi i Prokurorit publik "me telefon" nuk është pajtuar me propozimin të lexohet deklarata e të dëmtuarës dhe ka kërkuar të sigurojë praninë e saj në seancën e ardhshme.

Në seancën e dytë të vëzhguar që është shtyrë menjëherë për shkak të mos mospjesëmarrjes së të dëmtuarës në procedurë, kryetari i këshillit ka konstatuar se **Zv.P.P mbetet në propozim për dëgjimin e drejtpërdrejtë të njëjtës, edhe pse Zv.P.P përsëri nuk ka qenë prezent në gjykatore.**

---

<sup>133</sup> Ndodh që edhe krahas së thënës nga gjykatësi se do të lexohet qëndrimi i të dëmtuarës/dëshmitarit, e njëjta mos të ndodh në shqyrtimin kryesor.

<sup>134</sup> Sipas LPP çdo person, qoftë shtetas i vendit apo i jashtëm, i cili qëndron në territorin e shtetit tonë, është i obliguar të dëshmojë respektivisht është i obliguar ti përgjigjet ftesës së gjykatës dhe të jep qëndrimin e tij (përveç në raste kur është i liruar nga ky obligim me dispozita të veçanta ligjore). Situata është e ndryshme kur bëhet fjalë për person që qëndron në territoret e vendit tonë. Respektivisht, në pajtim me të gjitha marrëveshjet bilaterale për ndihmë juridike në lëndët penale (dhe civile) që Republika e Maqedonisë ka nënshkruar, mos ardhje e dëshmitarit nuk i nënshtrohet dënimit në të holla ose ndonjë sanksion tjetër, kurse në ftesë nuk guxon të ketë kërcënim për masë të dhunshme në rast se ai nuk paraqitet në gjykatë.

<sup>135</sup> Pas hapjes së qendrës së transitit për të huaj (i pari në këtë rajon) nga ana e Qeverisë së Maqedonisë, viktimat e tregtisë me njerëz pas identifikimit dhe caktimit të statusit të viktimës nga ana e policisë, sjellen në qendrën. Më 07.03.2001 nga Ministria e punëve të brendshme është sjellë Udhëzim për mënyrën e punës së qendrës së transitit për të huaj, derisa më 04.04.2001 u bë pranimi i parë për persona. Qendra gjendet në suaza të Sektorit-MPB për punë kufitare-seksioni për migrim ilegal. Nga themelimi i qendrës deri më qershor të vitit 2005, janë vendosur 682 persona. Më tepër për punën strukturore të qendrës së Transitit për të huaj dhe rolin e saj shiko:Praktikum për luftën kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal, Organizata Ndërkombëtare për Migrimin, Misioni në Shkup, 2005, f 36.

<sup>136</sup> Në dy lëndë.

Në seancën e ardhshme e cila për arsye të njëjta si dhe në të kaluarën menjëherë të shtyrë, në zyrën e kryetarit të këshillit, Zv.P.P përsëri nuk është paraqitur.

Në seancën e fundit, shqyrtimi kryesor ka filluar pa prezencën e Zv.P.P i cili në thirrjen (telefonike) nga gjykatësi, është paraqitur dhjetë minuta më vonë. Në mënyrë të shkurtë i është prezantuar se ka filluar pyetja e të akuzuarit.

Sipas nenit 291 nga LPP<sup>137</sup>, prania e PP ose Zv të tij është e domosdoshme. Është shkelje thelbësore e dispozitave të procedurës penale nëse shqyrtimi kryesor mbahet pa prezencën e personit, prania e të cilit është e domosdoshme.<sup>138</sup>

#### 4. Gjykatësit porotë

Mosprania e gjykatësve porotë, sipas analizave tona, vetëm në një lëndë paraqitet se arsye për shtyrjen e shqyrtimit.

Sipas nenit 283 nga LPP, gjykatësit porotë janë të obliguar pa ndërprerë të jenë të pranishëm në shqyrtimin kryesor. Kryetari i këshillit është i obliguar të konfirmojë vallë këshilli është përbërë sipas ligjit dhe vallë ekzistojnë arsye për shkak të cilave anëtarët e këshillit medoemos të përjashtohen. Pas hapjes së kuvendit, kryetari shpall lëndën e shqyrtimit kryesor dhe përbërjen e këshillit.

Shqetësuese është praktika në disa gjykata që gjykatësi në zyrë të caktojë vallë janë ose nuk janë plotësuar kushtet për mbajtjen e shqyrtimit kryesor, dhe nëse rrethanat e lejojnë, të pranishmit të shkojnë në gjykatore. Duke mos nënçmuar problemin me mungesën e kushteve hapësinore të nevojshme në numër të madh të gjykatave në Maqedoni<sup>139</sup>, në këtë situatë medoemos të vihet në dije edhe për dy probleme dhe pasojat që rrjedhin nga ato.

Respektivisht, në rastet e lartpërmendura, në zyrën e gjykatësit më së shpeshti gjykatësit porotë nuk janë të pranishëm në kuvend (apo gjykim) dhe në kohë të njëjtë, duke pasur parasysh madhësinë e zyrave të gjykatave, kurse viktimat/e dëmtuara vjen në situatë tejet të pavolitshme të jetë shumë afër të akuzuarit ose edhe më keq nëse janë më tepër të akuzuar në procedurë.

Në një lëndë të vëzhguar në gjykatën themelore në Strugë, në lidhje me tregtinë me njerëz sipas nenin 418 p.2, gjatë dëgjimit të dëshmitarit të dytë kryetari i këshillit ka thënë se gjykatësi tjetër ka pasur gjykim dhe do të nevojitet të dalë nga gjykatorja, dhe ka propozuar në çdo rast që të mos zgjatet gjykimi. Edhe përkundër kundërshtimit të Zv. Prokurorit publik i cili ka thënë se kjo është shkelje absolute e dispozitave të LPP gjykatësi i dytë nga këshilli prej pesë gjykatësve e ka lënë gjykatoren 45 minuta para përfundimit të shqyrtimit. Pak më vonë gjykatoren e ka lëshuar edhe një nga gjykatësit porotë kurse gjykimi nuk është ndërprerë, kështu që në afat të shkurtë kohor përbërja e gjykatës ka numëruar tre, në vend se pesë anëtarë.

Në lëndën e njëjtë në seancën e ardhshme, kryetari i këshillit ka filluar shqyrtimin kryesor duke shënuar në procesverbal se janë plotësuar kushtet ligjore për mbajtjen e shqyrtimit kryesor dhe se zv prokurori publik mundet të fillojë me fjalimin e tij të fundit, në mungesë të një gjykatësi porotë. Pasi që zv prokurori publik ka dhënë dy propozime në lidhje me caktimin e identitetit të të dëmtuarës, pas një pauze 15 minutash, gjykata ka sjellë vendim për shtyrje të shqyrtimit kryesor për shkak të përbërjes jo komplete gjyqësore.

<sup>137</sup> Shqyrtimi kryesor i cili është caktuar në bazë të aktit të akuzës do të shtyhet derisa prokurori publik ose personi që e zëvendëson nuk paraqitet në gjykim.

<sup>138</sup> Neni 355 nga LPP.

<sup>139</sup> Raporti përfundimtar i Koalicionit "Të gjithë për gjykime të drejta" periudha korrik 2003 deri korrik 2004 fq 72.



Në një lëndë të vëzhguar (Gos 001) në gjykatën themelore të Gostivarit në lidhje me nenin 418 a nga KP, në zyrën e gjykatësit ku është caktuar seanca nuk kanë qenë prezent gjykatësit porotë. Lënda është shtyrë.

Në një lëndë të vëzhguar (Tet 004) të vëzhguar në gjykatën themelore të Tetovës në lidhje me nenin 418 a nga KP, porota e tretë ka ardhur në gjykim në orën 11:00- edhe pse gjykimi ka filluar në orën 10:00.

Në një lëndë të vëzhguar (Tet 008) të vëzhguar në gjykatën themelore të Tetovës në lidhje me nenin 418a nga KP, shqyrtimi kryesor ka filluar me përbërje jo të tërësishme gjyqësore. Më vonë, gjykatësi i dytë i është bashkangjitur procedurës.

## 5. Dëshmitarë<sup>140</sup>

Mos ardhja e dëshmitarëve ka qenë arsye për shtyrje në 5 raste. Andaj gjykatësi në tre nga këto ka urdhëruar sjellje të detyruar sipas nenit 229 të LPP

Në 7 lëndë, arsyeja për caktimin e seancës së re ka qenë thirrje dhe dëgjim të dëshmitarëve të ri propozuar nga të dyja palët.

## Aktakuza

Kërkesë për përkthim të aktakuzës si arsye për shtyrje paraqitet në dy situata, derisa nevoja për precizim të aktakuzës evidentimit të situatës së re të shqyrtimit në lidhje me identitetin e të akuzuarit dhe të dëmtuarës, ka sjellë deri shtyrjen e vetëm një lëndë të vëzhguar.

Në lëndë të vëzhguar (tet 001) në gjykatën themelore të Tetovës, mbrojtësi njërit nga të akuzuarve ka reaguuar se i akuzuari nuk ka pranuar aktin e akuzës në gjuhën shqipe. Pas kontrollit të të dhënave të lëndës Kryetari i këshillit që kur ka konstatuar se nuk ka dëshmi se i akuzuari ka pranuar aktakuzë (siç kanë pranuar dy të tjerët të akuzuar të kombësisë shqiptare), ka shtyrë shqyrtimin kryesor kurse të akuzuarit menjëherë ka urdhëruar t'i dërgohet akt kuze në përkthyer në gjuhën shqipe.<sup>141</sup>

Në lëndën (Tet 002) të vëzhguar në gjykatën themelore të Tetovës, avokati i të akuzuarit ka propozuar që aktakuza së bashku me dëshmitë e shkruara materiale nga hetimi të përkthehen në gjuhën shqipe sepse i akuzuari nuk e kupton gjuhën maqedonase mjaftueshëm, as alfabetin e saj cirilik. Në pyetjen e gjykatësit vallë prokurori pajtohet me propozimin e mbrojtësit, ai është shprehur se do të mundej të përkthehet vetëm aktakuza, por jo edhe shkrimet tjera me shpjegim se gjatë procedurës hetuese i akuzuari në procesverbal ka deklaruar se mirë e njeh gjuhën maqedonase dhe ka përdorur atë.

Gjykatësi ka sjellë vendim me të cilin refuzohet propozimi i mbrojtësit me shpjegim se ky ka hy në forcë, kurse ato kanë mundur shumë më herët të kërkojnë përkthim. Njëherësh si arsye për shtyrjen e gjykimit në fjalë në marrëveshje me mbrojtësin, është notuar në procesverbal se mbrojtësi më parë ka caktuar kontroll në vend për gjykim tjetër.

Sipas ndryshimeve ligjore të vitit 2004 (neni 8 p 4 nga KP), të akuzuarit që nuk kupton gjuhën në të cilën mbahet procedura, i jepet përkthim i akuzës në gjuhë në të cilën ai është shërbyer gjatë procedurës.

<sup>140</sup> Nuk ka të bëjë me dëshmitarët – viktima eventuale të tregtisë me njerëz, respektivisht të dëmtuarve gjatë procedurës. Prania e tyre është përpunuar në veçanti në pjesën "Prania e viktimës".

<sup>141</sup> Sipas ndryshimeve të reja të LPP (neni 8 p4) të akuzuarit që nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, i mundësohet përkthim në gjuhën të cilën ai kë përdore gjatë procedurës.

Duket se përkthimi i shkresave që u dërgohen qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, kryesisht nuk paraqet problem në procedurën para atyre gjykatave themelore në të cilat ndiqen lëndë në lidhje me tregtinë me njerëz.

## Përgatitje e mbrojtjes

Përgatitja e fjalëve të fundit të mbrojtjes si dhe përgatitja e mbrojtjes në relacion me akuzës të precizuar paraqet faktor për shtyrjen e shqyrtimit në 7% të numrit të përgjithshëm të lëndëve të vëzhguara nga Koalicioni.

## Ekspertizë

Me inkorporimin e paragrafit 5 të nenit 234 të LPP, në pajtim me të cilin gjykata me mendimin e marrë paraprkisht nga eksperti, përcakton afatin në të cilin do të bëhet ekspertiza, legjislatura ka bërë përpjekje për vendosje e kontrollit më të madh ndaj kohës së realizimit të ekspertizës, kurse me vetë këtë edhe largim nga prolongimi i panevojshëm i procedurës.

Në kuadrin e lëmit të tregtisë me njerëz, ekspertiza është paraqitur si shkak për prolongim në tre raste<sup>142</sup>.

Në lëndën e vëzhguar në Janar 2005, para gjykatës themelore në Ohër (Ohër 001), në lidhje me veprën penale sipas nenit 191 të KP, ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit, urdhri për kryerjen e ekspertizës neuropsikiatrike është dhënë më 12.01.2005 me afat prej 2 muajsh. Afati nuk është ruajtur nga ana e ekspertit. Prandaj, shqyrtimi kryesor i cili tashmë është shtyrë për një periudhë kohore prej 69 ditësh, sërish u shty për 55 ditët vijuese.

Gjatë përcaktimit të afateve në të cilat duhet të realizohet ekspertiza doemos duhet ti kushtohet kujdes asaj që e njëjta të mos kalojë periudhën prej 60 ditësh me qëllim që sërish ti iket fillimit të procedurës.<sup>143</sup>

Në lëndë të vëzhguar në gjykatën themelore në Tetovë (Tet 008) në lidhje me veprën penale nga neni 418-a i KP tregti me njerëz, gjykatësi ka ndërprerë gjykimin përderisa nuk vjen neuropsikiatri nga qendra klinike në Tetovë, me qëllim që të vlerësohet aftësia e njërit nga tre të akuzuarit që të jep deklaratë. Njëherazi gjykatësi ka shënuar në procesverbal se sjellja e të akuzuarit sipas mendimit të tij është simulim, por gjykimin e ndërpret për shkak të mbrojtjes së të drejtës të mbrojtjes dhe sigurimit të gjykimin fer. Për shkak të pamundësisë së mbrojtësve që të presin në pritjen e neuropsikiatrit, procesi është shtyrë. Shqyrtimi vijues në të cilin do të ishte i pranishëm eksperti-neuropsikiatër u shty për shkak të mungesës së njërit nga personat e akuzuar<sup>144</sup>. Edhe pas një shtyrje të shqyrtimit për shkak të pamundësisë të njërit nga mbrojtësit që të marrë pjesë në shqyrtim, pason shtyrje e re, kësaj radhe nga shkak se eksperti i thirrur në mënyrë të rregullt nuk është paraqitur para gjykatës themelore.

<sup>142</sup> Pavel Manev, Disa aspekte ndëshkuese juridike të ekspertizave neuropsihjatrike, Revia Maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji, 1998, nr.1 fq 218.


<sup>143</sup> Snezhana Tasi, Funkcioni dhe domethënia e ekspertizës psikiatrike, Revia Maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji 1998, nr. 1, fq. 230.

<sup>144</sup> Seanca nuk është regjistruar në procesverbal, Gjykatësi ka thënë se do ta bëjë këtë më vonë.

## Dërgimi

Gjatë kohë problemi i dërgesës së thirrjeve ishte në qendër të vëmendjes së institucioneve dhe individëve të cilët vepron në kuadrin e gjyqësisë. Shpeshherë, dërgesa jo e rregullt si theksua si një nga faktorët prijës për zgjatjen e procedurës para gjykatës<sup>145</sup>.

Sipas analizave të Koalicionit, vetëm në 7,5 % të numrit të përgjithshëm të rasteve (të gjithë personat e akuzuar të thirrur, dëshmitarë, mbrojtësit dhe prokurorët) bëhet fjalë për dërgesë jo të rregullt. Nga kjo në më shumë se gjysmën e situatave është fjala për dërgesën e thirjes të dëshmitari në procedurë.



## Konkluzioni:

Në 1/3 e numrit të përgjithshëm të shqyrtimeve të vëzhguara për shkak të mos sigurimit të kushteve për mbajtjen e shqyrtimit kryesor, i njëjti menjëherë është shtyrë. Si shkak më i shpeshtë për shtyrje paraqitet mungesa e të dëmtuarës/dëshmitarë/ të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.

Masa paraburgim më së shpeshti (50% të rasteve) kumtohet në lëndët lidhur me veprën Kontra-bandë me mërgimtarë. Edhe përpos gjerësisë së opsioneve që i ka në dispozicion gjykatësi për sigurinë e pranisë së të akuzuarit në procedurë, është e qartë tendenca që në praktikë shpeshherë të përdoret masa paraburgim dhe arrestim. Përndryshe masat tjera preventive për sigurimin e pranisë së të akuzuarit zbatohen tashmë më se një vjet, duket se të njëjtat me të vërtetë nuk janë sendërtuar në gjykatat tona themelore.

Prania e viktimave dëshmitarë në procedurë para gjykatave themelore është siguruar në 31% të rasteve. Me këtë rast në më shumë se gjysmën e situatave marrja në pyetje e viktimës është kryer jashtë shqyrtimit kryesor.

Supozimi se shqyrtimi do të shtyhet për shkak të mungesës së palëve në procedurë është shkak më i shpeshtë që gjykimi të mbahet në zyrën e gjykatësit.

Përbërja jo përkatëse gjyqësore paraqet cenim të së drejtës së çdo personi në seancë para gjykatës kompetente të themeluar me ligj.


<sup>145</sup> Vangel Gagaçev, Dërgesa e shkresave gjyqësore, Biljana Çakmakova, Shikim krahasues i dërgimit të shkresave në botë Stojançe Ribarev, Probleme dhe mangësi gjatë dërgesës në gjykatat e R të Maqedonisë, Mirjana Veliçkovska, Dispozitat e postës dhe zbatimi i tyre, Materijale nga këshillimi i shërbimit dërgues të gjyqësisë së Republikës së Maqedonisë, Revia Gjyqësore, 1999, nr. 3, fq.129-177.

Edhe përpos ndikimit të pakontestueshëm të dërgesës së kohëzgjatjes së procedurës, megjithatë mund të konkludohet se e njëjta nuk është faktor vendimtar<sup>146</sup>


## 15. Afatet

Me qëllim të caktohet koha e procesit në të cilën shtyhen seancat e lëndëve në lidhje me tregtinë me njerëz, është bërë një analizë për kohëzgjatjen<sup>147</sup> mes seancave të të gjitha lëndëve të vëzhguara nga Koalicioni.


Periudha e kaluar kohore mes dy seancave, gj.th.Gostivar



gj.th. Tetovë



gj.th. Ohër, Manastir dhe Strugë




<sup>146</sup> Ngjashëm edhe rezultatet e fituara nga lëndët civile në suaza të projektit të Koalicionit "Të gjithë për gjyqime të drejta": "Vëzhgimi i implementimit të standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë në gjykatat e vendit dhe vlerësimi i funksionimit të gjyqësisë në RM"-Raporti përfundimtar, Shkup shtator 2004

<sup>147</sup> të shprehura në ditë.

Të dhënat nga të tre tabelat japin një shikim ndaj kohës mes dy seancave të vëzhguara<sup>148</sup> sipas gjykatave themelore ku janë vëzhguar gjykime nga temat e interesit

Analiza tregon se më së shpeshti seancat shtyhen në interval kohor prej 31 deri 40 ditë

#### Kohë për të cilën shtyhet seanca



Me ndryshimin e nenit 297 (p 5) nga LPP, me të cilin caktohet që, nëse shtyrja ka zgjatur më tepër se 60 ditë (për dallim nga e më parshme prej 30 ditësh), shqyrtimi kryesor medoemos të rifillojë, duhet të anashkalohet shtyrja e panevojshme e gjykimit e shkaktuar nga rifillimi i përsëritur i shqyrtimit.<sup>149</sup>

Edhe pse në shikim të parë duket se vendimi nuk synon shkurtimin e zgjatjes së procedurës, prapsepap sipas përvojës në praksën e gjykatave të vendit për shkak të pamundësisë së shpeshtë të caktohet seancë e ardhshme në "kohë të arsyeshme" (mes tjerash për shkak të ngarkesës së madhe së disa gjykatave me lëndë), lëndët "kanë fatin" e rifillimit të përsëritur.

Nga ana tjetër, fakti se 60% e lëndëve shtyhen në interval kohor më të gjatë se 30 ditë, sjell një përfundim se ndoshta vetë ndryshimi i dispozitës së nenit 297 p.5 (nga 30 deri 60 ditë) u mundëson gjykatësve një relacion më të relaksuar në pikëpamje të ri-caktimit të shqyrtimit kryesor.

Në 20% të rasteve, shtyrja e shqyrtimit ka qenë për periudhë më të gjatë se 60 ditë.

#### Konkluzion:

Më tepër se gjysma e lëndëve në suaza të sferës së tregtisë me njerëz shtyhen në interval kohor më të gjatë se 40 ditë (më së shpeshti 31 deri 40 ditë). Andaj 20% të rasteve janë shtyrje që kthehen në periudhë më të gjatë se 60 ditë. Me këtë, lëndët "kanë fatin" të rifillimit, sipas dispozitës së nenit 297 (p.5) nga LPP që sjell deri në zgjatjen e panevojshme të procedurës.

#### Kohëzgjatja e tërësishme e procedurës

Ndikim i përbashkët i një numri të madh faktorësh në lëndët e sferës së tregtisë me njerëz, përcaktojnë kohëzgjatjen e procedurës. Vlerësimi, vallë janë marrë të gjitha masat për zgjatje kohore të procesit të zvogëlohet në nivelin më të shkurtë që mundet, respektivisht vallë gjykata është kujdesur që të gjithë

<sup>148</sup> "Mes të parës dhe të dytës, të dytës dhe të tretës", ka të bëjë me seancën e vëzhguar, e jo me numrin rendor të seancës në suaza të lëndës.

<sup>149</sup> Sipas rezultateve nga Raporti Përfundimtar i Koalicionit, 12% të seancave ka qenë të shtyra për më tepër se 30 ditë, që ka shkaktuar rifillimin e shqyrtimit.

pjesëmarrësit në procedurë të bëjnë përpjekje të largohen nga shtyrjet, është tepër vështirë të caktohet.<sup>150</sup> Nëse këtu shtihet edhe mungesa e të dhënave empirike, qoftë në nivel nacional, qoftë në nivel ndërkombëtar në bazë të të cilave mund të caktohet ndonjë kohëzgjatje mesatare të lëndëve nga sfera në fjalë, duket se është ende më e vështirë arritja tek të dhënat për atë se vallë në Republikën e Maqedonisë procedura kundër kryerësve të veprave penale nga sfera e tregtisë me njerëz, zhvillohet në afat të arsyeshëm apo jo<sup>151</sup>

Analiza e të gjitha lëndëve të gjykuara në periudhën prej Janarit deri në fund të Korrikut të vitit 2005, tregon se koha mesatare e parashtrimit të aktakuzës prej gjykatës themelore deri në sjelljen e aktit të gjykimit (ose në situata të caktuara deri në seancës e fundit të lëndës),<sup>152</sup> është 305 ditë.

Për fat të keq, edhe pse fakti paraqet madhësi mesatare të gjatësisë të të gjitha – lëndëve të gjykuara, prapsepër kjo nuk tregon pamjen e vërtetë të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor në lëndët e sferës së tregtisë me njerëz. Respektivisht, nëse hipotetifikisht përfundojnë të gjitha lëndët e vëzhguara në datën e caktuar në fund dhe merret një madhësi e mesme për zgjatjen e tyre (shuma e përbashkët e lëndëve të përfunduara dhe të pa përfunduara), vlera që do të fitohet është 373 ditë<sup>153</sup> (68 ditë më tepër).<sup>154</sup>

Nëse njehsohet zgjatja mesatare e lëndëve të gjykuara të cilat kanë filluar në pjesën e dytë të vitit 2004 dhe në vitin 2005, do të kemi rezultatin 145 ditë. Ky shpjegohet me konkluzionin se lëndët e reja që paraqiten në gjykatat themelore përfundojnë shumë më shpejt në krahasim me ato që "enden" disa vite më radhë.

## Konkluzion:

**Shpejtësia me të cilën lëndët më të fundit në lidhje me tregtinë me njerëz marrin epilogun e tyre është shumë më e madhe në krahasim me lëndët e parashtruara para mesit të vitit 2004. Kjo çon drejt përfundimit se efikasiteti i gjykatave në sanksionimin e kryerësve të veprave penale "Tregti me njerëz", "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit" dhe "Kontrabandim i migruesve" është ritur në vitin 2005.<sup>155</sup>**

## Rekomandim:

**Duke pasur parasysh shkallën e lartë të shtyrjes së shqyrtimit për shkak të mungesës së të akuzuarit, njëherit edhe numri i madh i masave të cilat i ka në dispozicion gjykata për sigurimin e pranisë së tij dhe mbajtje të suksesshme të procedurës penale, është e dëshirueshme që në praksën e gjykatave**

<sup>150</sup> Gjykata Supreme e SHBA-së gjatë nxjerrjes së konkluzës në lidhje me atë se vallë në një situatë konkrete të gjykimit të shpejtë sipas dispozitave për procedurë të përshpejtuar (The Speedy Trial Act), është respektuar apo jo, orientohet në pajtim me katër kriteret: gjatësia e kohëzgjatjes, arsyeja për kohëzgjatjen, mbështetja në të drejtën për gjykim të shpejtë nga ana e të akuzuarit si dhe dëmin që ka pësuar i akuzuari. Gordana Lazhetiq Buzharovska, Domethënia e të drejtës për gjykim të shpejtë në SHBA, Vjetor i Fakultetit Juridik në Shkup, 1996/98, vëllimi 38, faqja 397.

<sup>151</sup> G Lazhetik-Buzharovska, Mënyrat e përshpejtimit të procedurës penale në legjislativat evropiane, Revia Maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji, nr1 faqe 86

<sup>152</sup> Për shkak të praktikës që akt gjykimit të dërgohen në mënyrë të shkruar deri tek pjesëmarrësit në procedurë pa u shpallë paraprakisht, në më tepër se gjysma e lëndëve Koalicioni nuk ka të dhënë për datën e saktë të sjelljes së gjykimit.

<sup>153</sup> Rezultati është tërësisht jo real, mirëpo duhet të na paralajmëron të paktën për kohëzgjatjen e gjykimit në rastet më të mira të lëndëve nga sfera e tregtisë me njerëz

<sup>154</sup> Sipas disa autorëve si kohë optimale për përfundimin e një lënde në gjykatën e shkallës së parë (nga parashtrimi i aktakuza deri në sjelljen e gjykimit) në procedurën penale, merret periudha prej 9 deri 12 muaj, Zeqir Selimi, kohëzgjatja e procedurës penale për lëndë standarde penale, Revia Gjyqësore, 1998, nr. 4 faqja 139

<sup>155</sup> Ndoshta përgjigja për arsyet për të njëjtën, mund të kërkohen në drejtim të zmadhimit të suksesit për të siguruar viktimat e tregtisë me njerëz përmes funksionimit të qendrës SEKI.

tona të bëhen përpjekje për përdorimin më të shpeshtë të tyre. Në situata kur nuk është i domosdoshëm caktimi i masës paraburgim, përdorimi më i shpeshtë i "masave tjera preventive" të parapara me ndryshimet e LPP, ndoshta do të sjellin deri në zvogëlimin e kohëzgjatjes së procedurës.

Gjykatat medoemos ti ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për zvogëlimin e periudhës kohore për të cilën ri-caktohen seancat e lëndëve në lidhje me tregtinë me njerëz. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet mos lejimit të tejkalimit të afatit prej 60 ditësh, me çka vjen deri në rifillimin e procedurës në gjykatë.

Duke marrë parasysh njomësinë e natyrës së veprës penale të tregtisë me njerëz, medoemos të bëhet përpjekje që gjykimet të mbahen në gjykatore, e jo në zyrat e gjykatësve, ku mungojnë kushte për rrjedhë normale të shqyrtimit kryesor.

Përdorimi i dispozitës nga neni 322 i LPP, sipas të cilit këshilli mundet të jep urdhër që dëshmitari, ardhja e të cilit në shqyrtimin kryesor është dukshëm e vështirësuar, dëshmia e të cilit është e rëndësishme për procedurën, të dëgjohet jashtë shqyrtimit kryesor në situatat kur sjellje e viktimave/dëshmitarë përcjellët me shpenzime të larta financiare, maltretim plotësues i viktimës, aktivizim i sistemit për bashkëpunim ndërkombëtar, të paktën deri në sjelljen e bazës ligjore për sigurimin e qëndrimit të viktimës gjatë kohës së procedurës, paraqet solucion logjik dhe të nevojshëm.

# 8

## *Politika ndëshkuese në Maqedoni më lidhje me veprat penale tregti me njerëz, ndërmjetësim në prostitucion dhe kontrabandim të migruesve*

Gjendja dhe lëvizja e krimit në çdo vend e determinon politikën kriminale, respektivisht i determinon mjetet dhe metodat që përdoren për mbrojtje efikase të lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe vlerat dhe të mirat tjera shoqërore.

Në pajtim me KP, qëllimi i përgjithshëm i sanksioneve juridike penale (neni 2) është mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe vlerave tjera themelore<sup>156</sup>, përveç arritjes së drejtësisë, marrin pjesë (neni 32) pengimi i kryerësit të bëjë vepra penale dhe re-edukimi i tij, si dhe ndikim edukues mbi tjerët që të mos bëjnë vepra penale.

Legjislatura e RM-së, si dhe numri më i madh i legjislativave në botë e pranojnë sistemit e dënimeve relativisht të caktuara, respektivisht, përveç caktimit të llojit të dënimit, caktohet edhe masa më e vogël dhe më e madhe (maksimumi dhe minimumi i përgjithshëm ligjor). Njëherit për çdo vepër konkrete penale, ligji cakton kornizat në të cilat lëviz dënimi (maksimumi dhe minimumi i posaçëm ligjor).

Me këtë, legjislatura i cakton gjykatës një orientim vlerësor, respektivisht kornizë në të cilën duhet të lëvizë gjatë përcaktimit të dënimit konkret, për kryerës saktësisht të caktuar të ndonjë vepre penale.

Duke ndjekur politikën ndëshkuese të shumicës së vendeve evropiane, njëherit duke respektuar nenin 2 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, në pajtim me të cilin, masa më e vogël e paraparë për dënimin heqje nga liria për vepra penale "serioze" do të duhej të jetë minimum katër vjet, andaj duke u nisur nga lëvizja dhe zhvillimi i tregtisë me njerëz në RM, legjislatura ynë ka caktuar dënim me burg prej së paku katër vjet për formën elementare të veprës penale tregti me njerëz (neni 418 a paragrafi 1). Kurse, në raste kur viktimat është foshnjë ose person i mitur, dënimi me burg është së paku tetë vjet.

Ai që shfrytëzon ose mundëson tjetrit shfrytëzimin e shërbimeve seksuale nga persona për të cilët dihet se janë viktimat të tregtisë me njerëz, do të dënohet me burg prej gjashtë muajsh deri pesë vite.

Minimumi i posaçëm ligjor i veprës penale Kontrabandim i migruesve (neni 418-b paragrafi 2) është një vjet, kurse maksimumi i posaçëm ligjor është pesë vjet. Dënimi është më i rreptë nëse viktimat është foshnjë

<sup>156</sup> Qëllimi i masave alternative, masat e sigurisë dhe masat edukuese caktohet me nenin 48, nenin 60 dhe nenin 73 nga KP.



ose person i mitur ose migruesit i është keqësuar jeta ose shëndeti ose mbi të ushtrohet sjellje arrogante dhe nënçmuese.

Në lidhje me veprën ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit (neni 191) në formën elementare (paragrafi 2) minimumi i posaçëm ligjor është gjashtë muaj, kurse maksimumi i posaçëm ligjor është pesë vjet. Dënimi i njëjtë i caktohet edhe atij që me qëllim të leverdisë me forcë ose kërcënim serioz për përdorimin e forcës, do të detyrojë ose me mashtrim do të shtyjë ndonjë person tjetër të jep shërbime seksuale.

Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimeve caktohen me nenin 39 i KP. Respektivisht, gjykata do të caktojë kryerësit peshën e veprës dhe qëllimit e dënimit, në kufijtë e paraparë me ligj, duke pasur parasysh përgjegjësinë e tij penale.

Sa u përket rrethanave të rëndësishme për matjen e dënimit<sup>157</sup>, para së gjithash rrethanave për veprën e bërë, gjykata duhet ti merr parasysh: mënyrën e kryerjes së veprës (në veprat e tregtisë me njerëz më së shpeshti bëhet fjalë për sjellje nënçmuese<sup>158</sup> ndaj viktimave, maltretim të pa ndalë, respektivisht lëndime fizike<sup>159</sup> në raste të pa dëgjueshmërisë, përdhunim nga ana e kryerësit), personi i viktimës (bëhet fjalë për gra të reja që janë rritur në kushte të rënda materiale, me shollë të ulët; mos njohje të gjuhës së vendit ku janë sjellë, si dhe mungesa e dokumenteve, si dhe frika nga intimidimi për shkak të prezencës ilegale, kontribuon për rritjen e lëndueshmërisë së tyre), pasoja e shkaktuar (fizike<sup>160</sup>, psikike), intensiteti dhe kohëzgjatja e veprës (më së shpeshti paraqiten si vepra të përhershme penale, viktimat janë nën vëzhgim të pa ndalë brenda 24 orësh, pa leje të lëshojë vendin ku jep shërbime, ose të lëshojë por nën kontrollë).

Sa u përket rrethanave lidhur me personalitetit të kryerësit, këto janë ose mund të kenë lidhje me profesionin e tij (numri më i madh i personave të akuzuar janë pronarë të bareve të natës ose lokaleve, dhe kanë arsim fillor ose të mesëm), finesat personale (ndaj dhunës, alkoolit), ndëshkime të më hershme (33% janë recidivistë), shkalla e njehsimit ose shkalla e fajit (të gjithë personat<sup>161</sup> janë të njehsueshme kurse vepra është e menduar prej më parë), sjellja pas kryerjes së veprës dhe në procedurën në gjykatë (kryerësit më së shpeshti e mohojnë veprën, bazohen në mosnjohien e viktimës ose e deklarojnë viktimën si të dashur)<sup>162</sup>.

## ***16. Matje gjyqësore e dënimeve***

Sa e madhe është reptësia e gjykatave tona gjatë matjes së dënimeve mund të shikjmë nga të dhënat për lartësinë dhe llojin e dënimeve të caktuara në periudhën prej vitit 2000 deri në vitin 2004 për veprën "Tregti me njerëz" (neni 418-a)<sup>163</sup>.

<sup>157</sup> Gj. Maranoviç, Matja e dënimit, E drejta penale e Maqedonisë, Pjesa e përgjithshme, Shkup 1998, faqe 294

<sup>158</sup> ..lënia e viktimës vetë në pyll disa orë..

<sup>159</sup> ..rrahje me karriqe, thyerje e shisheve të birës nga koka e viktimës, thyerje e dhëmbëve..


<sup>160</sup> Në lëndën e vëzhguar në Gjykatën Themelore në Ohër, viktimia dëshmitar në procedurë ka qenë e detyruar për katër operacione të vezoreve të cilat kanë rezultuar me nxjerrjen e njërës. Viktima në lëndën gjyqësore së vëzhguar në gjykatën themelore të Tetovës, gjatë tentimit për të ikur, ka pësuar rrahje nga i akuzuari. Në tentimin e pasuksesshëm për vetëvrasje i ka prerë venat, por me intervenim mjekësor nga ndonjë ordinancë private mjekësore të fshatrave të rrethit, ka shpëtuar.

<sup>161</sup> Shiko Kreu IV, profili i të akuzuarit

<sup>162</sup> Ligji ynë e detyron gjykatën gjatë matjes së dënimit ti merr parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë që ajo të jetë më e lartë ose më e ulët: Shkalla e përgjegjësisë ndëshkuese, shkaqet pse është ka ndodhur kjo, fuqia e lëndimit ose keqësimit, rrethanat nën të cilat është bërë vepra, kontributi i viktimës, jeta e mëparshme e kryerësit, sjellja e tij pas veprës së kryer si dhe rrethana tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e kryerësit (neni 39 p 2).


<sup>163</sup> Është caktuar vetëm një dënim efektiv me burg për vepër të krijimi të raportit robërues dhe transport të personave nën raport robërues (p 1) në gjatësi prej 3-6 muajsh 9 (vepra ndëshkohet me 1-10 vjet).

191 paragrafi 1,3,4, dënim me burg prej 5 muajsh deri 6 vjet.




Respektivisht, në 54% nga numri i përgjithshëm i rasteve të gjykuara në lidhje me ndërmjetësimin gjatë jryerjes së prostitucionit, neni 1,3 dhe 4, dënim me burg<sup>164</sup> lëviz nën minimumin e posaçëm ligjor (nën 6 muaj)

191 paragrafi 2



Në lidhje me nenin 191 paragrafi 2, në pajtim me të cilin kryerësi i veprës dënohet me dënim në të holla ose me dënim me burgim deri një vjet, të dhënat tregojnë se në vetëm nja nga katër lëndë, dënimi i caktuar ka qenë maksimum një vjet.


191 paragrafi 5



Për veprën e nenit 191 paragrafi 5 është paraparë dënim me burg prej një deri pesë vjet. Që të dyja dënimet e caktuara janë me kohëzgjatje prej 6 muajsh.


<sup>164</sup> Dënim efektiv me burgim.

### 191 paragrafi 6



Më tepër se gjysma e dënimeve burg që janë caktuar për veprën penale sipas nenit 191 paragrafi 6 nën minimumin e posaçëm ligjor (dënimi lëviz prej 1 deri 10 vjet)

### 418 a paragrafi 1



Në lidhje me dënimin burg për veprën "tregti me njerëz" (sipas paragrafit 1)<sup>165</sup> mund të vërehet rëptësim në vitin 2004. Edhapse, përsëri në 29 % nga situatat bëhet fjalë për dënime të cilat lëvizin nën minimumin e posaçëm ligjor. Analizat tregojnë në gjysëm nga të gjitha dënimet me burg të caktuara efektive për veprën tregti me njerëz dhe ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit, bëhet fjalë për gjatësi të dënimit e cila lëviz nën minimumin e paraparë ligjor.

Autorizimi i gjykatës ta zbusë dënimin paraqet instrument me të cilin gjykata mund vendosë pa përjashtime. Në të kundërtën, do të bëhej fjalë për largimin e modelit të matjes ligjore të dënimit.

Edhapse ligji, në mënyrë të përpiktë nuk i cakton rrethanat nën të cilat mund të vjen deri në zbutjen dënimit, respektivisht nuk cakton cilat janë atë rrethana veçanërisht lehtësuese të cilat mund të sjellin deri në caktimin e dënimit nën minimumin e posaçëm ligjor, prapëseprap gjykata gjatë matjes së dënimit medoemos të niset nga mendimi se këto rrethana kanë karakter përjashtues. Caktimi i dallimit mes "rrethanave posaçërisht lehtësuese"<sup>166</sup> dhe rrethanat lehtësuese të "rëndomta" është e domosdoshme për shkak të caktimit të dallimit mes dënimit më të butë në suaza të ligjit për çdo veprë penale dhe ndëshkim nën minimumin e caktuar ligjor për atë veprë.

Fakti se në gjysmën e rasteve, praktika gjyqësore në veprat e sferës së tregtisë me njerëz ka caktuar se bëhet fjalë për rrethana veçanërisht lehtësuese (logjikisht rrjedh nga lartësia e dënimit me burg), e ngushton domethënien e fjalën "posaçërisht".

Nga e gjitha që u tha më parë mund të përfundohet se praktika gjyqësore bën përjashtime nga politika juridiko ndëshkuese nëpërmjet dispozitave të KP për lartësinë e sanksioneve për vepra penale nga sfera e


<sup>165</sup> Nga viti 2002 deri 2004, të gjitha aktgjykimet kanë të bëjnë me nenin 418-a paragrafi 1. Vetëm në një situatë bëhet fjalë për paragrafin 5 nga i njëjti nen. Lënda është gjykuar në vitin 2004.

<sup>166</sup> neni 40 p 2 nga LPP.

tregtisë me njerëz, respektivisht gjykatat janë posaçërisht tolerant gjatë matjes së dënimeve në fushën e tregtisë me njerëz


Nga janari i viti 2005 të regjistruara janë lartësitë e dënimeve me burg në të gjitha lëndët e gjykuara që janë vëzhguar nga Koalicioni

### Kontrabandim i migruesve neni. 418-b paragrafi 2




Andaj, në lidhje me vepër kontrabandim i migruesve (paragrafi 2), është caktuar dënim efektiv me burg për 4 persona (një me kusht), në kohëzgjatje ose nën një vjet (dënim i zbutur) ose në kufi të minimumit të posaçëm ligjor. Tre persona janë liruar nga akuzat.

### Tregti me njerëz neni 418-a paragrafi 1



Lartësia e dënimeve të caktuara në lëndët në lidhje me tregtinë me njerëz, lëviz ose në vijën e minimumit të posaçëm ligjor ose pak mbi këtë kufi.<sup>167</sup>

### Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit neni 191 p 1, p 4



Ngjashëm ndodh edhe në vepërën ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit.<sup>168</sup>


Tendenca për politikë shumë të butë gjatë matjes gjyqësore të dënimeve vazhdon edhe në vitin 2005. Gjegjësisht, dënimt kryesisht lëvizin rreth ose nën minimumin e posaçëm ligjor. Nëse të gjitha këtyre i shtohet fakti se në diçka më tepër se 30% të rasteve bëhet fjalë për persona të akuzuar recedivistë, që sipas ndonjë logjike të gjërave do të duhej të jepte peshë plotësuese gjatë matjes së dënimit, befason

<sup>167</sup> Pesë persona janë liruar nga akuzat.

<sup>168</sup> Për këtë vepër, një person është liruar nga akuzat.

vazhdueshmëria e sanksionimit të butë të kryerësve të veprave penale që mbulohen me këtë projekt. Aq më tepër që me ndryshimet e KP nga viti 2004, legjislatura jonë, përmes ashpërsimit të dënimit në nenin 418-a qartë tregoi qëndrimin e vet për nevojën e ndëshkimit më të ashpër për tregtarët me njerëz.

Në suaza të të gjitha lëndëve të gjykuara deri në fund të muajit korrik 2005, në 65% të rasteve bëhet fjalë për aktgjykim ndëshkues.



Edhe krahas obligimit të gjykatës të shpall menjëherë aktgjykimin (ose, nëse nuk ka mundësi po atë ditë, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të bëjë këtë, do ta shtyejë shpalljen e aktgjykimit më së shumti për tre ditë dhe do ta cakton kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit), në 60%<sup>169</sup> të rasteve në lëndët në lidhje me "Tregtinë me njerëz" dhe "Ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit", palët pas përfundimit të shqyrtimit kryesor vetëm kanë qenë të infomuar se aktgjykimi në mënyrë të shkruar do t'u dërgohet, pa shpallur të njëjtën sipas dispozitave të nenit 344<sup>170</sup> nga LNP të LPP

## Konkluzione:

Në gjysmën e të gjithë dënimeve të caktuara efektive në Republikën e Maqedonisë për veprat "Tregti me njerëz" nga viti 2002 deri viti 2004 dhe ndërmjetësim gjatë kryerjes së prostitucionit nga viti 2000 deri 2004, bëhet fjalë për gjatësi të dënimit e cila lëviz nën minimumin e posaçëm ligjor.

Butësia tejet e madhe e gjykatave gjatë matjes së dënimeve në fushën e tregtisë me njerëz tregon se praktika gjyqësore nuk është në pajtim me konceptin e politikën juridiko ndëshkuese të R së Maqedonisë, e shprehur përmes dispozitave të KP për lartësinë e sanksioneve për vepra penale nga sfera e tregtisë me njerëz. Ka mos pajtim mes peshës së veprës dhe lartësisë të sanksioneve të caktuara.

Në më tepër se gjysma e lëndëve të gjykara, gjykata nuk e ka shpallur aktgjykimin sipas dispozitave të nenit 344 nga LPP

## Rekomandime:

Autorizimet e gjëra që gjykatat i kanë gjatë matjes së dënimit, veçanërisht ato që hyjnë në fushën e përdirimit të institutit "zbutje e dënimit" nuk guxojnë të paraqesin sulm mbi modelin themelor të matjes së dënimit, as guxojnë të jenë në kundërshtim me politikën juridike të Maqedonisë, shprehur përmes dispozitave për lartësinë e dënimit, konkretisht për veprat në lidhje me tregtinë me njerëz.

<sup>169</sup> Në 78% të rasteve bëhet fjalë për lëndët në gjykatën themelore në Gostivar.

<sup>170</sup> ...Pasi që gjykata ka caktuar aktgjykimin, kryetari i këshillit menjëherë do ta shpallë. Nëse gjykata nuk ka mundësi të caktojë aktgjykimin po atë ditë pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, do ta shtyejë shpalljen për maksimum tre ditë i do ta caktojë kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit.

E drejta diskrecionale e gjykatësve gjatë matjes së lartësisë së dënimit duhet të lëviz në suaza të minimumit dhe maksimumit të posaçëm ligjor.

Instituti zbutje e dënimit duhet të zbatohet në raste posaçërisht të veçanta.

Është i dëshirueshëm ndërtimi i qëndrimeve të përgjithshme ose mendime nga ana e gjykatave më të larta si kahëzues për caktimin e dënimit gjatë punës së gjykatave më të ulëta në lidhje me veprat tregti me njerëz, respektivisht për përcaktim më të saktë të dallimit mes rrethanave veçanërisht lehtësuese dhe rrethanave të rëndomta lehtësuese me pajtimin e të cilës caktohet lartësia e sanckionit për kryerësin e fajshëm.



## 9

*Rekomandime*

1. Është i domosdoshëm respektimi konsekuent i dispozitës së nenit 223 të LPP në pajtim me të cilën dëshmitari do të paralajmërohet se nuk është i detyruar tu përgjigjet pyetjeve të veçanta nëse ekzistojnë gjasa se me këtë do të ekspozonte veten ose ndonjë farefis të vetin në turp të rëndë, dëm material ose ndjekje penale.
2. Dëshmitari do të duhej të informohej për të drejtën që të shkurtojë paraqitjen e të dhënave personale (emrin dhe mbiemrin, emrin e babait, profesionin, vendqëndrimin, moshën dhe raportin me të akuzuarin) nëse me këtë do të ekspozonte veten ose ndonjë person të afërt me të në rrezik serioz për jetën, shëndetin ose integritetin fizik.
3. Nëse dëshmitari shkurton paraqitjen e të dhënave në fjalë kurse vlerësohet se rreziku ekziston, do të duhej të ekzistonte mundësi për zbatimin e dispozitave për mënyrën e veçantë të marrjes në pyetje të dëshmitarit në procedurë, e jo vetëm të dispozitave për përfshirje në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve. Vlerësimi i shkallës së rrezikimit dhe mënyrën e mbrojtjes duhet të bëhet në pajtim me situatën konkrete.
4. Është i domosdoshëm përpunimi më konkret ligjor i mënyrës së veçantë të marrjes në pyetje dhe pjesëmarrjes së dëshmitarëve në procedurë kur ekzistojnë rrethanat e nenit 270-a. Me këtë do të mundësohej mbrojtja më e shpejtë dhe më ekonomike e viktimës së tregtisë me njerëz/dëshmitarë në procedurë, posaçërisht në periudhën deri në hyrjen në fuqi edhe përpunimit të Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve.
5. Sigurimi i hapësirës adekuate për gjykim posaçërisht për lëndë me shkallë të ndjeshmërisë, siç janë ato në kudër të tregtisë me njerëz, paraqet domosdoshmëri për shmangien e viktimizimit sekondar të viktimave, si dhe sigurimin e marrjes së dëshmisë cilësore në procedurën kundër kryerësve të këtij lloji të veprave penale.
6. Përgatitja e një doracaku për të drejtat e dëshmitarëve në procedurë<sup>171</sup> mund të kontribuojë drejt afirmimit të të drejtave të të gjithë personave të cilët thirren si dëshmitarë në lëndët në gjykatat themelore. Afirmimi çon drejt njohjes së të drejtave, kurse e njëjta drejt përgatitjes më të madhe të qytetarëve ( gjithsesi edhe të viktimave të tregtisë me njerëz) për paraqitje dhe participim në procedurën në gjykatë.

<sup>171</sup> <http://www.usdoj.gov/usao/tnw/brochures/vwhandbook/vwhandbook.html>) Victim and Witness handbook



7. Ekziston nevojë për ndërtimin e një mekanizmi të bazuar mbi ligj ose akt nënligjor i cili do të mundësojë qasje të shpejtë të të gjitha viktimave (jo vetëm të viktimave shtetase të huaja) deri te ndihma adekuate juridike në procedurën kundër kryerësve të veprave penale.
8. Meqë viktima e tregtisë me njerëz për shkak të mosekzistimit të fondeve shtetërore për zhdëmtim nuk mund të kompensohet në mënyrë tjetër përveç se nga prona e kryerësit, është më se e qartë nevoja shfrytëzimit më të shpeshtë të dispozitave të KP për konfiskimin e pronës dhe të dobisë pronësore të fituar me veprën penale si dhe dispozitave për sigurimin e përkohshëm të pronës ose të mjeteve që janë në lidhje me atë veprën. Konfiskimi i fitimeve kriminale njëherësh mund të ketë edhe veprim më të fuqishëm frikësues se sa dënimi me burg i cili në Maqedoni për shkak të politikës së butë të gjykatave me rastin e matjes së dënimit, më së shpeshti lëviz nën minimumin e veçantë ligjor.
9. Respektimi i dispozitave nga Ligji për procedurë penale që i dedikohen kërkesës pronësore juridike, paraqet imperativ të domosdoshëm për sigurimin e mbrojtjes së interesit të viktimës përkatësisht të forcimit të pozitës së saj në procedurën para gjykatës.
10. Shfrytëzimi i mendimit (ekspertizës) të personave profesionistë që janë të obliguar për dhënien e përkrahjes psikologjike viktimave, menjëherë pas pranimit të tyre në Qendrën transitorë, si mjet dëshmuar në procedurë, veçanërisht në kushtet kur nuk është kryer ekspertizë tjetër e gjendjes psikologjike të viktimës para se e njëjta të kthehet në vendin amë, paraqet një zgjidhje të dëshiruar për shkak të caktimit të bazës dhe shumës së kompensimit të drejtë viktimave në tregtinë me njerëz.
11. Duke pasur parasysh shkallën e lartë të shtyrjes së shqyrtimit për shkak të mungesës së të akuzuarit, njëherit edhe numri i madh i masave të cilat i ka në dispozicion gjykata për sigurimin e pranisë së tij dhe mbajtje të suksesshme të procedurës penale, është e dëshirueshme që në praksën e gjykatave tona të bëhen përpjekje për përdorimin më të shpeshtë të tyre. Në situata kur nuk është i domosdoshëm caktimi i masës paraburgim, përdorimi më i shpeshtë i "masave tjera preventive" të parapara me ndryshimet e LPP, ndoshta do të sjellin deri në zvogëlimin e kohëzgjatjes së procedurës.
12. Gjykatat medoemos ti ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për zvogëlimin e periudhës kohore për të cilën ri-caktohen seancat e lëndëve në lidhje me tregtinë me njerëz. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet mos lejimit të tejkalimit të afatit prej 60 ditësh, me çka vjen deri në rifillimin e procedurës në gjykatë.
13. Duke marrë parasysh njomësinë e natyrës së veprës penale të tregtisë me njerëz, medoemos të bëhet përpjekje që gjykimet të mbahen në gjykatore, e jo në zyrat e gjykatësve, ku mungojnë kushte për rrjedhë normale të shqyrtimit kryesor.
14. Përdorimi i dispozitës nga neni 322 i LPP, sipas të cilit këshilli mundet të jep urdhër që dëshmitari, ardhja e të cilit në shqyrtimin kryesor është dukshëm e vështirësuar, dëshmia e të cilit është e rëndësishme për procedurën, të dëgjohet jashtë shqyrtimit kryesor në situatat kur sjellje e viktimave/dëshmitarë përcjelllet me shpenzime të larta financiare, malltretim plotësues i viktimës, aktiizim i sistemit për bashkëpunim ndërkombëtar, të paktën deri në

sjelljen e bazës ligjore për sigurimin e qëndrimit të viktimës gjatë kohës së procedurës, paraqet solucion logjik dhe të nevojshëm

15. Autorizimet e gjëra që gjykatat i kanë gjatë matjes së dënimit, veçanërisht ato që hyjnë në fushën e përdirimit të institutit "zbutje e dënimit" nuk guxojnë të paraqesin sulm mbi modelin themelor të matjes së dënimit, as guxojnë të jenë në kundërshtim me politikën juridike të Maqedonisë, shprehur përmes dispozitave për lartësinë e dënimit, konkretisht për veprat në lidhje me tregtinë me njerëz.
16. E drejta diskrecionale e gjykatësve gjatë matjes së lartësisë së dënimit duhet të lëviz në suaza të minimumit dhe maksimumit të posaçëm ligjor. Instituti zbutje e dënimit duhet të zbatohet në raste posaçërisht të veçanta.
17. Është i dëshirueshëm ndërtimi i qëndrimeve të përgjithshme ose mendime nga ana e gjykatave më të larta si kahëzues për caktimin e dënimit gjatë punës së gjykatave më të ulëta në lidhje me veprat tregti me njerëz, respektivisht për përcaktim më të saktë të dallimit mes rrethanave veçanërisht lehtësuese dhe rrethanave të rëndomta lehtësuese me pajtimin e të cilës caktohet lartësia e sanckionit për kryerësin e fajshëm.





Organization for Security and Co-operation in Europe

Spillover Monitor

Mission to Skopje

## *Konkluzione*

### **Nga tryeza e rumbullakët e mbajtur me rastin e Raportit "Pengimi i tregtisë me njerëz në praksën e gjykatave të vendit" Të Koalicionit "Të gjithë për gjykime të drejta"**

Më 11.11.2005, Në Hotelin ARKA në Shkup, në organizim të Koalicionit të 22 OJQ-ve "Të gjithë për gjykime të drejta" dhe Sektorit për sundimin e të drejtës pranë misionit të OSBE-së në Shkup, u mbajt tryeza e rumbullakët me qëllim që të prezentohen konkluzionet dhe rekomandimet nga vëzhgimi nëntë mujor i lëndëve në lidhje me tregtinë me njerëz në të gjitha gjykatat themelore të Maqedonisë në raportin "**Pengimi i tregtisë me njerëz në praktikën e gjykatave të vendit**".

Në tryezën e rumbullakët, përveç anëtarëve të Koalicionit që janë angazhuar rreth projektit "Vëzhgimi i lëndëve në lidhje me tregtinë me njerëz", përfaqësues të Misioni Vëzhgues të OSBE-së në Shkup, morrën pjesë edhe përfaqësues të gjyqësisë, Ministrisë për drejtësi dhe Ministrisë për punë të brendshme të R të Maqedonisë, Anëtarë të Komisionit Nacional të luftës kundër tregtisë me njerëz, si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të cilat veprojnë në këtë sferë. Nga diskutimi cilësor dolën këto konkluzi:

- Raporti "Pengimi i tregtisë me njerëz në praktikën e gjykatave të vendit" i Koalicionit mori notë mjaft pozitive dhe përkrahje nga pjesëmarrësit r tryezës së rumbullakët. I njëjti u cilësua si një tentim mjaft serioz që të jepet një pamje për atë se çka ndodh në praktikën gjyqësore në lidhje me tregtinë me njerëz, si dhe një bazë e vulltshme, respektivisht mjet për shkencën, legjislaturën dhe gjyqësinë, për locimin e problemeve me të cilat ballafaqohen Republika e Maqedonisë në procesin e pengimit dhe sanksionimit të tregtisë me njerëz.
- Gjykatësit medoemos ti përdorin të gjitha mundësitë e dhëna me ligj për sigurimin e kushteve për mbajtjen e shqyrtimit kryesor, para se gjithash për sigurimin e pranisë së atyre personave pa të cilët ai nuk mund të realizohet
- Pjesëmarrësit u pajtuan me qëndrimin se formimi i fondit shtetëror për kompensimin e viktimave të tregtisë me njerëz është imperativ pa të cilin nuk mund të ketë realizim të suksesshëm të mbrojtjes

së të drejtave të njeriut dhe interesave të viktimës në procedurën penale. Njëherësh u konfirmua se edhe krahas asaj se Ligji për procedurë penale para ndryshimeve të vitit 2004, mundëson sjelljen e vendimit me shkas për kërkesën juridike pronësore në procedurën penale, prapëseprap përdorimi i kësaj mundësie në praktikën e gjykatave tona është e anashkaluar. Me ndryshimin e fundit të LPP, legjislatura tenton të tejkalojë këtë praktikë, me përcaktimin e obligimit të detyruar të gjykatës të vepron sipas kërkesës pronësore juridike në suaza të procedurës penale kur sjellet aktakuza me të cilën i akuzuari shpallet i fajshëm

- Konfiskimi i pronës së kryerësit paraqet mjetin më efikas për sigurimin e dëmshpërblimit të viktimës të tregtisë me njerëz, veçanërisht në situatë të mos ekzistimit të fondit shtetëror për kompenzimin e viktimave të R të Maqedonisë
- Duhet të bëhet përputhje e praktikës gjyqësore gjatë vlerësimit të asaj se cilat rrethana merren si lehtësuese dhe cilat merren si veçanërisht lehtësuese, e gjithë kjo me qëllim të ndërtimit të qëndrimeve të qarta gjatë përdorimit të institutit "zbutje e dënimit"
- Në të ardhmen duhet t'i kushtohet vëmendje më të madhe periudhës kohore në të cilën kumtohen dhe shpallen aktgjykimet në gjykatat themelore në sferën e tregtisë me njerëz
- Si arsye për zvogëlimin e kohëzgjatjes së procedurës penale respektivisht për zmadhimin e efikasitetit në realizimin e proceseve gjyqësore në lidhje me tregtinë me njerëz, konstatuar sipas analizave të Koalicionit, pjesëmarrësit shtruan: ndryshimet e fundit ligjore në LPP, angazhimi i gjykatave më të larta në realizimin e vizitave tek gjykatat më të ulta si model efikas për përshpejtimin e punës, sjelljen më serioze të gjykatësve, ndihmën nga organizatat joqeveritare të llojit të Koalicionit, qendrës SEKI si dhe qendrës së Transisit.
- Duke nisur nga ndjeshmëria e veprave penale të vëzhguara nga Koalicioni, domemos të insistohet që të mundësohen kushte që gjykimet të zhvillohen në gjykatore dhe jo në zyrat e gjykatës, me çka zvogëlohen mundësitë për viktimizim plotësues të viktimës dhe do të zmadhohen mundësitë për sigurimin e shprehjes më cilësore të saj gjatë procedurës penale.
- Pjesëmarrësit u pajtun se ka nevojë për organizimin e takimeve plotësuese me përfaqësues të gjyqësisë me qëllim të prezentohen konkluzionet nga raporti i diskutimit rreth problemeve të konstatuara në procesin e vëzhgimit.
- Raporti me rekomandimet, pas botimi të tij, do t'u dërgohet anëtarëve të komisionit Nacional për luftë kundër tregtisë me njerëz, gjykatësve dhe të gjithë profesionistve tjerë që veprojnë në sferën në fjalë.

# *Nene nga Kodi Penal dhe Ligji për Procedurë Penale*

## **Neni 191, Ndërmjetësim në kryerjen e Prostitucionit**

- (1) Ai që inkurajon, shtyt, nxit ose mashtron persona në prostitucion ose ai që në cilën do mënyrë mer pjesë në dorëzimin e ndënjë personit tjetër për shkak të kryerjes së prostitucionit do të dënohet me burg prej 6 muaj deri në 5 vjet.
- (2) Ai që për shkak të përfitimit i mundëson ndonjërit shfrytëzimin e shërbimeve seksuale, do të dënohet me gjobë ose burg deri në një vjet.
- (3) Ai që për shkak të përfitimit me forcë ose me kanosje serioze për përdorim të forcës e detyron ose me mashtrim e shtyn ndonjërin në dhënien e shërbimeve seksuale do të dënohet me burg prej 6 muaj deri në 5 vjet.
- (4) Nëse vepra nga paragrafet 1,2 dhe 3 është kryer me person të mitur, kryerësi do të dënohet me burg prej 6 muaj deri në pesë vjet.
- (5) Nëse vepra nga paragrafet 1,2 dhe 3 është kryer me fëmi, kryerësi do të dënohet me burg prej 1 deri në 5 vjet.
- (6) Ai që organizon kryerjen e veprës nga paragrafet 1 deri në 5 ose veprat do ti bëjë gjatë kryerjes së dhunës familjare, do të dënohet me burg prej 1 deri në 10 vjet.

## **Neni 418-a, Tregtia me njerëz**

- (1) Ai që me forcë, kanosje serioze e vë në mashtrim ose me forma tjera detyrimi, grabitje, mashtrim, me shpërdorimin e pozitës së vet ose të gjendjes së shtatzënisë, pafuqisë ose paaftësisë fizike ose mentale të tjetrit, ose me dhënien apo marrjen e të hollave ose të ndonjë interesi tjetër për të arritur marrjen e pëlqimit nga personi i cili ka kontrollin mbi një person tjetër inkurajon, transporton dhe bart, blen, shet, strehon ose pranon persona për eksploatim përmes prostitucionit ose formave të tjera të eksploatimit seksual, pornografisë, punës së detyruar ose punës së shërbyesit, robërisë, martesave të detyruara, fertilizimit të detyruar, adoptimit të paligjshëm ose ndonjë marrëdhënie tjetër të ngjashme ose transplantimit të palejueshëm të pjesëve të trupit të njeriut, do të dënohet të paktën me 4 vjet vuajtje burgu.

- (2) Ai që inkurajon, transporton, bart, blen, shet, strehon ose pranon fëmijë ose të mitur për eksploatim, do të dënohet me, të paktën 8 vjet burg.
- (3) Ai që do të marrë ose shkatërrojë letërnjoftim ose pasaportë ose ndonjë dokument tjetër të huaj identifikimi për kryerje të veprës nga pika 1 dhe 2 do të dënohet me burgim prej 6 muaj deri 5 vjet.
- (4) Ai që i shfrytëzon ose i mundëson ndokujt tjetër shfrytëzimin e shërbimeve seksuale nga person për të cilin ka dijani se është viktimë e tregtisë me njerëz, do të dënohet me, të paktën 4 vjet burg.
- (5) Nëse vepra e pikës 4 kryhet me fëmijë ose të mitur kryerësi do të dënohet me të paktën 8 vjet burg.
- (6) Nëse veprën e pikës 1 e kryen person juridik, do të dënohet me të holla.
- (7) Mjetet dhe automjetet që janë përdorur për kryerjen e veprës, merren.

### **Neni 418-b, Kontrabandë migruesish**

- (1) Ai i cili me forcë ose me kanosje serioze se do të cenojë jetën ose sulmojë trupin, me grabitje, mashtrim, nga leverdia, me keqpërdorim të pozitës së vet zyrtare ose duke shfrytëzuar pafuqinë e ndokujt bart migrues jo legalisht nëpër kufirit shtetëror si dhe ai që bën, furnizon ose posedon pasaporta të rrejshme për qëllime të tilla, do të dënohet me burg prej të paktën 4 vjet.
- (2) Ai që rekruton, transporton, bart, blen, shet, strehon ose pranon migrues, do të dënohet me burg prej një deri në pesë vjet.
- (3) Ne së gjatë kryerjes së veprave nga paragrafët 1 dhe 2 rrezikohet jeta ose shëndeti i migruesit, ose me migruesin veprohet posaçërisht në mënyrë nënçmuese ose të vrazhdë, ose pengohet që ai ti shfrytëzojë të drejtat që i takojnë sipas të drejtës ndërkombëtare, kryerësi do të dënohet me të paktën tetë vjet burg.
- (4) Nëse vepra nga paragrafët 1 dhe 2 është kryer me person të mitur, kryerësi do të dënohet me burg prej të paktën 8 vjet.
- (5) Mjetet dhe automjetet e përdorura për kryerjen e veprës do të merren.

### **Neni 418 v, Organizimi i grupit dhe nxitja e kryerjes së veprave tregti me njerëz dhe kontrabandë me migrues**

- (1) Ai që organizon grup, bandë ose ndonjë shoqatë tjetër për kryerjen e veprave penale nga nenet 418-a dhe 418-b, do të dënohet me burg prej të paktën 8 vjet.
- (2) Ai që do të bëhet pjestarë i ndonjë grupi, bande ose ndonjë shoqate tjetër nga paragrafi 1 ose në mënyrë tjetër e ndihmon grupin, bandën ose shoqatën, do të dënohet me të paktën 1 vjet burg
- (3) Pjestar i grupit nga paragrafi 1 i cili do ta zbulojë grupin para se të bëjë vepër penale në përbërjen e vet ose për të, do të lirohet nga dënimi
- (4) Ai që thëret, nxit ose përkrah kryerjen e veprave penale nga neni 418-a dhe 418-b do të dënohet me burg prej 1 deri në 10 vjet.

## **MBROJTJA E DËSHMITARËVE, BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË DHE TË VIKTIMAVE**

### **Neni 270-a**

(1) Gjatë procedurës Prokurori publik, përkatësisht gjykatësi hetues, përkatësisht Kryetari i këshillit ndërmarrin veprime për sigurimin e mbrojtjes efikase të dëshmitarëve, të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, të viktimave nëse gjatë procedurës paraqiten si dëshmitarë kur ekziston rrezik që t'u ekspozohen frikësimeve, kanosjeve me hakmarrje ose rrezikut për jetën, shëndetin ose integritetin fizik, ose kur është e nevojshme mbrojtja e tyre.

(2) Mbrojtja e personave nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet në mënyrë të veçantë të marrjes në pyetje dhe pjesëmarrjes në procedurë.

(3) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, dëshmitari merret në pyetje vetëm në praninë e prokurorit publik dhe gjykatësit hetues, përkatësisht kryerit të këshillit, në vendin që garanton mbrojtje të identitetit të tij, përpos nëse në pajtim me dëshmitarin këshilli nuk vendos më ndryshe dhe që marrja në pyetje të bëhet nëpërmjet gjykatës pse duke përdorur mjete tjera teknike për komunikim dhe mjete të tjera përkatëse për komunikim. Kopje e procesverbalit me deklaratën e dëshmitarit, pa nënshkrimin e tij, i dorëzohet të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, të cilët mundën me shkrim nëpërmes gjykatës t'i parashtrojnë pyetje dëshmitarit.

### **Neni 270-b**

(1) Mbrojtja e personave nga Neni 270 a paragrafi (1) të këtij ligji, mund të kryhet edhe përmes inkuadrimit në Programin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve

(2) Kërkesë për inkuadrim në Programin nga paragrafi (1) i këtij neni te Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë mund të paraqesë prokurori kompetent publik, gjykatësi hetues ose kryetari i këshillit.

(3) Nëse ekzistojnë rrethana për inkuadrim në programin nga paragrafi (1) i këtij neni, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë, paraqet propozim trupit kompetent për marrjen e vendimit për përfshirje në këtë program.

(4) Përbërja, kompetencat e trupit nga paragrafi (3) i këtij neni, si dhe masat e mbrojtjes dhe mënyrat e zbatimit të tyre përcaktohen me ligj.





---

## *Bibliografia*

Arnaudovski Q dhe Stojanovski T, Tregtia me njerëz- krimet, Shkup, 2002

Baçanoviç Oliver, Policia dhe shteti, Shtip, 1998

Gagaçev Vangel, Dërgimi i letrave gjyqësore sipas rregullave ekzistuese, Materijale nga këshillimi për servis për dërgim në gjyqësinë e Republikës së Maqedonisë, Revia Gjyqësore, nr.3

Raporti Përfundimtar i Koalicionit "Të gjithë për gjykime të drejta", Korrik 2004 deri korrik 2004

Përfundim nga takimi i mbajtur në Slloveni, Mars 2003 me motiv "Masa të posaçme për mbrojtje të viktimave të tregtisë me njerëz të cilët lajmrohen si dëshmitarë gjatë procedurës"- Pakti për stabilitet- Evropa Juglindore

"Mbrojtja e dëshmitarit në sistemin e gjyqësisë penale" – Raport i Misionit të OSBE-së në Kosovë

Ingilizova-Ristova, Liljana Konventae Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional dhe dënimi-konfiskim i pronës, Revia Gjyqësore, 2002, nr.4

Judicial Reform Index for Macedonia, November 2003

Kalajxhiev Gordan, E drejta e personit privat për gjykim të shpejtë, Siguri, 1994 nr.1

Kalajxhiev Gordan, E drejta e të akuzuarit ti mundësohet prani gjatë dëgjimit të dëshmitarëve në interes të tij, Vjetorja e Fakultetit të Drejtësisë në Shkup, 1996/98, vëllimi 38

Kambovski Vllado, Reforma ndëshkuese juridike para sfidae të shekullit XXI, Shkup 2002

Kambovski Vllado, E drejta Ndëshkuese- pjesa e përgjithshme, Shkup, 2004

Kambovski Vllado, E drejta ndëshkuese, pjesa e veçantë

Vllado Kambovski, Krimi i Organizuar, 2005

Kanevçev M. Viktimologjia-Të mësuarit për viktimën, Vjetor i Fakultetit për Siguri, 2000/2001

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional me protokolet (komente, shtojca, qartësime dhe rekomandime), Ministria e drejtësisë

K. de Rover, Paraburgim, Në shërbim për mbrojtje, të drejtat e njeriut dhe e drejta humanitare për forcat policore dhe të sigurisë, MKCM,

Lazhetiq Buzharovska Gordana, Rëndësia e të drejtës për gjykim të shpejtë në SHBA, Vjetor i Fakultetit Juridik në Shkup, 1996/98, vëllimi 38

Lazhetik-Buzharovska Gordana, Mënyra për përsheptimin e procedurave penale në Legjislaturë Evropiane, Revia Maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji, 1998, nr.1

Limanowska Barbara, Trafficking in Human Beings in South Eastern Europe, March 2005,

Manev Pavel, Vërejtje dhe propozime në lidhje me paraburgimin, Revia Maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji, 1995

Manev, Pavel, Disa aspekte juridiko ndëshkuese të eksertizave neuropsihjatrike, Revia Maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji, 1998 nr.1

Maranoviç Gorgji, Matja e Dënimit, E drejta Penale e Maqedonisë. Pjesa e përgjithshme, Shkup, 1998

Matovski Nikola, E drejta Ndëshkuese procesore, Pjesa e përgjithshme, 2003 SShkup

- Matovski Nikola, Roli i mbrojtësit gjatë procedurës penale, Libri i Maqedonisë, 1981, Shkup
- Matovski Nikola, Kohëzgjatja e paraburgimit, Sistemi i procedurës ndëshkuese në Republikën e Maqedonisë, Vjetor i Fakultetit Juridik në Shkup, 1999.2001 vëllimi 39, libri 2
- Mattar Mohamed Y., a comparative Analysis of the Anti-Trafficking Legislation in Foreign Countries: towards a comprehensive and effective legal response to combating trafficking, 25 June 2003
- Migration connected with trafficking in women and prostitution, 25 April 2003, **Report**, Committee on Equal Opportunities for Women and Men, Rapporteur: Ms Zwerver, Netherlands, SOC
- Miftari Agim, Etika profesionale në gjyqësi, prokuroria dhe avokatura dhe relacionet e ndërsjellta, Revia Gjyqësore, nr.3
- Mrvik N., Dëshmërbliimi gjatë rprocedurës penale-mes reparimit dhe retribuimit, Siguri-Revja e krimistikës, kriminologjisë dhe të drejtës penale 1994, nr.2
- Pavlovski Vanko, Pozita e të dëmtuarit në procedurën penale, Revja Gjyqësore, 1996, nr.5
- Doracak për gjykime të drejta, 22.2.1, Dëshmitarë anonim
- Praktikum për luftën kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal, Irganizata Ndërkombëtare për Migrime, Misioni në Shkup 2005
- Doracak për trajnim në suaza të programës gjithpërfshirëse për trajnim, shkëmbim dhe bashkëpunim të grupit operativ të paktit për stabilitet në lidhje me tregtinë me njerëz
- Doracak për trajnim, "Zhvillimi i mpdelit për trajnim të gjykatësve dhe Prokurorisë Publike në sferat e tregtisë me njerëz", 2003, Stability pact for South Eastern Europe
- Proevski Jovan, Milan Kërckovski, Shtyrje dhe Ndërprerje të shqyrtimit kryesor, Ligji për procedurë penale-qartësime, kemente, praktika gjyqësore dhe shembuj për zbatim praktik, Akademik 1997
- Vlerësim i qëndrimeve dhe të dhënat për popullatën e shkollave të mesme për fenomenin e prostitucionit të fshehur dhe tregtisë me njerëz, HOPS, Shkup, 2004
- Selimi Zeqir, kohëzgjatja e procedurës penale për lëndë penale të zakonshme, Revja Gjyqësore, 1998, nr.4
- Snezhana Tasi, Funckioni dhe domethënia e ekspertizës psihijatrike, Revja Maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji. 1998, nr1
- Stojanov Ivanço, I dëmtuari si subjekt në procedurën penale, Revja Maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji, 1996
- Stojanov I., Bazat për përcaktimin e paraburgimit në Procedurën penale të Maqedonisë, Vjetor i fakultetit për siguri, 2000/2001
- "Tregtia me njerëz-Temis" Shkup, 2004
- Tumanovski Dragan, Tregtia me njerëz, 2002, nr4
- Tumanovski Dragan, Marëveshjet ndërkombëtare, botimi i dytë i plotësuar, Shkup, 2005
- Tupaņevski Nikolla, Tregtia me njerëz në të drejtën krahasuese-ndëshkuese dhe në të drejtën ndëshkuese në R të Maqedonisë, Revja e Maqedonisë për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji
- Changing patterns and trends of trafficking in persons in the Balkan region, IOM Report 2004
- Cvetkovski, Cvetan Mundësitë kushtetuese dhe kufijtë për caktimin ligjor të paraburgimit dhe masave tjera për sigurimin e pranisë së të akuzuarit, Revja Maqedonase për të drejtën ndëshkuese dhe kriminologji, 1995

---

\*\*\*

<http://www.legislationline.org/> Trafficking in Human Beings

[http://www.unodc.org/unodc/en/trafficking\\_victim\\_consents.html#how](http://www.unodc.org/unodc/en/trafficking_victim_consents.html#how) United Nations, Office on crime and drugs

<http://www.abanet.org/ceeli/publications/conceptpapers/humantrafficking/moldova.html> CEELI Survey of Legislative Frameworks for Combating Trafficking in Persons

<http://webjcli.ncl.ac.uk/2001/issue5/obok5.html> The Durham Research postgraduate conference 2001

<http://www.germanlawjournal.com/> German Law Journal.

<http://www.interpol.int/Public/THB/PeopleSmuggling/Default.asp> Interpol

[www.femmigration.net/victims](http://www.femmigration.net/victims) Legal agenda for Migrant Prostitutes and trafficked women on Internet

[www.ncjrs.org](http://www.ncjrs.org) Issues and Practices

<http://icpo.at.tut.by/crimpren.html> Sources of Criminal Procedure

<http://www.ncjrs.org/spotlight/trafficking/summary.html> NCJRS

<http://www.usdoj.gov> United states department of justice

<http://www.protectionproject.org> Protection project

<http://www.state.gov> United states department of state

[http://www.newr.bham.ac.uk/topics/Trafficking/trafficking\\_newr.htm](http://www.newr.bham.ac.uk/topics/Trafficking/trafficking_newr.htm) Network for European Women's Rights

<http://www.december18.net/web/general/start.php> International calendar-directory-UNconvention-imd-campaigns

<http://www.ojp.usdoj.gov/> United states department of justice

[http://www.oasis.gov.ie/justice/victims\\_of\\_crime/Irish](http://www.oasis.gov.ie/justice/victims_of_crime/Irish) Government Resource

[www.mvr.gov.mk](http://www.mvr.gov.mk) Ministria për punë të brendshme.





КОАЛИЦИОНТИ КОАЛИЦИЈА КОАЛЦИЈДА  
СИТЕ ЗА ПРАВИЧНО СУДЕЊЕ  
ТЁ ГЈИТЁ ПЁР ГЈУКИМЕ ТЁ ДРЕЈТА  
SARINE BAŞO NIJAMALO KRISIPE

Me përkrahjen e



Organization for Security and Co-operation in Europe  
**Spillover Monitor  
Mission to Skopje**